

BIBLIOTEKA


E

8.5H-1-82

F 65


SHETIT

GJIROKASTER



*RILINDJA  
ME GJYKU  
SË PËRPARIMI*

Antologji e poetëve të Rilindjes



## P A R A T H È N I E

*Ky libër me pvezi të zgjedhura të poetëve më të shquar të Rilindjes sonë Kombëtare botohet në prag të 70-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë. Dhe kjo është e natyrshme përderisa kjo poezi ka marrë pjesë aktive në përgatitjen e ngjarjes së madhe. Ajo ka ecur njësh me kohën, është pjellë dhe dëshmi e saj e pazëvendësueshme. Si në asnjë periudhë tjeter letrare të së kaluarës, në këto poezi janë pasqyruar tiparet e kohës, fryma e saj heroike e patriotike, drita e vetmohimi i saj. Zhuurimën e epokës së Rilindjes, zhurmën e topave dhe të dyfekëve, jehonën e këngëve dhe demonstratave, të prangave, të zinxhirëve të thyer, të kuajve që çonin Qeverinë në Vlorë, të gjitha këto i gjejmë në fjalët e ritmet e këtyre vjershave. Gjëmë të pasqyruar në të atë gjendje të veçantë shpirtërore të popullit tonë në mbarim të natës së gjatë shekulllore të pushtimit dhe në vigjilje të mëngjesit të Pavarësisë. Meritë kryesore e kësaj poezie është se e kapi mesazhin e kohës, e bëri atë program të saj dhe me atë mesazh madhor u fut në luftë për çështjen e Shqipërisë. Këndej vjen gjithë forca e saj, karakteri kombëtar e popullor, fryma përparimtare, drita dhe bukuria e saj. Rrallë mund të gjendet në historinë e kulturave evropiane një frymë vetmohimi si në poezinë e Rilindjes sonë. Heroika, prometeizmi, flijimi për çështjen kombëtare, janë karaktere*

*ristikë kryesore e kësaj poezie. Të tjerat janë rrjedhim i tyre.*

Një frysme suvereniteti, e reflektuar nga poezia popullore, e përshkon tej e mbanë këtë poezi. Është besimi i madh te çështja kombëtare, te luftra e drejtë e popullit shqiptar, te njerëzimi përparimtar në përgjithësi. Ajo ushqehet nga ndjenja e superioritetit ndaj pushtuesit, ndaj ideoologjisë e filozofisë së tij barbare, egërsisë dhe prapambetjes së tij. Por ajo ushqehet njëkohësisht nga superioriteti ndaj fqinjëve shovinistë, qeverive të tyre që s'ishin më pak barbare se ajo e pushtuesit osman. Meritë e madhe e poezisë sonë të Rilindjes, ashtu si e gjithë epokës, është se duke u përleshur me helmin shovinist, me injorancën dhe egërsinë e tij, e ruajti veten të pastër, nuk u përlye nga balta dhe nuk u hidhërua nga helmi. Me këtë, ajo tregon se është thellësisht superiore ndaj përkuzave reaksionare që vlonin përreth saj dhe se ishte jo vetëm një poezi e ndritshme e përparimtare për vendin tonë, por njëkohësisht një shembull për gjithë popujt e gadishullit ballkanik. Sa më shumë që kaloi koha aq më tepër shkëlqeu ky tipar i saj i mrekullueshëm.

Tipar tjetër i rëndësishëm është fryma e shëndetshme dhe optimizmi i saj. Rrallë mund të mendohet një poezi e lindur në kushte të atilla, që të ketë aq dritë e optimizëm në vetvete.

Ndihet menjëherë që nata e robërisë po ikën, bashkë me ankthet e saj, që mëngjesi është pranë. Kjo frysme paramëngjesore e përshkon atë nga kreua në fund. Ajo dëboi prej saj të gjitha spekulimet e mundshme, pozat, frymën e sëmurë, me të cilat qe mbushur poezia evropiane e, kohës. Megjithëse s'ishte koha për festë, megjithëse ndihej se Shqipëria po ngrihej përmes mundimesh, se kishte përparrë ende drama të tjera, asnjëherë kjo poezi s'e uli kokën. Dhe këtu duhet thënë se optimizmi i saj nuk ishte naiv. Pjesa më e madhe e poetëve ishin njerëz të shquar, të ndërgjegjshëm për ngjarjet e tragjeditë e ardhshme, shpesh dhe personazhe të tyre, megjithatë ata dinin të shikonin mes mjegullës të ardhmen e Shqipërisë.

Të gjitha këto tipare c bënë këtë poezi të dashur e gjith-monë të afërt për popullin tonë.

Poezia jonë e realizmit socialist, duke trashëguar tiparet më të mira të poezisë së Rilindjes, i ka çuar ato më tej, i ka pasuruar, zgjeruar, kthjelluar e shëndoshur edhe më. Brezi ynë i ri, i rritur dhe i edukuar në epokën e Partisë, gjen në poezinë e Rilindjes, embrionin e shumë vlerave që epoka e socializmit i ka rritur në përmasa të mëdha. Ndaj ai e do dhe e çmon këtë thesar.

ISMAIL KADARE

et klosteret i Lund har gjort det  
en god del for den katolske  
kyrkan i Sverige. De har  
med hjelpe av de katolske  
kyrkjene i Europa og Amerika  
gjort det mulig å få til en  
kloster i Lund som kan  
være et godt eksempel  
for andre katolske  
kyrkjene i Sverige.

WILHELM WAGNER

**NAIM FRASHËRI**

**SHINRAKI MIKE**

## **Gjuha jonë**

Vëllezër shqipëtarë,  
të prekim urtësinë,  
të zëmë udhën e mbarë,  
të ngjallim Shqipërinë!

Shqipëria ka qenë,  
edhe po do të jetë,  
po sot në ditët tënë  
të metë të mos ketë.

E ka nderuar Zoti  
gjithënë Shqipërinë,  
ish fort mirë qëmoti,  
do bëhet dhe taninë.

Sa ishte trimëria  
n'atë kohë të vjetër;  
kish emër Shqipëria,  
sa s'kish ndonjë vend tjetër.

Sa burra kordhëtarë  
ka nxjerrë Shqipëria  
më pastaj e më parë,  
q'i shkruan historia.

Ajo ish 'kohë' e 'zjarrtë,  
dhe kish mundime tepër,  
po sot pendë dhe kartë  
na duhet, nukë tjetër.

O burra shqipëtarë,  
të marrim dituritë,  
se s'është kohë e parë,  
tani lipsetë dritë.

Të shkruajm' gjuhën tënë,  
kombinë ta ndritojmë,  
gjithë ç'është e ç'ka qenë,  
ngadalezë ta mësojmë.

Pa shihni ç'gjuh' e mirë!  
Sa shije ka e hije,  
ç'e bukur' edhe e lirë,  
si gjuhë perëndie.  
Shumë e bardhë kjo ditë'  
për gjithë shqipëtarët,

---

1) Është fjala për hapjen e shkollës së parë shqipe në Korçë,  
mars 1887

do na sjellë një dritë  
që s'e kishin të parët.

Kjo dritë do na bjerë  
të gjitha mirësitë  
dhe gjithë do t'i ngrerë  
dëmet e marrëzitë.

Si lum kush zë të mbjellë,  
lum kush vë këtë pemë,  
se kjo ka për të pjellë,  
s'mbulohetë me rremë!

## Korça

O vëllezër shqiptarë,  
gëzohi që erdh' kjo ditë,  
kaq e mirë e kaq e mbarë,  
që sjell gjithë mirësitë.

Kjo është një ditë e rezë,  
që bie vëllazerinë,  
e dëbon jetën e zezë  
dhe ndarjen e marrëzinë...

Hapu, hapu, errësirë!  
Pa jakë tëhu, o dritë!  
Se arriti kohë e mirë,  
u gdhi nata, u bë ditë.

Sot niset një tjetër jetë,  
të rrmenë poshtë e shtie,  
mbretëron fjalë e vërtetë  
dhe të mirat gjithë i bie...

Lumja ti, moj Korçë, o lule,  
q'i le pas shoqet e tua,  
si trimi në ballë u sule,  
ta paçim për jetë hua!

Kushdo që është sot burrë  
dhe shqipëtar i vërtetë,  
emëri s'i shuhet kurrë  
dhe nderi i rron përjetë.

Gjuha jonë sa e mirë,  
sa e ëmbël, sa e gjerë,  
sa e lehtë, sa e lirë,  
sa e bukur, sa e vlerë!

Kjo është mëmë e mirësisë,  
që bie qyteterinë,  
gazthin e vëllazërisë,  
njerëzinë e miqësinë.

S'jemi grekër as bullgarë,  
as gjë tjetër nukë jemi,  
jemi vetëm shqipëtarë  
ne këtë emër nder e kemi.

Ky emr' është shumë i mirë,  
se më s'jemi të gënjer,

nukë jemi n'errësirë,  
e njohëmë gjënë e vyer...

O, sa qenë të gënjer  
ata që vuan për botë,  
turp të madh kanë rrëfyer,  
punuanë fare kotë!

Nga gjithë ç'kemi kënduar,  
për të njohur vetëhenë,  
kaqë gjë kemi mësuar,  
të nderojmë Mëmëdhenë.

Se njerëzit gjithë vdesin,  
pojeta s'mbetet e shkretë,  
gjuha, Mëmëdheu mbesin  
të patundurë për jetë...

## **S h p r e h<sup>1)</sup>**

Kam shumë shpresë  
te perëndia  
që të mos jesë  
k'shtu Shqipëria,  
po të ndritohet,  
të lulëzohet.

Pa vjen një ditë  
që të na sjellë  
të madhe dritë,  
q'ajo të pjellë  
qytetërinë,  
fatbardhësinë.

Vëllazëria  
edhe bashkimi  
e njerëzia  
është shpëtimi.

---

1) Shpresoj

Lum kush t'arrijë,  
pa do të vijë,  
që Shqipëria  
do të ndritohet  
dhe ligësia  
do të mërgohet.

Jak', e vërtetë!  
Pse rri e qetë?  
Për Shqipërinë  
ditët e mira  
paskëtaj vinë,  
shkoi errësira,  
lum kush të rrojë  
ta shohë zonjë!

Se shqipëtari  
e gjuh' e tija  
venë së mbari  
dhe Shqipëria,  
lum kush ta shohë  
për pakë kohë!

Pa dituritë  
dhe mbrothësia  
e mirësitë  
dhe njerëzia  
do të burojnë,  
nukë mënojnë.

1890

## Tradħētorët

Shokë, kemi nē mes tēnē  
shum' armiq' e tradħētorë!  
Popo, mos u qoftë thēnē,  
veç qē s'kanë gjē nē dorë!

Harruanë Mēmēdhenë,  
dh'e lanë kombinē tēnē  
e njē tjetrē na gjenē!  
Popo, mos u qoftë thēnē!

Lanë zonjën' e lēvduar  
e zunē njē kurvē shtrigë,  
tē ndyr' e tē mallēkuar,  
tē fēlliqr e tē ligë!

Lanë mēmēn tē zhveshur  
dhe mundohenē pēr botë,  
pa dhe bo ta, duke qeshur,  
u thotë: Mundohi kotē!

Qysh u bënë Efialtë,<sup>1)</sup>  
e nuk' e njohin të mirën,  
uthullën pendehin mjaltë  
edhe dritë errësirën!

Buk' e Mëmëdheut i zëntë  
tradhëtorët e pabesë,  
dhe zoti dërmën u dhëntë,  
kurrë mos paçinë pjesë!

Miqt' armiq i kanë bërë,  
armiqëtë miq i zunë,  
qysh janë fyell të tërë,  
ç'është kjo e madhe punë?!

Fajn' e madh kur do ta njohin  
njerëzit e mallëkuar?  
Dritënë pse nuk' e shohin,  
apo janë të verbuar?

Janë së gjithash të marrë  
dhe të liq me të vërtetë,  
Mëmëdheut i bëjnë varrë,  
po do të bienë vetë.

---

1) Figurë e njohur tradhtare e Greqisë së vjetër.

Se mbretëron e vërteta,  
s'del kurrë gënjeshtr' e shkretë;  
t'ish ashtu, qe prishur jeta,  
s'kish mbetur gjë e vërtetë.

Ata turpinë fitojnë,  
nder' e tyre posht' e hedhin,  
dhe armiqëtë gëzojnë,  
e në errësirë bredhin.

Nuk është kurrë harruar  
dh'e mira dh'e lig' e shkretë,  
të gjitha janë paguar,  
s'ka mbeturë gjë në jetë...

Opopo, ç'turp kanë marrë,  
janë bërë tradhëtorë,  
dhe s'janë më shqipëtarë,  
se nga kombi hoqën dorë!...

Vëllazérin' e harrojnë  
dhe kombin' e mëmëdhenë,  
dhe armiqëtë dëgjojnë  
edhe s'dinë se ku venë.

Hiqni dorë, hinqni dorë,  
mblidhni mend' e turpërohi;  
mos-u bëni tradhëtorë,  
se pastaj do të pendohi!

### 1890

Shqipëri, qëndroj me  
nëntorin e vjetër, qëndroj me  
nëntorin e vjetër, qëndroj me  
nëntorin e vjetër.

Nëntorin e vjetër, qëndroj me  
nëntorin e vjetër, qëndroj me  
nëntorin e vjetër, qëndroj me  
nëntorin e vjetër.

Nëntorin e vjetër, qëndroj me  
nëntorin e vjetër, qëndroj me  
nëntorin e vjetër, qëndroj me  
nëntorin e vjetër.

Nëntorin e vjetër, qëndroj me  
nëntorin e vjetër, qëndroj me  
nëntorin e vjetër, qëndroj me  
nëntorin e vjetër.

## **Shkëndij' e dielli ndaj manushaqes**

Manushaqe bukuroshe,  
pse s'ngre kryetë përpjetë,  
po rri e mpit' edhe e qetë,  
pse s'zbukuroh' e s'shëndoshe?

Pa shiko lulet e tjera,  
q'u çel' e u lulëzuan,  
shih, pa shih ç'u zbukuruan,  
i ngjalli përsëri vera.  
Zgjohu tani q'u ngroh moti,  
erdhî koh' e gjallërisë.

Se dheu anembanë bleroi  
e të vdekurit u ngritën,  
gjithë ç'jan' u përtëritën.

Prej qiellit bukurinë,  
edhe nga parajsa erë  
të kam prurë këtë herë,  
pa hape, pa hape gjinë.

Hap syt' e qesh dhe gëzohu,  
se gaz të madh të kam prurë,  
mos më rri si e sëmurë  
po çelu e zbukurohu.

Shpëndëra, hithëra, ferra  
përsipër të kanë rënë,  
dritënë ta kanë zënë,  
me fletë shumë të gjera.

Të kanë kallurë gjëmba,  
që të shpojn' e të lëndoijnë,  
edhe gjaknë ta helmojnë,  
që të lëvrin nëpër rrëmba.

Dhe ca nga fletët e tua  
me të huaja përzierë,  
secila do të të bjerë  
dëmn' e vdekjenë pothua!

Oh, fletëtë që i rrite,  
duke i nxjerrë nga gjiri yt,  
t'u bënë si halë në syt',  
pa m'u fishk' e m'u drobite!

Dimër' i madh me dëborë,  
me të ftoht' e me të ngritë

e me gjithë ligësitë,  
të la të mjer' e të gjorë.

Ah, ta zbriti bukurinë  
dhe gjëllimn' e gjithë ç'kishe,  
vdiqe, u trete, u' prishe,  
të thatë të shoh taninë!

Po mos u tremb, bëhu trime  
edhe ki durim e shpresë,  
e pa sillë zotit besë,  
dhe kësaj fjalësë sime.

**1885**

## Fjalët e qiririt

Në mes tuaj kam qëndruar,  
e jam duke u përvëluar,  
që t'ju jap pakëzë dritë,  
natënë t'jua bëj ditë.

Do të tretem, të kullohem,  
të digjem, të përvëlohem,  
që t'ju ndrij mir' e të shihni,  
njëri-tjetrin të njihni.

Për ju do të rri të tretem,  
asnje çikë të mos mbetem,  
të digjem e të qaj me lot,  
se dëshirën s'e duroj dot.

Unë zjarrit nuk i druhem  
dhe kurrë s'dua të shuhem,  
po të digjem me dëshirë,  
sa të mund t'ju ndrij më mirë.

Kur më shihni që jam tretur,  
mos pandehni se kam vdekur,  
jam i gjall' e jam në jetë,  
jam në dritë të vërtelë,  
unë jam në shpirtin tuaj,  
mos më kini për të huaj.

M'është falurë durimi,  
andaj po digjem si trimi,  
se ma kënda t'ju bëj mirë,  
të mos mbeti n'errësirë.

Jakëni rreth meje rrini,  
flisni, qeshni, hani, pini.  
Në shpirtit kam dashurinë,  
pa digjem për njerëzinë.  
Lemëni të përvëlohem,  
nukë dua më të ftohem,  
dua ta djeg trupn' e shkretë...  
Me zjarr ta djeg mushkërinë  
e të tretem për njerinë...

Unë dua njerëzinë,  
mirësin' e urtësinë.  
Në bëhi shokë me mua,  
në më doni si ju dua,  
njëri-tjetërin në doni,  
të paudhë mos punoni.

O zemëra fluturake,  
qasju pakë kësaj flake,  
mbase krahët t'i përvëlon,  
po dhe shpirtin ta shenjtëron!...

Dua shumë fjalë t'ju them,  
po trëmbem mos i bënji ujem.  
e ku shkruhenë në kartë  
fjalët e gjuhës së zjarrtë?

**1884**

## Fyelli

Pa dëgjo fyellin ç'thotë,  
tregon mërgimet e shkreta,  
qahet nga e zeza botë,  
me fjalëzë të vërteta:

Qëkurse më kanë ndarë  
nga shokë e nga miqësia,  
gra e burra kanë qarë  
nga ngashërimet e mia!

Krahërorë e kam shpuar,  
e kam bërë vrima-vrima,  
dhe kam qarë e kam rënkuar  
me mijëra psherëtima!

Dhe me botën e gjëzuar  
bëhem shok edhe marr pjesë,  
dhe me njerëz të helmuar  
bëhem mik me besa-besë.

Puna sido që të bjerë,  
unë qaj me mallëngjime,  
më çdo vend e kurdoherë  
psherëtin zemëra ime!

Gjithë bota më dëgjojnë  
po së jashtëmi më shohin,  
dëshirën s'ma kupëtojnë,  
zjarr' e brëndshëm s'më njohin!

Njerëzit me mua rrinë,  
unë qaj e mallëngjehem,  
po dufnë e fshehtë s'ma dinë,  
andaj kurrë s'përdëllehem.

Gjith' ata që janë ndarë,  
fyellit shokë iu bënë,  
shkallët e tij disa farë.  
na shkalluan mendjen tënë.

O rrëmet i njerëzisë!  
Zéri i fyellit s'është erë,  
ky është zjarr i dashurisë,  
që i ra kallamat mjerë!

I ra qiellit, e ndriti,  
i ra zemërës, e nxehu,

i ra verës, e buqiti,  
i ra shpirtit dhe e dchu

I dha erë trëndafilit,  
i dha dritë bukurisë,  
i dha këngëtë bilbilit,  
i dha shije gjithësisë.

O more zjarr i bekuar!  
Unë me ty jam përzjerë,  
po jam tretur e kulluar,  
po të kam shpirt, mos më lerë.

**1885**

## Bagëti e bujqësia

O malet e Shqipërisë e ju o lisat e gjatë,  
fushat e gjera me lule, q'ju kam ndër mend dit' e natë,  
ju bregore bukuroshe e ju lumenjt' e kulluar,  
çuka, kodra, brinja, gërxhe dhe pyje të gjelbëruar!,  
Do të këndojoj bagëtinë, që mbani ju e ushqeni,  
o vendëhit' e bekuar, ju mendjenë ma dëfreni!  
Ti, Shqipëri, më jep nderë, më jep emërin shqipëtar,  
zemërën ti ma gatove plot me dëshirë dhe me zjarr.  
Shqipëri, o mëma ime, ndonëse jam i mërguar,  
dashurinë tënde kurrë zemëra s'e ka harruar.  
Kur dëgjon zëthin e s'ëmës, qysh e lë qengji kopenë,  
blegërin dy a tri herë edhe ikën e merr dhenë,  
edhe në i prefshin udhën njëzet a tridhjetë vetë  
e ta trembin, ai s'kthehet, po shkon në mes

si shigjetë,

ashtu dhe zemëra ime më lë këtu, tek jam, mua,  
vjen me vrap e me dëshirë aty nér viset e tua.  
Tek buron ujët e ftohet edhe fryn veriu në verë,  
tek mbin lulja me gaz shumë dhe me bukuri e m'erë,  
ku i fryn bariu xhurasë, tek kullosin bagëtia,  
ku mërzen cjepi me zile, atje i kam mend e mia;  
atje lind diell' i qeshur edhe hëna e gjëzuar,  
fat i bardh' e mirësia në atë vend janë mbluar;

nat'atje është tjetër nafë, edhe dita tjetër ditë,  
në pyjet e gjelbëruar, atje rrinë perënditë.  
Mendje, merr fushat e malet, jashtë, jashtë nga qyteti,  
nga brenga, nga thashethemet, nga rrëmuja,  
nga rrëmeti.

Tek këndon thëllëza me gaz edhe zogu me dëshirë,  
e qyqeja duke qeshur, bilbili meëmbëlsirë,  
tek hapet trëndafili, atje ma ka ënda të jem,  
bashkë me shpez't edhe unë t'ia thérres këngës  
e t'ia them;  
të shoh kecërit e shqerrat, deshtë, cjeptë, dhentë,  
dhitë,  
qiellin e zbukuruar, dhenë me lul' e me dritë.  
— Vashë bukurosh' e bariut, që vjen me llërë

përveshur,  
me zemërë të dëfryer e me buzëzë të qeshur,  
me dy shqerrëza ndër duar të bukura, si dhe vetë,  
në sythin tënd e shoh gazë, që s'e kam gjetur në  
jetë;  
dashi sysk' e me këmborë, q'e ke manar, po të vjen  
pas  
dhe qeni me bes' i larmë të ndjek me dëshir' e me  
gas;

dashç perndinë, pa më thuaj, a mos na pe bagëtinë?  
— Pash' atje pas më të gdhirë... ja atje përtej tek  
vinë! —

O sa bukuri ka tufa, sa gaz bie bagëtia!  
Vijnë posi blet' e plotë, i bekofte perëndia!  
Nëpër shesh' e nér bregore janë përhapurë shqerrat  
e kecërit nëpër rripat dhe në gjethet e në ferrat;  
sa me vrap e me gaz bredhin, edhe lozin shoku me  
shok,

aty përhapenë me nxit, aty mblidhenë prapë tok,  
edhe prapë tufë-tufë përhapenë duke bredhur,  
duke ikur me vrap shumë, duke lojtur, duke u hedhur.  
nxitojn' e s'lodhenë kurrë, edhe kur i merr uria,  
secili futet në tufë, suletë ne mëm' e tia;  
posa gjën mëmën e dashur edhe me vrap i hyn në gji,  
tri në gjunjë dhe zë sisën e qumështin e ëmbël pi.  
Pa e ëma me mall shumë, ndo dhi qoftë e ndo dele,  
bir' e vetëm e merr në gji me gaz e me përkëdhele...

.....

Sa më pëlqen blegërima, zër' i ëmbël i bagëtisë,  
qengji edhe kec' i bukur, që rri më gjunj' e pi sisë!  
Përhapurë bagëtia nëpër sheshe, nëpër brinja,  
ner lajthi e nëpër dushnja, ndër murizza, në dëllinja,  
bien zilet e këmborët dhe fyelli e xhuraja,  
dheu bleron e gjelbërojnë fusha, male, brigje, majë;  
edhe gjithë gjë e gjalle ndjen në zemër një dëshirë,  
një gaz t'ëmbël e të shumë, o, sa bukur e sa mirë!  
Pelën e ndjek mëz' i bukur, lopës i vete viçi pas,  
dallëndyshja punëtore bën folenë me të madh gas,  
ogiçi ikën përpara, i bie tufës në ballë,  
me zemër të çelur shumë, vete si trimi me pallë...  
Qielli sa është i kthjellë e sa është zbukuruar!  
E dielli sa ndrin bukur mbi lulet të lulëzuar!  
Gjithë këto lule ç'janë, që u ngjalle menjëherë?  
Ngaha qielli ke zbritur, ver', o e bukura verë?!

Çdo lulezë ka me vete një emër e një fytyrë,  
një bukuri, një mirësi, një shtat, nj'erë e një ngjyrë,  
si dhe çdo dru e çdo pemë, edhe çdo bar e çdo fletë.  
Sa është bukur faq' e dheut, s'të zë syri gjë të  
metë...

.....

Veç një njeri shoh pa punë dhe të mjer' e të  
brengosur,  
të këputur, të mejtar, të grisur e të rreckosur,  
lipën i gjori pa shpresë, se atje e pru përtimi,  
s'i ka mbetur gaz në zemër, se s'i la vend  
hidhërimi...

Ah, edh' atje tej mbi udhë i duket i shkretë varri,  
rrethuar me lul' e me bar, një të gjori udhëtar,  
që ka vdekur i ri shumë e ka rarë lark shtëpisë,  
mërguar nga mëm' e motër dhe prej gjithë njerëzisë.  
Një zog i helmuar mi varr i rri si mëmëz dhe e qan,  
ndarë nga të gjithë shokët edhe zi për të mjerë  
mban...

O malet e Shqipërisë, që mbani kryet përpjetë,  
tëmerr e frikë përhapni, përpini qiejt e retë!  
Të patundurë për jetë jini, pa kur oshëtini,  
udhëtarit në zemër frikë të madhe i vini;  
kini shkëmbenj, gërxhe, lisa, lumenj dhe dëborë  
në gji;  
përsipër lulez e gjethë dhe brenda argjend e flori;  
e ju, fusha bukuroshe, edhe të majm' e pëllore,  
ju sheshet e lulëzuar, ju bregore gjelbërore...  
zemern' e varfërë time aty ndër ju e kam mbluar,  
tek buron nga gjithi juaj uj' i ftoht' e i kulluar;  
jam larg jush i dëshiruar edhe s'e duroj dot mallë,  
po s'e di, si dua unë, do t'ju shoh njëherë vallë?!  
Të paskësha vrapt' e veriut, të kisha krahë pëllumbi,  
nxitimin' e lumit me valë, q'ikën me vërtik si plumbi,  
e të viaj në gji tuaj, nj' ujë të ftohet të pija,

edhe nëpër ato hije një copë herë të rrija,  
syt' e ballit t'i zbavitja, zemërën ta dëfreja,  
gazë, që paçë një herë, prap' aty ndër ju ta gjeja.  
Opopo! kshtu pse më vini përpara syve pa pushim,  
o ditët e djalërisë, o moj kohëz e të rit tim?  
O flutura krahëshkruar, që fluturon nëpër erë,  
as merr dhe zemrën time me vetezë dhe ma shpjerë  
nër male të Shqipërisë, tek kullosin bagëtia,  
tek i frys bariu xhurasë, tek më rrinë mendt' e mia,  
ku shkon me zile të madhe ogiçi përmes lajthisë,  
pa zjen e oshëtin mali ngaha zër' i bagëtisë;  
marrënë vrapt' e nxitojnë, derdhen në gjollë për

kripë,  
dhëntë ndër shesh' e ndër brigje, dhitë në shkëmb  
e në rripë.

Bariu plak kërrabën në dorë, edhe urdhëron

të rinjtë,  
e ata gjithë punojnë, ngriturë më brez përqinjtë;  
ca bëjnë vathën e shtrungën, ca ngrehin tendën  
e stanë,

kush sjell gjeth e karth' e shkarpa, secilido ndih

mënjanë;

kush përvjel, kush qeth shelegnë, kush mjel dhitë,

kush mjel dhentë,

njëri merr, ushqen këlyshnë, jatëri përgëzon qentë;

stopani bër' i zi sterërë, shikon bulmetn' e bekuar,

tund, bën gjalpë, djathë, gjizë edhe punon pa përtuar;

udhëtarëve e gjahtarëve, q'u bie udha ndër male,

u jep mish, qumëshët, kos, dhallë, ajkë, djathtë,

bukëvale...

Kec i mbeturë pa mëmë dhe i varfër e i shkretë,

mënd mëmënë, që ka mbetur pa bir e pa gaz në jetë.

Dëgjohet nga mes' i pyllit krism' e sëpatës  
s'druvarit,  
e sharrësë, që bënë lëndë, edhe fyell' i shterparit.  
Shterpari s'i qaset stanit, po ndër pyje bij' e ngrihet,  
nëpër maya, nër bregore rri, këndon, a gdhend e  
shtrihet;  
s'i trembetë syri kurrë, vetëm ai dit' e natë,  
nga ujku e nga kusari, s'ka frik' as nga lis' i gjatë,  
as nga shkëmbenjt' e nga pylli; as gogolëtë s'e hanë,  
armëtë ka shok e vëlla, mëm' e motërë xhuranë,  
miqt' e tij shqerratë janë, kecëritë, dhitë, dhentë,  
cjeptë, ziletë, këmborët, deshtë e më tepër qentë,  
që s'flenë po rrin' e ruajnë bagëtinë dhe barinë;  
kur e shohin tundin bishtin, dhe me gas të madh i  
vinë;  
s'e hanë njerin' e mirë edhe mikn' e udhiëtarë,  
se i njohin, po të lignë, egërsirënë, kusarë.  
Vjen nata e lë në t'errët, del hëna, i përhap drithën,  
vjen mëngjesi, zbardhëllohet, lind diell' i bie ditën;  
yjtë, hëna, dielli, shenja lindin e prapë përendojnë;  
gjithë ç'lëvrijnë nër qiej përpara syve i shkojnë;  
mblidhen ret' e hapësira bëhetë e zezë sterrë,  
vetëtimat e gjëmimet nisin e shiu zu të bjerë;  
bariu vë gunën në kokë, zë eshkën me herë të parë,  
ndez shkarpat sakaqëherë a lisnë fyl dhe bën zjarrë;  
fishkëllen e thërret qentë secilin me emër veçan,  
pa kur derdhet Baliku ujkun e zë edh' e përlan,  
se bisha, që bie dëmnë, errësir' e mjegull kërkon,  
papo bariu shum' aherë vë re dhe mban vsh e dëgjon,  
dhe sokëllin me zë të madh; tunden malet e shkëmbenjtë,  
gumzhitin pyjet e veshur e oshëtijnë përrenjtë!  
Ësht e lehtë dhi e stanit, që kullot gjethen e malit

dhe bij' e fle majë shkëmbit e pi ujëthit e zallit;  
dhi e shtëpis' ësht' e plogshtë, fle në vath e nënë strehë,  
e pi ujët e rrëkesë edhe shtrihetë në plehë,  
ësht' e butëz' edh' e qetë dhe e urtë si manare,  
nuk është si malësorja, andaj i thonë bravare.  
Në fshat, posa zbardhëllëhet, sheh një plakëzë të gjorë,  
ngrihet, hap derën ngadalë e del me kusi në dorë,  
rri në derëzë të shtrungës, dhe djali duke dremitur  
i ngjet bagëtin' e dalën, i mjel pakëz' e drobitur;  
plaka lë shkopnë mënjanë e bën gardhin a zë shtegnë,  
bariu vë tufën përpara, vasha përkëdhel shelegnë,  
nusja fshin e ndreq shtëpinë edhe bën bukën e gjellën,  
i shoqi sheh kanë, lopën, viçnë, demnë, kalën, pelën,  
mushkën, që ësht' e harbuar edhe bashkë me gomarë  
rrahënë të hedhin murë, të hanë bimën a barë;  
një grua vete në krua, jatëra zë të tundjë,  
një sheh pulat, miskat, rosat, dhe tjetëra bën ç'të mundjë...  
Të mos ishte gjë e gjallë, njeriu s'rron dot në jetë,  
do të vdiste nga uria, do t'ish lakuriq e shkretë;  
gjë e gjallë na vesh, na mbath dhe na ushqen e na zbatit,  
kur shtohet e vete mbarë, jetënë tën' e përtërit;  
edhe dheu, që na jep drithë, sido ta kemi punuar,  
nukë pjell mirë, si duam, po s'e patëm plehëruar.  
O shokët' e njeriut! Zoti ju shtoftë e ju bekoftë!  
Dhe shpirti im mik për jetë, sikundër ka qën',  
ju qoftë!

Kafshët edhe bagëtinë, që u ka kaqë nevojë,  
njeriu duhet t'i shohë, t'i ketë kujdes, t'i dojë.  
Të mos t'i mundojmë kurrë, po si fëmijë t'i kemi,  
është mëkat edhe fjalë të ligë për to të themi.  
Dallëndyshe bukuroshe, që thua mijëra fjalë  
dhe ta kënda vahn' e lumën, që vjen me vrap e me valë,

a mos vjen nga Shqipëria? Eni vjen prej Çamërie  
me këto milëra fjalë e me gluhe perëndie?

Apo vjen nga Labëria, pra më duke kaqë trime?

Edhe fjalëtç, që thua, më gëzojnë zemrën time,

q'është thier, bërë milë copë, posa një pasqirë

duke u këputur nga cmagu,<sup>1)</sup> që s'e kanë vartur

mirë;

apo vjen ngaj fush' e Korçës, ngaj vend' i mir'

e i gjerë,

pe zemrës së Shqipërisë, që del gjithë bot' e ndjerë?

A më vjen pej Malësie, pej Skrapari, pej Dobreje,

nga Vjosa, nga Devollli, pej Vlor' e pej Myzeqeje?

Të mundjam të fluturoja e të kishjam krahë si ti,

me gaz të madh do t'i vijam Shqipërisë brenda në gji,

për të marrë drejt Shkumbinë edh' Elbasan

e Tiranën,

e me ardh ke ti, o Shkodër, të shof Drinin e Bujanën,

Kostur, Përlep, Follorinë, Dibër, Ipek e Gjakovën,

Mat e Ysqyp e Prishtinë dhe Mirëdit' e Tetovën,

Krujënë e Skënderbegut, q'i ka pas dhan ner

Shqypnisë,

tue bam me trimni luftë, e me mund mren'

e Turqisë.

Durrës, o qytet i bukur, që je kërrthiz' e Mëmëdheut,

edhe ti, Leshi me emër, që ke eshtrat e Skënderbeut,

burrat tuaj aqë trima do ta lënë vall' Ulqinit...<sup>2)</sup>

Dua të dal majë malit, të shoh gjithë Arbërinë,

vëllezërit shqipëtarë, që venë në pun' e vijnë,

1) gozhë druri, kunj

2) Është fjala për pushtimin me forcë të Ulqinit nga ushtria malazeze, që ngjalli shqetësim të madh aso kohe në Shqipëri.

burratë trima me besë dhe shpirtmir' e punëtorë  
dhe fushatë gjithë lule e maletë me dëborë.  
O fushazëtë pëllore, që m'ushqeni Shqipërinë,  
do të këndoj bukurinë tuaj dhe bujqësinë!  
Ti, perëndi e ligjërisë,<sup>1)</sup> që rri në mal të Tomorrit,  
unju posht' e më ndih pakë, o motra im' e të gjorit!  
Më ke leshrat e florinjta e të argjentë krahrorë,  
ball' e gush' e faq' e llërë dhe këmb' e duar dëborë;  
sindëkur do malësorët dhe pyjet e bagëtinë,  
duaj edhe fusharakët dhe arat e bujqësinë.  
Edhe ti, o Mëmëz e dheut, q'i fale dheut aq'uratë,  
sa pjell mijëra të mira e kurrë s'mbetetë thatë,  
i dhe lul' e bar e gjethe, bim' e drith' e pem' e drurë,  
mblodhe gjithë bukuritë edhe kanisk ia kc prurë.  
Të keqen, o symëshqerrë, shikomë një herë në syt,  
si lulet e si bilbili edhe unë jam djali yt!  
Gjithë këto farë lulesh e këtë të bukur erë,  
këtë blerim, këto ngjyra vallë nga ç'vend t'i kesh

O, sa e madhe bukuri! As më thua ku e more?  
O bukuroshe, t'u bëfsha, ngaha gjiri yt e nxore?...  
Kudo shkel këmbëza jote, gëzohet vendi e bleron,  
tekdo hedh sythin e qeshur, bukuri' atje lulëzon!  
Ti zbukuron faqen e dheut, si do e ushqen njerinë,  
më të gjallë dhe pas vdekjes e pret duke hapur gjinë.  
Vjen dimëri t'i than lulet, ti me një frys' i ngjall  
prapë,  
napënë, q'u hedh përsipër, ua heq me verë, me vapë.

1) Si edhe në raste të tjera, Naimi ndjek traditën klasike duke iu drejtuar zanës, «perëndisë» mitologjike të ligjërisë. Më tepër se me një besim, këtu kemi të bëjmë me një konvencion stilistik.

Bujkun e zgjuan me natë edhe vë përpara qetë,  
nisetë pa zbardhëlyer për punëzë të vërtetë,  
merr pluarin e parmendën, zgjedhën, tevliknë,  
hostenë,  
kafshën, farën, shoknë, bukën, trajstënë, lakrorë,  
genë...  
Shërbëtor' i Mëmës së dheut, q'e ka zemrën plot  
shpresë,  
del kur hapet trëndafili dhe bari është gjithë vesë...  
Pa u lodhur e pa u këputur, pa djersë e pa mundime  
njeriu i gjorë në jetë nuk gjen dot as thërrime...  
Ver', o e bucura verë, që na vjen nga i madhi zot,  
me mirësi, me bukuri. me gaz të madh, me duar plot,  
sindëkur çel trëndafilë e i fal bilbilit zënë,  
ashtu na bie nga qielli një gaz dhe në zemër  
tënë...

Ju, shokë, kur pini verën, mos dehi, mos zemërohi,  
mos u zihni, mos u shani, mos lëvdohi, mos qërtohi...  
Po gëzohi, prëhi, qeshni, duhi, zbaviti, dëfreni,  
flisni fjalë të pëlqyer, loni, këndoni, kërceni,  
bëjeni zemrën të gjerë, edhe shtonit dashurinë,  
mirësinë, njerëzinë dhe besën e miqësinë;  
se në breng' e në të keqe, në punë e në të pirë,  
merretë vesh njeriu i lik, njihetë njeriu i mirë.  
A e shihni gjithësinë? Yjtë, diellin, hënën,  
dhenë, erën, retë, kohën, Kashtën e Kumtërit, shenjën  
si janë përveshur gjithë edhe lëçijn'<sup>1)</sup>) e punojnë,  
njëri-jatërit i ndihin, ashtu punën e mbarojnë?  
Në mes të këtij rrëmeti, të punëtorëve shumë,  
njeriu duhet të lëçijë, apo të bjerë në gjumë?

---

1) lëvrijnë.

Mundohetë punëtori, po në zemërzë të qetë  
sa gaz të madh ndjen, kur njëra, që hodh, i pjell  
dymbëdhjetë!

Kur e sheh kallin' e plotë të kërrusurë nga barra,  
dhe parajsën e vërtetë të shfaqurë nëpër ara,  
kur hedh lëmën e mbledh toknë, ndan bykn'

e kashtën mënjanë,  
u hedh kuajve e qeve, që janë lodhur, të hanë,  
kur e përmbush plot shtëpinë me drith' e me gjë të gjallë.  
shtrohet me uri në bukë e ha me djersë në ballë,  
sheh pjergullnë, manë, fiknë, thanënë, arrën, ullinë,  
mollën, dardhën, pjeshkën, shegën, vadhenë, ftuan,  
qershinë,  
kumbullatë, zerdelinë ngarkuar në pemë gjithë,  
oborrë plot gjë të gjallë, shtëpinë mbushur me

drithë...  
Qysh roit blet' e uruar, dhe ven' e vijn' e lëcijnë,  
ca huallinë<sup>1)</sup> ndërtojnë, ca nëpër lule shkëndijnë.  
O, ç'punë me mënd punojnë! Sa bukur e bëjn' e mirë!  
Na japin dyllëtë, q'jep dritë dhe mjaltë thjesht'

ëmbëlsirë.  
Dhe punëtorët e mirë n'atë mënyrë punojnë.  
Edhe gjithë njerëzia me mundim t'atyre shkojnë,  
njëri mihi, jatëri lëron, njëri mbjell, jatëri prashit,  
kush tëharr, kush korr, kush mbledh duaj, kush  
shin, kush sharton, kush krasit,  
një bën pluar' e sëpatën, një parmandën, një

shtëpinë,  
një prët e qep, një merr e jep, një mbath, një shikon  
mullinë...  
Edh' ajo miza përdhese, ç'i duhetë për të ngrënë,

1) piten e mjaltit.

është rrahu e përpjekur me kohëz' e ka vënë!...  
Bujku mundohet në verë, po në dimër rri e prehet,  
sheh shtëpizënë me kamje dhe zemëra i bëhet.  
Gratë të gjitha punojnë n'avlëmend e në të tjera,  
edhe jashtë fryn e bie, po kur na trokëllin dera;  
është nj' udhëtar i gjorë, që ka mbetur në dëborë,  
i kanë ngrirë të mjerit vesh' e goj' e këmb' e dorë.  
Ngrihet i zot' i shtëpisë edhe të huajthin e merr,  
e vë në krye të vatrës me njerëzi, me të madh nder...  
Pa i bëjnë zjarr, e ngrohet, edh' e mbajnë me të mirë,  
i sjellin shtresë të flerë, edhe të ngrën' e të pirë.  
Kështu të huajt e miqtë njeriu, q'është i uruar,  
i pret me krahëror hapur e i përcjell të gëzuar.  
Në verë, që çelen lulet, qelli ndrin si pasqyrë,  
zbukurohet faq' e dheut e merr mijëra fytyrë,  
pa njallënë më çdo lule, më çdo bar e më çdo fletë  
gjérëra të gjalla me mijë, roitin nga dheu si bletë.  
Shpezt' e mizatë këndoijnë, kuajtë hingëlljinë,  
lulet e bukura m'erë si ar e si flori ndrijnë,  
bujku ngjet pendën e leron, mbjell e bën gati ugarë,  
kalorësi i shkon njatë dhe i thotë — puna mbarë! —  
Papo merr anën e lumit, me zemërë të gëzuar,  
këndon, fishkëllen, a vete ngadalë duke mejtuar,  
vë re lumin e kulluar, që ikën me ligjërimë,  
e ndër mend të tij bie ca t'ëmbla shumë mejtime.  
Vashazatë bukuroshe, posa shqerratë manare,  
si kaprollet e malit, si thëllëzat mitare,  
venë të lajnë në lumë gjithë tok duke kënduar,  
me gaz në sy e në buzë e me lulezë nér duar,  
përveshin llërët e bardha dhe të majm' e të perndijta<sup>1)</sup>.

---

1) hyjnore

pulpazëtë 'bukuroshe e këmbëzët e kërthijta;  
dallëndyshja, që fluturon e ndehetë përmbi lumë.  
u afrohet si mike e u thotë fjalë shumë;  
dhe mëshqerr' e përkëdhelur vjen në lumë të pij' ujë,  
a të prehetë në hije, a të bëjë gjë rrëmuje.  
Bari, bima vajtuar me brez, e bujku shum' i gözuar,  
si bariu kur merr kërthinë edh' e përkëdhel ndër duar.  
Bilbili ia thotë bukur, lumi vete gjithë valë...  
Veç një vashëzë e mjerë qan të motrën, q'e ka lënë,  
o, është mbuluar në dhe vashëza fytyrëhënë!  
Mëma dhe motëra mbetur në zi e në vaj të shumë,  
dhe shqerra manarez' e saj e përzishme e për lumë!  
Të këput shpirtinë plaka, kur zë dhe numëron e qan,  
ah, i ziu njeri në jetë sa heq e sa duron e mban!...  
Bukuri e saj u përzie me bukurizë të prillit,  
me fjalëzë të bilbilit, me erë të trëndafilit;  
gjësendi s'humbet kurrë, e gjë s'vdes me të vërtotë,  
mase ndryshohenë pak, po janë në këtë jetë...  
As shtohet, as pakësohet, as prishet gjithësia  
vdesin e ngjallen prapë si gjith' edhe njerëzia.  
Këtu janë gjithë q'janë e gjithë q'gjë mund të jetë  
engjellit, perënditë dhe ajy zot i vërtetë!  
Se një trup e një shpirt është gjithësia, që s'ka anë,  
të gjallë edhe të vdekur, gjithë brenda në të janë...')  
Det i paanë i mirësisë, q'emrin tënd s'e zë dot ngoje!  
Qysh e ngrehe gjithësinë pa lënë fare nevoje!  
Fali njeriut urtësinë, mirësinë, njerëzinë,  
butësinë, miqësinë, dashuri, vëllazërinë;  
epu shesheve lul' e bar dhe pyjeve gjeth e fletë,

---

1) Këtu dhe në krijimet e tjera shfaqen idetë e tij panteiste,  
sipas të cilave zoti është shkrirë me natyrën.

resë shi, arave bimë e mos lerë gjë të metë,  
fali erë trëndelinës, manushaqes, trëndafilit,  
kalliat bukë, mizës pjesë, zogut ngrënje, zë bilbilit,  
e drurëve epu pemë dhe uratë bagëtisë,  
dërgo dhëmbje e kujdes për to në zemër të njerëzisë,  
jepi pjergullës e vreshtit rrush dhe vozës fali verë,  
mos e lerë pa të kurrë, kurrë thatë mos e lerë,  
fali diellit flakë e zjarr dhe hënës e yjve dritë,  
edhe detit ujë e kripë, gjithësisë jetë e ditë,  
yjtë le të vijnë rrotull dhe njerëzit të punojnë,  
të dësfrejnë e të gëzohen dhe si vëllezër të shkojnë.  
Tregomu dhe shqipëtaret udhën e punës së mbarë,  
bashkomi, bëmi vëllezër, edhe thjeshtë shqipëtarë.  
Falmi, salmi Shqipërisë ditën e bardhë të lirisë,  
udhën e vëllazërisë, vahnë e gjithë mirësisë.  
Nxirr të vërtetën në shesh, paskëtaj të mbretërojë,  
errësira të përndahet, gënjeshtëra të pushojë.

# **Histori e Skënderbeut**

*(FRAGMENTE)*

## **I**

.....  
... Mbreti plak u hoq mënjanë,  
pa u ngrit një trim më këmbë,  
shikoi një her' anembanë,  
hekurin e haj me dhëmbë!  
Ish Kamani, q'ishte burrë,  
më trim nga gjithë të parët,  
nuk i trëmbej syri kurrë  
pa e donin shqipëtarët;  
i holl' isht' e pak' i gjatë,  
nukë kish shumë mustaqe,  
vij si i zeshk' e i thatë,  
e s'kish fare mish mbi faqe;  
kishte gjithë urtësinë,  
me një zë të ëmbël fliste,  
fjal' e tij e bind njerinë,  
dhe gjuha hekur' i priste.  
Mori kordhënë ndër duar

e qëndroi në mes si burrë  
me fytyrë t'ashpëruar,  
ngriti gishtin dhe tha: «Kurrë!  
Kurrë s'trembet Shqipëria,  
nukë vdiq, po ësht' e gjallë,  
tjetër përgjigje Turqia  
nukë do përveç me pallë!  
Shqipëtari, trim i vlerë,  
kurrë nuk' u frikësua,  
e të trëmbet këtë herë!  
Mbret, o zotthi im, ç'më thua?  
Apo s'e dimë Turqinë,  
nuk e kemi dhe mësuar,  
e s'ia njohëm djallëzinë  
gjer më sot që ka punuar?  
Na bën si miq këtë herë,  
se ka të tjera qëllime,  
mos pandehni të na lerë  
pa të këqij hidhërimë.  
Mjerë, mjer' ai i gjorë,  
që i sjell besë në fjalë,  
bie në lak e në dorë,  
edhe shpejt po s'mund të dalë.  
Mbret i ndershëm e ju shokë,  
mos harroni trimërinë,  
mblidhni mëndjenë në kokë,  
ngrihi të zëmë kufinë!  
Trimëria, trimëria,  
mban lirin' e Mëmëdhenë,  
unë shpreh te perëndia,  
t'i hedhimë përtej denë.  
Qysh të zëmë miqësinë

me atë që na bën varrë?  
Turku vëndet, gjith' e dimë,  
me ç'djallëzi i ka marrë,  
gjithënë kështu punojnë,  
kombet me lajka i ndajnë,  
pa miqësin' e harrojnë  
dhe një nga një i përlajnë;  
kur ka armiqë të tjerë  
të bën mik, sa t'i volitjë.  
A mbaroj ata një herë?  
Prite, vjen të të goditjë.  
Miqësira të vërteta  
s'ka njeriu i pabesë,  
përveç shpata dhe shigjeta,  
ato janë për ne shpresë...  
...Unë gjall' e me të gjallë  
s'mund të bëhem aq' i gjorë.  
A e shihni këtë pallë?  
Do të vdes me të në dorë!  
Se turpin e Shqipërisë  
s'e shoh dot me sy në jetë,  
dhe miqësin' e Turqisë  
kurrë s'e zë të vërtetë;  
trimëri në mos na mbeti,  
e më s'jemi shqipëtarë,  
të shuhet gjithë rrëmeti,  
se kjo është pun' e pangjarë.  
Një komb më mirë të vdesë,  
e kështu të mos dobëtohet,  
gur mbi gur le të mos mbesë  
dhe Mëmëdheu të shkretohet!  
A të gjall' e me nder të rrojmë,

apo në luftë të vdesim,  
a Mëmëdhenë shpëtojmë,  
a mbi të më të mos mbesim!...  
...Po ta bëjmë besa-besë,  
e të mblidhet Shqipëria,  
ahere le të na presë,  
ta shihni ç'është Turqia...  
...U përpinqën prindit tanë,  
e ruajtën Mëmëdhenë,  
edhe neve na e lanë,  
ashtu sikundër e gjenë.  
Kush merr atë turp taninë,  
që të humbasë për jetë?  
Pastaj ata që të vijnë  
ta gjejnë, qoftë lark, shkretë!  
Tani, burra shqipëtarë,  
pa kujtoni trimërinë,  
secili armët të marrë,  
e ta shohëmë Turqinë;  
delni, të dalim të tërë,  
t'i përgjigjemi Turqisë,  
pa e shihni si ta zërë  
udhën e mezit t'Azisë;  
dhe pastaj të mos guxojnë  
për këtej denë të hidhen  
po edhe kur t'u kujtojnë,  
laqet e gjunje t'u dridhen.  
Sot duhet trimëria,  
nukë duhet më mejtimi,  
lark Shqipërisë Turqia,  
pa tani duketë trimi!  
Sot neve në dor' e kemi,

t'i débojmë nga kufia,  
pastaj kush e di si jemi,  
mös të zëntë robëria!  
Kush ka shpirt prej shqipötari,  
si të parëtë që qenë,  
i bëhet zemra si zjarri,  
s'e do gjalljen e vel'henë.»  
Këtë fjalë duke thënë,  
erdh e mbyti mallëngjimi.  
dhe më nuk' e nxori zënë,  
po u egërsua trimi.  
Fjalën përnjëher' e preu,  
e lotët çurkë iu derdhë,  
të gjithë i mallëngjeu,  
të tërëve lotë u erdhë.  
U hoq edhe ndënj mënjanë  
i vrenjtur, i zemëruar,  
më nukë dëgjoj se ç'thanë,  
po vuri kokën nér duar...

## VI

Kruj' o qytet i bekuar!  
Prite, prite Skënderbenë,  
po vjen si pëllumb i shkruar,  
të shpëtojë Mëmëdhenë;  
shqipëtarët t'i shpëtojë,  
nga zgjedh' e keq' e Turqisë,  
edhe ty të të nderojë,  
që je kreu i Shqipërisë;  
ka pas trima shqipëtarë,

që s'u trembej syri kurrë,  
ndë zemër të tij ka zjarrë,  
ësht' i urt' e trim e burrë.  
Mirë se erdhe, o verë,  
që na prure mirësinë,  
dhe për shumë vjet të tjerë  
e zbukurofsh Shqipërinë!  
O Shqipërizë, gëzohu,  
se të erdhi prapë dita,  
lulëzohu, zbukurohu,  
të zbriti nga zoti drita.  
Edhe juve, o të vdekur,  
merrni nga ky gaz pjesë,  
që shkuatë buzëpjekur,  
n'atë jetë, paçi ndjesë!  
O moj vash' e Shqipërisë,  
që më rri duke mejtar,  
pa i zhvish rrobat e zisë  
arriti dit' e uruar!  
Zbardhi fusha, ndriti mali  
nga armët e trimërisë,  
hingëllint' e s'mbahej kali,  
që sill mbren' e Shqipërisë;  
trimatë bashkë me mbretnë  
me nxit posi vetëtimë  
u futn' e zunë qytetnë  
me të madhe kërcëllimë...  
...Shqipëria u lëshua,  
edhe iu derdhë qytetit;  
burrat trima më s'mënuan,  
gjith' u mblodhë posи reza,  
kryeqytetn' e rrëthuan,

armikn' e preu e zeza.  
Zjente bota, tundej dheu,  
u ngrit gjithë Shqipëria,  
duke thën': «Erdh Skënderbeu,  
erdhi vetë perëndia.»

Mysliman' e të krishterë  
u derdhë për Mëmëdhenë,  
e kishin të bashkë nderë,  
si vëllezër që qenë;  
pa zoti nuk i la shkretë,  
u bë mbret' i Shqipërisë  
trim' i mi' e i vërtetë,  
u mbarua koh' e zisë.  
Pleqtë, q'e kishinë parë  
në kohë të foshnjërisë,  
van' e puthën duke qarë  
dritëzën e pérëndisë.

Gjithë ç'qenë shqipëtarë  
me radhë mbretit i vanë,  
si vëllezër më të parë,  
e me gaz të madh panë.  
Skënderbeu bukuroshi,  
burri trim pa shok në jetë,  
miqtë gjith' i përshëndoshi,  
posi vëllath i vërfetë.

U sul gjithë njerëzia,  
të shihninë Skënderbenë,  
pleq, të rinx dhe foshnjëria  
gjith' e donin shumë mbrenë...

. . . . .

...Menjëherë Shqipëria  
e hoqi cipën e zisë;

doli në shesh mirësia,  
ra dritëz' e perëndisë.  
U hoq nata, erdhi dita,  
gazi, kamja, dashuria,  
e vërteta, miqësia...

.....  
...Pa këndo me émbëlsirë,  
o éngjëll i ligjërisë,  
atë burrë, trimn' e mirë,  
q'i dha aq nder Shqipërisë.  
Këndo, këndo Skënderbenë.  
që s'ka pasur shok në jetë,  
që lartësoi Mëmëdhenë,  
kordhëtari trim me fletë!  
Lum ti, Shqipëri, o lule!  
që pate trim të vërtetë,  
kurrë në turp nuk' u ngule,  
të la nder të madh për jetë.  
Mos ki keq, se kurdoherë  
do ta kesh ditën e mbarë,  
koha ty do të ta bjerë,  
si ta pat prurë më parë,  
po të dojë fati, plaku,  
të t'japë foshnjë të rezë,  
qumësht të bëhetë gjaku,  
dhe më s'sheh ditë të zezë.  
O kohë, që rrjedh si lumi,  
edhe s'rri gjékundi fare,  
as dremit, as të zë gjumi,  
dhe më t'errët hiqesh zvarë,  
hapu, hapu errësirë,  
të shoh mbren' e Shqipërisë,

trimn' e bukur e të mirë,  
nder' e gjithë njerëzisë,  
rrethuar me burra trima,  
shqipëtarë të vërtetë...  
Qysh duken yjtë, kur erret,  
që ndrijnë në hapësirë,  
edhe në mes të të tjerve  
hëna ndrin shumë më mirë,  
ashtu edhe ti më ndrije,  
mbret' i madh i Shqipërisë...  
Oshëtimë dha Tomori,  
edhe zjarr e flakë qiti,  
flaka qiellnë mori,  
gjithësia vetëtitë...  
Hodhë syt' e panë malë,  
dhe gjithë më këmb' u ngrenë,  
kur më der' u dha një djalë,  
tha: «Rrëmet i madh po vijnë!»  
Sé fjala kish marrë vraptë,  
pa kishte mbushurë dhenë,  
e hapi sa mundi çapnë  
dh'e dëgjuan gjithë ç'qenë.  
Shqipëria anembanë  
ish në dasm' e në gëzime,  
ditën e lirisë e panë,  
që e pritin pa durime.  
O liri e shënjtëruar,  
ëngjelli i perëndisë,  
erdhe me gëzim ndër duar,  
i dhe dritë Shqipërisë!  
Vallë, kur do të vish prapë,  
e të na sjellç atë ditë,

përse rri pshtjellë me napë?  
Pa hiqe, të shohëm dritë!  
Mbreti posi perëndia,  
ishte mbyturë në dritë  
rri ndaj soje bukuria,  
edhe gjithë mirësitë;  
mejtohej si të shpëtojë  
Mëmëdhenë nga myxyra,  
ta ngrer' e ta lartësojë,  
edhe i qeshte ftyra...

## VII

Zbrit, pa zbrit, o e vërtetë!  
Zbrit nga gjur' i perëndisë,  
jakë pakë tatëpjetë,  
t'u japsh dritë njerëzisë.  
Ta mësojnë shqipëtarët  
ç'ish Shqipëria njëherë,  
ç'burra qen ata të parët,  
të dëgjuar e të ndjerë.  
Mbretër dhe pleq e të parë,  
e gjithë sa trima erdhë,  
burra thjeshtë shqipëtarë,  
të tërë në mbledh' u derdhë.  
U ngrit mbret' i Shqipërisë  
edhe zu fjalën e mirë,  
shpirt i jepte njerëzisë  
zër' i tij plotë ëmbëlsirë.  
Tha: «Mbretër të dëgjuar,  
pleq të urtë e të ndjerë,

dhe ju shokë të lëvduar,  
djemt' e Mëmëdheut të vlerë!...  
Vdekja është shumë m'e mirë  
nga turpi, nga robëria,  
sa është pun' e pështirë  
të rrojmë si bagëtia!  
...Vdekja ësht' e mirë shumë  
ndaj kurthit e robërisë,  
q'e le njerinë për lumë,  
dh'e nxjerr jashtë njerëzisë.  
Shqipëtarë trim e burrë  
në zgjedhë nuk e ka vënë  
njeri dhe s'e vë dot kurrë,  
zoti mos e pastë thënë.  
Kini ndër mend trimërinë  
e kurrë mos e harroni,  
mizëri turqsh le të vijnë,  
as për gjë mos i peshoni.  
E kam gas e për lëvdatë,  
të vritem për Shqipërinë,  
të përpinqem dit' e natë,  
e t'i mërgoj ligësinë.  
Në jan' ata shqipëtarë,  
që i njoh e i di unë,  
bota po ka për të parë  
këtu një të madhe punë!...  
...I huaj s'e shkel dot kurrë  
dhe s'e merr dot Shqipërinë,  
se shqipëtarë është burrë,  
e tërë bota e dinë.  
Gjithë njerëzit, që janë,  
mbi Shqipëri të lëshohen,

për të bërë gjë po s'kanë,  
do të ikin, të tmerrohen,  
gjithënë në jetë s'mbesim  
dhe, sado që të mënojmë,  
më mirë me nder të vdesim,  
se me trup të madh të rrojmö...  
...Pa Muratit kur i thanë  
që u bë mbret Skënderbeu  
mbi gjithë mbretër që janë,  
i ra e zeza dh'e preu!  
Erdhi e t'u zgurdullua  
i ra rrufeja e pika  
dhe nga froni u rrëzua,  
iu hap zemëra nga frika,  
u këput e ra në truall,  
edhe shkumbëzon' e hiqte,  
u shtri përdhe posa buall,  
e këmbëtë i përpinqte!  
Po Turqia s'ra në gjumë,  
s'harroi e nuk mënoi,  
kohë s'shkoi as pak as shumë  
ushterin' e prëmëtoi.  
Tri dhe nga njëzet dy herë  
mijë burra luftëtarë,  
e përmbi gjithë të tjerë  
Ali pasha trim i parë,  
iu lëshuan Shqipërisë  
me të madhe kërcëllimë...  
Mbret i mirë, Skënderbeu,  
thirri me vrap parësinë,  
dhe njerëz të shpejtë kreu,  
mblodhi gjithë Shqipërinë:

të gjithë me vrap u derdhë,  
e me të madhe dëshirë,  
muarrë armët edh' erdhë  
te mbret' i tyre i mirë;  
lanë pla'knë dhe shtëpinë,  
edh' e bënë ditë natën,  
bariu la bagëtinë,  
edhe druvari sëpatën.

Po ti, o motra Marë,  
shpatënë më qaf' e vare,  
erdhe nga gjithë më parë,  
me gra trime shqipëtare.  
Mëmëdhe, o jetëgjatë,  
për shpëtimthin tënd njëherë  
lëftoninë edhe gratë  
e s'të lininë të mjerë.

U shkul gjithë Shqipëria,  
erdhë në Krujë te mbreti,  
parësi e vegjelia,  
sa u mbush gjithë qyteti...  
...Ali pasha ish i rëndë,  
shqipëtarët s'i peshonte,  
po rrinte brënda në tëndë;  
edhe së largu shikonte;  
pastaj mblodhi parësinë,  
u tha: «Sot do të lëftojmë,  
bëni gati ushtërinë,  
edhe më të mos mënojmë;  
neve mundëm mbretëritë  
e të gjithë njerëzinë,  
edhe sot, në këtë ditë,  
të peshojmë Shqipërinë!

Mbret është vetëm Murati,  
gjithë bota ësht' e tia,  
se ia ka falurë fati,  
ia ka dhënë perëndia!  
U zëntë buka që hani,  
po s'më zutë Skënderbenë  
e ta shpiem te sultani,  
pa të njohë vetëhenë!  
Kush të përpinqet, nderohet,  
bëhet i madh e i parë;  
mjerë kush të frikësohet,  
me thonj le ta hapi varrë!»  
Kështu tha i ashpëruar,  
ushtëtarët u ngrinë,  
edhe muarrën ndër duar  
armët' e bardha që ndrinë.  
Më të djathtë ca të parë,  
më të mëngjér ca të tjerë,  
vuri më shum' ushtëtarë  
Ali pasha, trim i ndjerë;  
me të shumët ndenji vetë,  
në mes të gjith' ushtërisë,  
me mijë njëzet e tetë,  
si rrebesch' i perëndisë!  
Skënderbeu m'anë tjetër  
me burratë shqipëtarë  
ushtërin' e ndan më katër,  
vë trima mbi ta të parë:  
më të djath' ish Moisiu  
me shumë burra të vlerë,  
Tanushi, këmishëziu,  
më të mëngjér me të tjerë,

e në mes vuri Uranë,  
lul' e trimërisë vetë,  
shumë shokë pas i vanë,  
gjithë burra të vërtetë...  
...Lufta u ndes me rrëmbime,  
me zë e me kërcëllimë,  
gjë s'dëgjohej, po gjëmime  
e nj' e madhe oshëtimë!  
Burratë gjith' egërsuar,  
papo gjak' donin të pinin,  
ishin me vdekje nér duar,  
gjalljenë s'donin ta dinin!...  
...Posa u derdh Skënderbeu  
me vrap posa vetëtima,  
turqit' e zeza i preu,  
më nuk ishin aqë trima.  
Si shqipja nér shpez kur bie,  
ata ikin e tmerrohen,  
frikë të madhe u shtie  
pa shihenë e qetohen.  
Mbreti posa yll i qeshur,  
bij' si rrufeja mbi trima,  
shpatënë e kishte zhveshur,  
pa ndrinte si vetëtima.  
Pasroje ishte Urani,  
që s'i trëmbej kurrë syri,  
gjak i rridhite jatagani,  
në mes t'armiqve hyri;  
edhe gjithë shqipëtarët  
me trimëri po lëftonin,  
i bënë copë barbarët,  
më s'mundninë të qëndronin...

Papo më nukë qëndruan;  
po u prishn' e u përhapnë,  
u trembn' e u frikësuan,  
ikën' e muarrë vrapnë,  
„U zëntë buka! Ku vini?» —  
thirri Ali pashë burri, —  
Qëndroni, shtini, godini!»  
po më sa dëgjonte guri.

Një turk me vrap i zu frenë,  
i tha: „Ikë, o i gjorë,  
shokëtë muarrë dhenë  
e do të biesh në dorë!»  
Pa shkoi dh' ai me të tjerët,  
q'ikn' e më s'panë nga vanë,  
si u përhapën të mjerët,  
njëri-tjetrinë s'e panë...

## 1898

ОКЛАХОМА  
ИЧУЛА

## A T D H E U<sup>1)</sup>

### Mëmëdhe

Mëmëdhe quhetë toka  
ku më ka rënurë koka,  
ku kam dashur mëm' e atë,  
ku më njeh dhe gur' i thatë,  
ku kam pasurë shtëpinë,  
ku kam njojtur perëndinë,  
strëgjyshët ku kanë qënë  
dhe varret q'i kanë vënë,  
ku jam rritur me thërrime,  
ku kam folur gjuhën time,  
ku kam fis e ku kam farë,  
ku kam qeshur, ku kam qarë,  
ku rroj me gaz e me shpresë,  
ku kam dëshirë të vdesë.

---

1) Nga libri «Baba Tomorri» 1902

## Shqipëtar!

Shqipërin' e mori turku,  
i vu zjarr!  
Shqipëtar, mos rri po duku,  
shqipëtar!

Mjaft punove për të tjerë,  
o fatkeq!  
Kujto vëndin tek ke lerë  
dhe tek heq.

Të ka bërë perëndia  
luftëtar,  
si s'të lodhi robëria,  
shqipëtar!

Erdhi dita të ngresh kokë,  
të kërkosh  
lirinë, bashkë me shokë  
të luftosh!

Mos bëni si keni bërë  
gjer më dje,  
po të luftoni të tërë  
për atdhe.

Pesëqind vjet kemi rruar  
me pahir,  
lidhurë nga këmb' e duar  
me zinxhir!...

Mysliman' e të krishterë  
jemi keq!  
Të ngrihem i që të tërë,  
djem e pleq!

Të ngrihem i të dëftojmë  
trimëri;  
ja të vdesim, ja të rrojmë  
për liri!

O moj Shqipëriz' e dashur,  
mëmëdhe,  
të shoh me buzë të plasur,  
si më sheh.

U shkretove anembanë,  
Shqipëri,

se shqipëtarëtë s'kanë  
dashuri.

Gjithë djemtë që ke qarë  
dhe mban zi,  
për Morenë janë vrarë,  
për Turqi!

Zhvish robat e robërisë,  
mëmëdhe,  
vish armët e trimërisë,  
se ke ne!

## Ku kemi lerë

Në ç'vend kemi lerë?  
Ku na bëjnë nderë?  
— Në Shqipëri.  
Po njeriu vetë,  
cinë do në jetë?  
— Do vënd' e tij.  
Ku i duket balta  
m'e ëmbël se mjalta?  
— Në Shqipëri.  
Ku rron me një shpresë?  
Ku kërkon të vdesë?  
— Në vënd të tij.  
Ku mund të gëzojë  
dhe me nder të rrojë?  
— Në Shqipëri.  
Përse të punojë  
dhe të lakëmojë?  
— Për vënd' e tij.

## Baba Tomori

. . . . .

O shqipëtarë të gjorë,  
dëgjoni Baba Tomorë:  
kombi juaj s'vete mbarë,  
se betë u kanë ndarë.  
Besa e bashkon njerinë,  
ju pse ndani perëndinë?  
Si ungjilli dhe kurani,  
nukë na dihetë fundi,  
me qiejtë mos u mbani,  
se nukë mbahen gjëkundi.  
Të krishter' e myslimanë  
gjithë një perëndi kanë;  
jini një gjak, mor të mjerë,  
se në një vënd kini lerë.  
Jini gjithë shqipëtarë,  
s'jini grekër as tartarë.  
Hiqni dorë nga rreziku,  
shihni se ç'punon armiku,  
i pabesi dhe i ligu.  
Mblidhuni të bëni benë,

të kujtoni Skënderbenë,  
të duani mëmëdhenë,  
të mos e lini të shkretë.  
Ngrihi ta shpëtoni vetë,

• • • • •  
Mës c peshoni Turqinë,  
mos e besoni Morenë;  
në duani perëndinë,  
të duani mëmëdhenë.  
Erdhi dita të lëftojmë  
për lirin' e Shqipërisë;  
ja të vdesëm, ja të rrojmë  
si burrat e trimërisë.

## Dëshir' e Skënderbeut ditën që vdiq

Sa rrojta, s'u turpëruam,  
të gjithë bashkë luftuam,  
vëndin tënë e nderuam,  
se nga turqit e shpëtuam.  
Po tani u afërua  
dit' e fundit dhe për mua.  
Gjithë këtë ditë presim,  
kemi ler' e do të vdesim:  
njeri për jetë s'ka mbetur,  
dheu të gjith' i ka tretur:  
po lum kush është përpjekur  
dhe për atdhenë ka vdekur.  
Ndaj desha, sa jam dhe gjallë,  
t'u mbledh, t'u them këto fjalë:  
O vëllezër shqipëtarë,  
u lutem të bëni mbarë,  
gjithë bashk' e të pandarë.  
Mysliman' e të krishterë  
perëndia<sup>1)</sup> na ka bërë,

1) Gjatë leximit vemë re se Çajupi, si dhe poetë të tjerë të Rilindjes, zë në gojë perëndinë. Kjo sepse i drejtohej një lexuesi që besonte në atë kohë, nga ana tjetër s'mund të mohojmë edhe inkosekuencat në pikëpamjet e tij.

jemi vëllezër të tërë.  
Zoti, kur bëri insanë  
me një fytyrë të naltë,  
të krishter' e myslimanë  
i gatoi nga një baltë.

• • • • •

Shoku shoknë mos e hani  
si punojn' ata që s'dinë;  
besa ësht' e gjithësisë,  
ne jemi të Shqipërisë,  
se kemi pirë një sisë.  
Për perëndi që besoni,  
Shqipërinë mos harroni,  
pra faluni si të doni...

• • • • •

Tani ta shpëtoni vetë,  
se unë nukë kam jetë.

## R o b ē r i a

E dashura mëmëdhe,  
të dua dhe kshtu si je!  
Po kur të të shoh të lirë  
do të të dua më mirë.

Qani pyje, fusha, gurë,  
qani male me dëborë!  
Shqipëria mbet e gjorë  
dhe nukë sheh dritë kurrë;  
një mjegull e keq' e shkretë  
e ka mbuluar përjetë!

Një gazep, një errësirë,  
vetëtit edhe gjëmon!  
Rojmë me zemër të ngrirë,  
nga frika kurkush s'gëzon!  
Njerzitë kurrë s'këndojnë  
dhe bilbilëtë vajtojnë!

Kiameti. shkretëtira!  
Zogu vete zë folenë,  
njeriu lë mëmëdhenë,  
se mbretëron egërsira!  
Për Shqipëri dëshërojmë  
se në vënd të huaj rojmë.

Robërinë si duron,  
o moj Shqipëri e mjerë?  
Shpëtove vënde të tjerë,  
vetë nënë zgjedhë rron!  
Shqipëtarë, bëni benë  
të lëftoni për atdhenë.

E dashura mëmëdhe,  
të dua dhe kshtu si je!  
Po kur të të shoh të lirë  
do të të dua më mirë!

## Besa-besë

Gjithë vëndetë gëzojnë,  
ti Shqipëri pse pushon?  
Gjithë njerzitë këndojnë,  
ti shqiptar pse rënkon?

Gjithë duanë lirinë  
dhe pa të njeriu s'rron;  
ti shqiptar Shqipérinë  
në zgjedhë si e duron?

Zgjohuni, o shqipëtarë,  
erdhi dita për liri!  
Zini luftë me barbarë,  
përpinqi për Shqipëri!

Të krishter' e myslimanë,  
të tërë një sua kemi;  
gëgë, toskë, dibranë,  
gjithë shqipëtarë jemi.

Mlidhuni të bëjmë benë,  
të gjithë dorë për dorë:  
të duamë mëmëdhenë  
edhe malet me dëborë.

. . . . .

Që ditën që u shkeli  
robëria dhe gjer sot  
nukë bën më bar Dhëmbeli  
dhe Tomori qan me lot.

Male me krye në qiell,  
si duroni robërinë?  
Ju që shihni drit' e diell,  
pse s'ndrini dhe Shqipërinë?

Ku janë vaftet e parë,  
që kini dhënë yrnek?  
Ku jini, o shqipëtarë,  
pse s'dëgjonet një dyfek?

Apo humbi trimëria,  
apo s'doni mëmëdhenë?  
A u shua Shqipëria,  
që ka pjellë Skënderbenë?

Pse rrini lidhur me lak?  
Pse s'shpëtoni vënd' tuaj?

Apo s'u mbeti më gjak,  
se e derdhtë për të huaj?

Mirri pushkëtë në duar  
edhe bëni besa-besë:  
Shqipëria do shpëtuar,  
kokë turku të mos mbesë!

## **Naim Frashëri**

Vdiq Naimi, vdiq Naimi,  
moj e mjera Shqipëri!  
Mëndjelarti, zëmërtrimi,  
vjershëtori si ai!

Vdiq Naimi, po vajtoni  
shqipëtarka, shqipëtarë!  
Naimnë kur ta kujtoni,  
mos pushoni duke qarë!

. . . . .

Vdiq Naimi, gjithë thonë,  
qani turq, qani kaurë!  
Bilbil' i gjuhësë tonë  
s'do të dëgjohet më kurrë!

Vdiq Naimi, që këndoi  
trimërinë, Skënderbenë,  
vdiq Naimi, që lëvdoi  
dhe nderoi mëmëdhenë!

Vdiq Naimi, po ç'të gjeti,  
o moj Shqipëri e mjerë!  
Vdiq Naimi, po kush mbeti?  
Si Naimi s'ka të tjerë.

Vdiq Naimi, vdekj' e shkretë,  
pse more të tillë burrë?  
I ndritë shpirti për jetë,  
mos i vdektë nami kurrë!

## **Fshati im**

Maletë me gurë,  
fushat me bar shumë,  
aratë me grurë,  
më tutje një lumë.

Fshati për karshi  
me kish' e me varre,  
rrotull ca shtëpi  
të vogëla fare.

Ujëtë të ftohtë,  
era pun' e madhe,  
bilbili ia thotë,  
gratë si sorkadhe.

Burrat nënë hie,  
lozin, kuvendojnë,  
pika që s'u bie,  
se nga gratë rrojnë!

Gratë venë nd'arë  
dhe në vreshta gratë,  
gruaja korr barë,  
punon dit' e natë.

Gratë në të shirë  
në të vjela gratë,  
ikin pa gdhirë,  
kthenenë me natë.

Gruaja për burrë  
digjetë në diell,  
punon e s'rri kurrë  
as ditën e diel.

O moj shqipëtarkë,  
që vet' e nget qetë,  
edhe drek' e darkë  
kthehet e bën vetë;

moj e mjera grua,  
ç'e do burrë zinë,  
që ftohet në krua  
dhe ti mban shtëpinë!

## Fyell' i bariut

Bariu, shokë, bariu,  
kur gjëmon e frys veriu,  
është përjashta fatziu,  
e rreh breshëri dhe shiu!  
Barinë, shokë, barinë,  
mos e harroni të zinë,  
se lë gruan e shtëpinë,  
t'u kullosë bagëtinë.  
Kullotni, moj bagëti,  
ti, ti, ti...  
Kullotni, biro, kullotni,  
kur të vdes të më kujtoni,  
ndjesë pastë të më thoni.

Shikoni barin' e gjorë:  
në diell a në dëborë,  
bariu me shkop në dorë  
ruan deshtë me këmborë.  
Vështronje barinë mirë,  
me të ngrën' e me të pirë,  
t'u marrë dhëntë pa għdirë,

t'i kulloſe me dëshirë,  
të rrijë bashkë me to,  
to, to, to,...  
Hani, moj, bagëti, hani,  
kur të vdes do të më qani,  
për mua zi do të mbani.

## ANSWER TO A QUESTION

1. *Alouatta palliata*  
2. *Alouatta seniculus*  
3. *Alouatta seniculus*  
4. *Alouatta seniculus*  
5. *Alouatta seniculus*  
6. *Alouatta seniculus*  
7. *Alouatta seniculus*  
8. *Alouatta seniculus*  
9. *Alouatta seniculus*  
10. *Alouatta seniculus*

## K u r b e t i

Mitrua, kur u martua,  
ndënji një muaj me grua!  
Erdhi dita pér të ndarë  
dhe u ndanë duke qarë!  
Gruaja qënkej me barrë  
dhe kur polli, bëri djalë.  
Po Mitrua ku ish vallë?  
Motëmot që qe larguar,  
një kartë s'i kish dërguar!  
Ku t'i shkruaj mëm' e mjerë  
pér djalënë që kish lerë?  
Tri vjet, katër, dhjetë shkuan!  
Mitrua harroi gruan!  
E varfëra se ç'pësoi,  
të ritë vëtëm e shkoi.  
Ç'e deshi të tillë burrë,  
që s'e pati pranë kurrë!  
Gjith' botë ven' e vinë,  
Mitrua harroi shtëpinë,  
nuk e di që ka dhe djalë!  
Rron a ka vdekurë vallë?  
Këto thosh grua e mjerë,

po burrit i mbajti nderë.  
E zeza grua se ç'hoqi!  
Humbi shpresën tek i shoqi;  
kur pa ngrën' e kur pa pirë,  
punoi e rriti të birë.  
Kurbeti, shokë kurbeti,  
kush vate e nukë mbeti?  
Mitrua zuri Misirë,  
po puna s'i vinte mirë.  
Qysh të vejë puna mbarë  
për të zeztë shqipëtarë?  
Shkretojënë mëmëdhenë,  
tek perndon dielli venë!  
Ku vini, more të mjerë,  
se sot s'është si njëherë,  
qysh vini në vend të huaj,  
kur s'dini as gjuhnë tuaj?  
Lum kush rron në vend të tij  
me qe, me dhën e me dhi.  
Mos u ndani nga shtëpia,  
të mos mpshojë\*) perëndia,  
se perëndia, kur mpshon,  
gjynaqarët i mundon.  
Puna nukë ka të sharë,  
po punoni vetë n'arë,  
zini çapën e hostenë  
dhe parmëndën që çan dhenë.  
Nga fëmia mos u ndani,  
po punoni që të hani;  
grurëtë që bëni vetë,

---

\*) të mpshojë — të zemërohet

u arrin për këtë jetë.  
Me zakonetë që kini,  
kurbenë duhct ta lini,  
të nderçim jini, të zotë,  
po nderi sot s'ka të shkuar,  
e drejta në këtë botë  
është fare shtrëmbëruar...

Në kurbet venë të tjerë,  
ata që s'duanë nderë,  
se zakonet u ndërruan:  
burri që fiton, shet gruan,  
burratë rrojnë nga gra!...

Po për Mitro shqipëtarë  
këto zakone të ra  
nuk i dukeshin mbarë.  
Ndaj hoqi e voi shumë,  
kur pa buk' e kur pa gjumë,  
rrahu Misirë të tërë,  
nukë la punë pa bërë,  
gjithë jetën nën urdhër,  
qeseja si kokë udhër!  
E shoqja e kish qarë,  
njëzet vjet që s'e kish parë,  
dhe në mos e paftë kurrë,  
djali ju rrit, u bë burrë  
mëmën do ta mbajë mirë  
me tëngrën' e me të pirë.  
Pas njëzet vjet, nga kursimi,  
Mitros ju shtua fitimi,  
solli ndër mënd Shqipërinë».

gruan e tij dhe shtëpinë;  
psherëtiti zëmr' e tij  
dhe qau si çilimi;  
dhe nesërmet, ndaj të gdhirë,  
Mitrua e la Misirë.  
Ta kish ditur, kur ish ndarë  
që la gruan me barrë,  
mbase kish ikur më parë.  
Shtatë dit' e shtatë net  
bëri Mitrua në def;  
mbaroi udhën e gjatë  
dhe vate në fshat me natë.  
Në shtëpi u afërua,  
ndënji pak e u mendua,  
dhe me vete të tij thosh:  
«Në gjeça shtëpinë bosh?  
Në mos e gjeça të gjallë  
gruanë!» Me këto fjalë  
shikon shtëpinë me dritë  
edhe vate në fëngjité\*)  
të shojë kush është brënda,  
t'i përgjojë ja ka énda.  
Djali kuvëndon me mëmë:  
«Pse qan, i thosh, kur ke mua?  
Ç'kanë shkuarë t'i lëmë  
dhe duajmë si të dua.  
— Të dua, thosh mëm' e njerë,  
me shpresë tënde kam rruar,  
nga ti harrova qederë  
dhe gjith ato që kam vuar,

---

\*) fengjia — dritare e vogël

dhe sot rroj me shpresë tënde.»  
Kur gjegji këto kuvënde,  
Mitrua ngriu në fengjité,  
fatziu, çvuri nér mënde!  
Vuri syn' e pa në dritë,  
pa një trim të ri me grua!  
Mëndia ju trubullua!  
Mitrua kujton Misirë,  
sheh vetëhenë me brirë!...  
O Mitro, mendoju mirë,  
mëma përkëdhel të birë,  
nukë të ka turpëruar,  
se me nder të madh ka rruar!  
Ç'mendonesh, more fatzi,  
hyrë brënda në shtëpi  
dhe merr djalënë në gji.  
«Obobo! Sytë ç'më panë!  
tha Mitrua si i marrë.  
Pashë gruan me jaranë,  
po tanë do t'u bëj varrë!  
Do t'u bie me kobure,  
t'i lëshoj në shesh shondure.<sup>4)</sup>  
Mua të më vënë brirë!»,  
tha, dhe goditi të birë...  
Mëm' e zezë ulëriti,  
pushtoi djalën dhe briti  
po Mitrua nukë priti:  
pushka krisi dhe një herë,  
ra përbys dhe mëm' e mjerë!

---

\*) shondure — pa shpirt, pa jetë

## K o r r i k u<sup>1)</sup>

Na erdhi korriku prapë  
mè grurë të ri, me vapë.  
Mirë q'erdhe, o korrik,  
gjithë bota të ka mik,  
të duanë varfëria,  
se s'vdes njeri nga uria.  
Korriku, si flak' e drizit,  
na ngroh palcën e kurrizit.  
O korrik, o faqezjarr,  
gjithë lule, gjithë bar,  
dhe me penë barrë-barrë,  
s'dimë c'të hamë më parë.  
Në korrik piqen me radhë  
pjeshkë, mollë, thanë, dardhë;  
kur afrohet korriku,  
zë të piqetë dhe fiku.  
Nga gjithë pemët e tjera,  
fiku na mbiftë te dera,  
se gjersa ka shporta fiq,  
gjithë bota janë miq...  
Me shpresë të këtij muaji,  
punëtor, puno e vuaj.

---

1) U botua më 1903.

Të punojmë që të gjithë,  
të mos mbetemi pa drithë,  
se në këtë muaj zoti  
na kërren nga tërë moti.  
Ata që kanë punuar,  
në korrik janë gëzuar,  
se në këtë deli muai  
nuk ka lëmë pa duaj.  
Vjen korriku! Punëtorë  
mirri drapërin në dorë,  
të korrij kush ka punuar,  
kush ka mbjell' e ka lëruar.  
Dilni, dilni nëpër ara  
e shihni ç'ka bërë fara:  
shikoni një koqe gruri  
se sa koqe grurë pruri.  
Shikoni kallinjt' e verdhë,  
në korrik duhenë mbledhë.  
Shihni, shihni kur fryn era,  
kallinjtë lozin si shtjerra;  
me diell, kur fryn veriu,  
si floriri ndrit kalliu,  
fusha, ara, palë-palë,  
duken si deti me valë.

Fush' e gjatë, fush' e gjerë,  
pse më bën të qaj ngaherë,  
me djersën e varfërisë  
gjith' arat e Shqipërisë  
vaditen e gjë s'kërrejnë,  
se të huajt' i rrëmbejnë!

Shqipëtari, dëm e kotë,  
punon gjithënë për botë:  
arat që mbjell, ngaherë  
vjen' e i korrin të tjerë!  
O korrik, o faqezjarr,  
je dukur dhe luftëtar:  
në Francë, kush nuk e di,  
u ngre vëndi për liri;  
në korrik lufta u zu,  
u bë gjaku gjer në gju...  
Kryeqitjet q'u bënë,  
prej korriku janë zënë;  
se zjarrë që ndez korriku,  
nuk e shuan dot armiku;  
se dielli është i ngrohtë,  
ndez gjakun në gjithë botë.  
Gjaku i trimit vërtetë  
për liri ndizetë vetë,  
gjakut yt, o shqipëtar,  
s'të ndizet as në behar!  
Të ndeztë vap' e korrikut,  
ti biesh në kok' armikut!

**PASHKO VASA**

ASAV OAHUAT

## O moj Shqypni

O moj Shqypni, e mjera Shqypni,  
kush të ka qitun me krye n'hi?  
Ti ke pas' kenë nji zoj' e randë,  
burrat e dheut të thirrshin nanë;  
ke pas shum' t'mira e begati,  
me varza t'bukura e me djelm t'ri,  
gja e vend shumë, ara e bashtina,  
me armë t'bardha, e më pushka ltina,  
me burra trima, me gra të dlira  
ti ndër gjith' shoqet ke ken ma e mira.  
Kur kristë pushka si shkrepët moti,  
zogu i shqyptarit gjithmon' i zoti  
ka ken' për luftë e n' luft' ka dekun  
e dhune mbrapa kurr' s'i ka mbetun.  
Kur ka lidh'besën burr' i Shqypnisë,  
i ka shti dridhjen gjith' Rumelisë;  
ndër lufta t'rrepta gjithkund ka ra,  
me faqe t'bardhë gjithmon' asht da.  
Por sot, Shqypni, pa m'mthuej si je,  
po sikur lisi rr xuem përdhe.  
Shkon bota sipri, me kamb' të shklet,  
e nji fjal' t'ambël askush s'ta flet.

Si mal me borë, si fush' me lule  
ke pas ken' veshun, sot je ndër crule,  
e s'të ka mbetun as em'n as besë;  
vet' i ke prishun pér faqe t'zezë.  
Shqyptar', me vllazën jeni tuj u vra,  
ndër njëqind çeta jeni shpérnda.<sup>1)</sup>  
Sa thon<sup>2)</sup>, kam fe, sa thonë kam din,<sup>2)</sup>  
njeni: jam turk, thot', tjetri: latin.  
Do quhen grek e shkje disa tjerë,  
por jeni vllazën t'gjithë, more t'mjerë!  
Priftnit e hoxhët ju kan' hutue,  
pér me ju danum, me ju vorfnue!  
Vjen njer' i huej e ju rri n'votër,  
me ju turpnu' me gru' e me motër;  
e pér sa pare që doni t'fitoni,  
besën e t'parëve t'gjith e harroni,  
baheni robt e nierit t'huej,  
që nuk ka gjuhën as gjakun tuej.  
Kjani ju shpata e ju dufeqe,  
se u zu Shqypnia si zog ndër leqe!  
Kjani ju trima bashkë me ne,  
se ra Shqypnia me faqe n'dhe!  
E s'i ka mbetun as trup as mish,  
as zjerm në votër, as drit' as pishë;  
as gjak në faqe, as nder ndër shokë,  
por asht gremisun, ashtu bamun trokë.  
Mblidhnju ju varza, mblidhnju ju gra,  
m'ata sy t'bukur që dini me kja,  
eni t'vajtojmë Shqypnin e mjerë;

---

1) çeta — parti

2) din (turq.) — fe

që mbet' e shkret' pa emën, pa nder!  
Ka mbet e vej si grue pa burrë,  
ka mbet si nanë, që s'pat djelmë kurië!  
Kujt i ban zemra m'e e lan' me dekë  
kët far' trimneshet, që sot asht mekë?  
Kët nan' të dashtun a do ta lamë,  
që njeri i huej ta shklas' me kambë?  
Nuk, nuk! Kët marre askush s'e do,  
kët faqe t'zezë gjithkush e dro!  
Para se t'hupet kështu Shqypnia,  
me pushkë n'dorë le t'des 'trimnia!  
Çonju, shqyptarë, prej gjumit çonju,  
të gjith', si vllazën, n'nji bes' shtrëngonju,  
e mos shikjoni kisha e xhamia;  
fe e shqyptarit asht shqyptaria!

**1879**

À DÉS MOI MINONNE,

# NGA KËNGËT E MILOSAOS

*fragmente*

## Kënga II

Vreshtat ishin verdhëllore.  
Erdh nga mali dhelpëra  
me të lodhurat të bijat,  
me të mbaruar të vjelat;  
e athere kur ndër sheshe  
fshihet dielli (si nën tokë  
mëmat që kënduan në valle),  
në Fjokat unë rashë.  
E përveshur e e lartë,  
me gërshet të pleksur  
në një lidhëse të bardhë,  
ish te kroi një vash'. Te balli  
një mendim i kishte hie.  
I lidhur te brezi i kaltër,

mbi truall i çik mandili.  
Posa që më ndjejti,  
vasha drejt nga unë u suall,  
gjifryrë edhe plot hie,  
me një të trembur hare.  
Trimi: — Vajzë, a m'ep ti një pikë ujë?  
Vajza: — Sa të duash ti, bir zoti.  
— Kuja bijë je ti, vashë?  
Mos më je nga dheu i huaj?  
Kur djalosh, nü Selanik  
vajta, vashëzat nuk ishin  
në katund me kaqë hir.  
Në çeret e ndezur,  
vucën ajo ngrinte:  
— Jam e bijë e Kollogresë,  
ngriti ballët e zbuluar.  
Duke shkuar asaj udhe,  
gjembat që vareshin udhës  
s'e gërvishtnin atë çupë:  
me llërët përgjakur,  
unë nga ballët ia reshtja.  
Dy buzë të qeshura,  
njëj here të bardhë,  
atë mbrëmje dukeshim.

## Këngë

E bija e Kollogresë, duke kënduar diellin e hënën,  
natyrën e vendit të saj shfaq dashurinë që ka nisur t'i  
zjejë brenda pér «atë të pamë», pér Milosaon. (I) E bija  
e Kollogresë me shoqet, duke punuar në ara, shikojnë  
Milosaon me shokë dhe i drejtohen me këtë këngë. (II)  
E treta është kënga që Milosaoja dhe shokët e tij shko-  
dranë u këndojnë vashave, si përgjigje. (III).

20 shkurt 1426

### I

Si ndrit dhe qielli përmbi kodrën tënë!  
Atje sipër gështënjas përmbi fshat,  
me një yll tok u ngrit e bardha hënë;  
atje dhe dielli ndëhet, zotëron,  
si një që pamë e në gji na qëndron!

## II

20 prill 1426

Arat vallzojnë agimit e era buar<sup>1)</sup>  
çdo gjurmë bishe fushës së vëtmuar.  
Me shokët ti në hije pakëz rri,  
o qipariz bujarësh, syulli.  
Sa ty të njohëm, zemëra na mbet  
që tash e gjer në mbrëmje në qytet.  
Atje si dielli qillit kur kalon,  
ti ndër bujarët, jetën hijeshon!

## III

S'jam hijesha unë për qytet,  
rreth i bujarve më mërzit, dh'andajë  
me shi e diell fushës një re ndjek.  
Sa bota vlen për mua vashë e bardhë,  
prej gjakut të kulluar e fatbardhë,  
që hiri i pastër aq e hijeshoi,  
ku dy limonj<sup>2)</sup> nga malli më dhuroi.

---

1) buar — humbi, zhduku

2) dy limonj — në botimin e parë vasha i dhuron trimit «dy mollë» (k. IV).

## Këng a V

Përse të venë në det  
mendimet, zemëra ime?  
Zbardhuan anijeza,  
panë këndej e u fshehën...  
Erdhi dita e Arbërit!  
Doemos do vdesim  
në shtrat, në mos rënçim  
përpara shtëpive tona  
e nën dhe do na harrojnë  
shokët e vëllezërit,  
krojet e katundi ynë.  
Tani që nata e zezë  
me shiun e saj të butë  
kudo i përbalti udhët,  
hapnie ju derën  
tek të pérhedhurat çupa  
lozin të harruara.  
Vasha forëmadhja  
ma rrëmbeft' nga dora  
atë buzëhieshmen  
e ma sjelltë mua përpara.  
Kanë pér t'i u ndezur faqet

me atë shenjëzën në mes,  
kur e drojtur të më qeshë.  
Veç në sy të shihemi,  
pa dhe bota të përmbyset.

## Këng a VI

Ra bora mbi det  
e ndër leshterieq e zbardhi  
kraht' e shqitëzës.  
Gjumi mua më lodh:  
thuajse trupi më largohet,  
si një gruaje që, Marbelës,  
mbrëmjes, i largohet  
zhurma e trokashkave  
dhe të lehurit e qenve  
mbi mullinjtë, e sheh si shuhet  
zjarri i ndizet vreshtave.  
Jeta akoma s'fjet.  
O, vasha kryegështenjë  
shtratin butë të ma shtronte,  
pra të vihej duke tjerrë  
gjysmë në terr e në dritë,  
me këngë në gojë!  
Të harroja se nën borë  
biren krojet e të mbjellat  
që na mbajnë jetën;  
edhe djemtë e zonjave  
Samërankut, që gumojnë

me tambur vreshtën e largët  
e i thonë: — Ne të ruajm'!  
I kotur do ëndërritja  
se, përdore, fushave  
vemë dhe shtëpitë e njerzve  
na faniten më të aguar  
edhe yjt na lënë;  
apo se më zgjidhet kali  
dhe shkon te një trumë gra,  
që shpérndahen, veç asaj  
që i zë lakun e përtrollëm:  
syri i bukur i njeriut,  
dhe vështrimi i tij e zbut.  
Krahërorin e dërsitur  
ajo e fshin me mandil  
e skuqur se po ma shohin.  
Ajo vashë zakonbukur  
nuk leu ndër të mëndafshata;  
porse mua, kur zbardh dita,  
në një kasolle të lënë  
e të hapur ernave,  
prej ku duken, nëpër të,  
brinja e bardhë, malet, lumi,  
fort ma kënda ta kem pranë  
vajzën që më mori zemrën;  
ajo mua më ka hije.

## Kënga VIII

Mu në mes të gurëve  
mbiu një re manushaqesh,  
shenjë e pranverës së bardhë:  
me gazmend i venë vesh  
zhurmërimësë së lumit.  
Pa një re mali me borë  
u buthtohet njerëzve:  
ata lutin për të korra.  
Këtij dimri kam pushuar  
si thëllëza te foleja.  
Ngriti degt' ulliri i shkundur  
edhe vashëza e bukur,  
harruar vëllezërve,  
duketë në valle  
vetëm kur unë e dredh.  
Botë e madhe, që s'qetohet  
ernave dhe fjalëve,  
atë e ka si llambadhe  
që hieshon shelqërorin,  
po që jashta shpis' nuk ndrin.  
Kur i ngrija fshehur grackat,  
qullurë, ullishtave,  
sa mezi që merrja frymë

po t'i tundte era vadhet;  
lutja per hirin e memes  
qe te zija mbremanet  
plot me zogj te gjallë.  
Shkonte vasha mespurtekë.  
shtija gur e me mallkonte.  
Pra qe u rrit, — si me rrëmbeu!  
Kur e shoh, me ikën mendja,  
dridhem e nuk marr dot frymë.  
Dita ka diellin qe e zbardh  
para syve tanë,  
porse ç'yll e ruan vashën  
edhe mua në këtë mall?  
Kur un' dal te Shureza,  
vucën merr e vjen te lumi,  
porse mb'udhë e trembur  
kthehet e vështron katundin.  
Luleja e celur  
një te hënë pot hare,  
t'enjten, duke u bërë e bardhë,  
ku ta dish a e sheh te dielën.

## Këng a XI

Duro, zemër, e duro  
sa duroi mali me borë.  
Shkrepëtinë nëntë diej,  
zbardhëlluan kumbullat;  
trimi nga katundi i largët  
doli e i pa menatë  
dhe harroi shtëpinë.  
— Lumi unë! — thoshte mali.  
Si ai qelqi, që m'i fryn,  
bjerr ndriçimin nga hukatja,  
porse brenda gjithë ndrit,  
ashtu është vajzë e mjerë.  
Ka vetëm t'ëmën e t'anë.  
Ata e duan. Kujt t'i thotë  
«po», në mos u thëntë atyre?  
Ajo lë fshatin e quhet  
nuse e trimit huaj.  
Po na vjen një ditë e kthjellët,  
që t'ulet ashtu në derë,  
të më qepë linjëzën.  
Vështron detin:  
fluturojnë dallëndyshet;

é vihet e më këndon  
këngët që i thosha vetë  
nd'atë mot që duheshimi;  
e harron zotin e saj,  
më unj kryet e në mend  
sjell fytyrën time.  
Ja, si bregu i braktisur  
gjëmbave e thëllëzave,  
ku vinë e ndërtojnë njerezit  
një katund plot hieshi  
te luginat gjelbërore,  
është malli i trimave.  
E stolisur, në mes grave,  
vajza del për t'u martuar,  
edhe lindin djem sydritë.

## Kënga XII

Si suvala e detit  
e turbullt' e si një mal,  
nuk pyet më për anijen,  
ashtu dhe gratë në krua,  
o te lumi, o për shkarpa,  
flasin për çupën e varfër,  
që i biri i zonjës madhe  
e don dhe dashurohet.  
Vasha rrinte gjithë turp  
vetëm me gjitonet;  
ato ktheheshin nga puna  
mbrëmanet e veç për linja  
flisnin, për shami e fustane.  
Një të diele menatë  
e gjeta në Korqiollo:  
— Trim, ti mua në më do fort,  
udhëve të mos më pjekësh,  
ndër shoqe mos më vështrosh,  
— Vashë, malli im i parë.  
unë i mjeri s'e pandeha  
që kështu të bëja dhunë.  
— Mos u qaj, o ti bir zoti,

mos bëj që të jem fajtore  
për lotët që s'duhen derdhur:  
s'dëmtove të varfërën,  
as helmove çupat,  
njeriu s'i bëre keq.

100-38140-23

Wiederholung  
der Spurenbildung  
begleitet von der  
entfernen Veränderung  
der Stoffe und die  
Vereinfachung des  
Abbaus. Diese Ver-  
änderungen sind  
durchaus verschieden  
und es kann nicht  
vorausgesagt werden,  
ob ein bestimmtes  
Gesetz für alle Stoffe  
gültig ist. Es ist  
aber wahrscheinlich,  
daß die Abbaustufen  
für alle Stoffe gleich  
sind, und daß die  
Unterschiede nur  
durch die verschiedene  
Art der Zersetzung  
bedingt werden.

— — — — —  
— — — — —  
— — — — —  
— — — — —  
— — — — —

## Këngë XIV

Pasi dielli i rante shtrati;  
m'u pataks e mjera:  
vuri shpejt të veshurat,  
dual nga rrrij i biri i zotit.  
Era ngrinte pluhurin  
e e shfrynte murevë;  
asnjeri s'kalonte andej.  
Por atje, te buzë e udhës,  
Rina flit, vetëm në vatër:  
— Ku ta dish në do të shkojë  
trimi i hieshëm më ksaj udhe!  
Fatmiroshe apo n'Greqi  
zërin që i dëgjojnë!  
Vate! — tha me vetëhe,  
u kthyte në shpi,  
mori tërkuzën e trastën  
e më vajti nga ullinjtë:  
mblidh ullinj e qante.  
Pasi shkundi pesë ullinj,  
tek i pesti, në shullë,  
ndejt e e zuri gjumi.  
Trimi në ëndërr m'iu duk

që i doli udhës lumit.  
Fushat ishin plot me borë,  
rrobat mbi krah i pikonin.  
— Me ktë mot ke bërë finjën?  
Si të janë skuqur duart!  
Vasha vu buzën në gaz,  
Kur, — ia bëhu një erë e fortë,  
shkundi born' e drurëve,  
e përflaku porsi valë  
e të kaltër si një det  
poshtë kodrave e hapi.  
Vate dhe trimi, i rrëmbyer!  
Te një spart ajo u zu:  
pas e ruajti e larg e pa  
si një flutur përmbi ujët,  
që tundet e, vende-vende,  
zbardhon së këputuri...  
Por se u ngrit veriu i ftohtë,  
që m'i ngriu zverkëtin  
edhe gjurin e zbuluar, —  
m'i këputi gjumin.


## Këng a XVII

Shtëpi tona të shpërndara,  
do t'ju shoh pasnesër.  
Do shoh bregn' e Rakanielit  
e vashat që lajnë.  
Nesër ndaj të ndrysur  
shkon vasha nga dera ime  
edhe sheh shumë hare;  
pyet: — Ç'është kjo hare?  
— Ësht' hareja e t'bir të zotit,  
që po na vjen nesër.  
Zemra vashës i kërcen.  
Mblidhet tek të motrat,  
ulet, ngrihet, del te dera.  
Nga çdo anë sheh plot zjarre:  
çunat, me urë në dorë,  
ndjekin udhve lakuriqët.  
Shëndrit vasha prej hareje,  
porsi djali<sup>1)</sup> një mëngjesi,  
që gdhihet me gaz.  
Përmbi shtratin e mëndafshët,

---

1) Në kuptimin: djali i vogël, fëmija.

drita që m'i ndehet,  
m'i këput atija gjumin.  
Sheh të ëmën nëpër shpi  
me gërshet të shpleksur  
e me lidhëse në dorë;  
mbi tryezë sheh pasqyrën;  
brof<sup>4</sup> në këmbë, se kujton,  
trimatë në Shurezët  
e stolitë e vashave  
përgjunjur në Shëndëlli  
përpara Mesosporites.



## **Vjershë e bijës së kollogresë**

Isha në vallet e i ndryshuar erdhe:  
më shture sytë e m'u errësuajeta.  
Mos e ki rëndë, o diell, kjo re e lënë  
në të takoftë e ndrin dhe ajo një herë.

## Këng a XX

Gjethet ishin si të mpira,  
dielli i fshehur resh,  
zemr' e grave pa dëshirë,  
kur, — ia dha një shkundullim.  
Ullinjtë e thyer,  
shtëpitë e rrëzuara,  
njerzit i braktisën  
mërisë së dheut.  
Ulérinin egërsirat.  
Përmes gjindjes së tmerruar,  
që sillej, përpiquej udhës,  
asaj nate të pabesë  
kam diktuar vashëzën,  
vashëzën meshollëzën,  
atë kryegështenjëzën.  
Si ai që një yll të qetë  
sheh e zemërën ia ngroh,  
yll që thot': «Vështromni dritën,  
bota nuk do të shkallmohet», —  
bardhëllore unë e pashë.  
Vajza: — O i bardhë bir bujari,  
në më merr, ku po më shpie?

Unë s'jam një zonjë e madhe  
si mizorja jot kunatë.

Trimi: — Shkodra më s'thuhet qytet;  
përtej malit gjejmë priftër  
që të na martojnë.

Un' me shigjetë e parmendë,  
ti kasollen të më ruash  
edhe rrobat të më lash,  
vetëm për mua të vetmin.

## Këng a XXII

Bie, por s'dua tē fle.  
Mos e mbyll ti derën,  
le tē hyjë era e detit,  
tē më ftohë, si më ftoh  
vashëzat më tē prashitur;  
le tē hyjë dielli,  
që te vatrat, i pafaj,  
na u rri pranë mëmave,  
u kujton kohën e shkuar.  
Vajzën me shtatin e bukur  
unë tē dashur e mata  
e m'i leu një djal' që i ngjet.  
Me hare në këtë shpi  
ajo përkund djepthin  
e mua brezin më qendis. —  
Bie, por s'dua tē fle,  
Si drita në qiell e syu  
në kurm tē njeriut,  
kur e sheh tē pamenduar,  
ajo shpisë i ka hie.  
Ditët e mia fatmira,  
do kujtoheni mbi dhe

si këta brigje e lumenj,  
që të mocëm do t'u duken  
atyre që do të lejnë. —  
Bie, por s'dua të fle.

卷之三

## Këng a XXV

Dy dit' mjegull edhe shi  
verën dojin të na reshtin;  
tek e katra, ndër lëmenj,  
shtruan duajtë në diell.  
Unë, vetëm, i helmuar,  
vajta gjer te Shureza,  
ndejta te bythë e ullirit.  
Një trumë stërqokash vinin  
kashtonjës, duke u çirrur  
aqë sa brofa në këmbë.  
Pyllit takënte  
sëpata e grave;  
këngë vinin vreshtave;  
bota dukej të kish lerë  
asaja menate. —  
O e bukura motra ime,  
mos ka rrush te varri yt?  
Vend të bukur në të dhanë,  
prapë s'shtrihesh dot e lumtur.  
Pse s'rri përherë me mua?  
Kurmi i saj i bërë pluhur  
nëpër rroba i ka rënë

e këto fjälë s'i ndjen.  
Zoti i dherave të shuma,  
që dha ditën plot dëshirë,  
më vështroftë dhembshurisht,  
këtë jetë ma këputtë,  
të më dalë dorës tij!

— — — — —

## Këngë XXVIII

Ranë këmborë e tambure.  
Me një vel të zi në krye,  
ime motër maste  
një trëmbë lesh e mëndafsh,  
që e kish tisur vetë mëma.  
Trimit që do i mirr të bijën,  
ia kish tisur për shatore,  
që ta hapte natën  
ushtrisë kur t'i printe;  
por s'e dinte motra ime  
e prandaja, e harruar,  
filli vetëm kujtoj mëmën,  
kryepluhurosurën  
e që s'nihej më te varri;  
iu veshën sytë me lot.  
Ish pa jetë si piktura,  
që mbi shtratn' e nuses  
në mesditë i qesh shtëpisë  
e s'e ndjen kurmin e saj  
me atë flok të bukur.  
Ulur pranë, unë e vështroja.  
Mëdhështorja mëma ime

pat besuar që me ushitri  
arbërët unë t'i ndihja;  
e la besa edhe vdiq.

E kujtova dhe, nga duket  
kopshti, u ktheva e qava.

Arat e prashitura  
shiu i butë i bunarte.

Kajisia me lule  
frushullonte si një valle  
që ulet e më pret nusein,  
pret të dielat plot fruta.

Motra: — Ja tryesa e shtruar,  
froni pranë, o vëlla;  
Najde, ngushëllahu,  
kaq i ri dhe veç helmuar!

Milosao: — Motra ime e vogëla,  
pasi m'ujdise shtëpinë,  
po të shoh të lodhur, vetëm,  
e që s'të hedh syt' njeri...

— Lavdi pastë në qiell zoti,  
që na mori zonjën mëmë!...

Kur të na kujtojë ajo  
nga vendi i paqes,  
njësoj është... — Ti je e lumtur,  
se gjithnjë si desh e mjera  
bëre: ditënë punove,  
natën fjete, si një dritë  
që ndizet edhe shkëlqen  
gjersa shuhet, edhe botës  
më s'i lypset. Mua mëmën  
një e huaj ma largoi.

— Mëma pat shumë gjëzime,

porsé ajo motér e mjerë,  
punëtore e varsfér,  
i la shtatin tim vëllai  
si drita që rri tek ylli.  
Ç'e mërzit të zezën?  
Përse nuk e lë të qetë,  
pasi të gjithë e harruan?  
Sa e bukur kishte lerë!...  
Sa hie në ato zakone!...

## Këng a XXIX

Ujërat menë, ra veriu,  
male dhe sheshe u veshën.  
Si udhën e engjilit, verë,  
të shoh edhe trembem.  
Djempt', që botën shtrigë  
njojur nuk e kanë, qeshin  
porsi shqerrat në livadhe.  
Degt' e trëndafilave  
shkundin vesën edhe vashës  
mbi gërshetëthin i bie,  
që pleksi me vjollca;  
bie mbi foshnjën e fqinjës  
që i lot te prehëri.  
Ajo e puth e më skuqet,  
se mendon te djali i mallit,  
që një ditë do t'i lejë.  
Pelat zbuten për të hipur;  
burri shkul pendët e zogjve  
të stolisë kryet;  
si veriu që përthan lulet,  
ai prish një shesh me sirq,  
që një rrobezë të bëjë; —

fatbardhë sikur të tiste  
rrezet e diellit vetë!  
Vera e magjeps më shumë;  
lule të bardha, lule të verdha,  
të përhapura, të vjerra,  
duan veç gojë t'i flasin.

2.122-Sub B

## Këng a XXX

Fryjti era e maleve  
dhe rrëzoi hien e lisit.  
Gjaku im te Lumi i Vodhit.  
Hapeni shatoren,  
o ushtarë, që të shoh  
Shkodrën edhe time motër  
te dritarja kundruall.  
Atje nuk do zgjohem më  
luleve që i tund era  
si suvalë e pasosur.  
Mblidhen shokët mbrëmanet  
në katund, në vatërët. —  
I lashë si ëndërrëz.

Mbaroi Milosaoja.

1836-1873

# **SKENDERBEU I PAFAN**

## **Rrëfimi i Gjon Kastriotit**

(Nga libri I, kënga 3)

*Në këtë këngë, përmes çasteve të fundit të Gjon Kastriotit, i cili, duke qenë i vetëdijshëm për rrezikun turk, i lë peshkopit të Janinës porositë e tij të fundit, poeti shpreh idetë e veta patriotike e shoqërore.*

Krujë, gusht 1442

Has më drekherë peshkopin  
një bujar i largë e i thotë:  
«Ja pallati dhe shpërvjerrset,<sup>1)</sup>  
që m'ia prisnin erërat:  
po m'i le për varr të ngrirët,  
them, ksaj jave Mbreti i Krujës,  
pa njeri të farës tij

---

1) shpërvjerrset — perdet

për t'ia lënë dhjatën. Por  
Mbreti vetë e mblodhi, e ty  
po t'i lë porsitë e fundit.

„S'kam kujt, thotë, prandaj kishës  
s'amëshuar po ia le.“

**Peshkopi** — Ah, ngado, si rrëshmja<sup>1)</sup> e shembur  
ndaj përroit kur fryn dimri,  
po më ngjet, ka vjete, Arbri,  
krejt i sigurt s'jam për besën.

**Bujari** — Mos u ngut, unë jam plak;  
që fëmijë i pashë retë  
tek po i frynte juga e nxeh të  
dhe çdo vit të shfryjnë shqotë.  
Njësoj sot e tutje fryhen.  
Fati ynë me to ngjet.

Pra, o burra, shkëmb qëndroni.  
Djemve, që shpejt do t'ju rriten,  
vepra e shembëlla t'ju lini,  
siç ju lamë edhe ne juve,  
tek kjo botë e pasosur,  
q'i rrit njerzit për të mirë!

**Peshkopi** — Kam për vdekje, o zot Stefan,  
në shtëpi djalin e vetëm.

Vemi vetëm sa ta shoh,  
pastaj shkojmë.

**Bujari** — E kush e di,  
a na pret Mbreti?... I dërgojmë  
zonjës Verë një njeri.

**Peshkopi** — I dërgojmë, edhe ne shkojmë  
Fatin në dorë s'e kemi.

---

1) rrëshmja — orteku

Çlodhën kuajt më një hije.  
Hëngrën bukë e pinë verë  
e pastaj vazhduan udhën.  
Si mbaroi dita djegtare,  
na u nde shatorja e qiellet  
gjithë yj', shumë larg nesh.  
Dhe shkefajat<sup>1)</sup> që nga dheu  
nxorën kryet anembanë,  
tërzimitë<sup>2)</sup> e tyre nisën:  
gjumin njerëzve u ndjellin  
dhe mendimet u rrallojnë.  
Në mes qiellet, filli e vetme,  
hëna e plotë ndriste botën  
edhe tokën pa kufi...  
Tok me ta përpara shkonin  
dhe barinj, që mblidhnin qersash  
lopë e qe, të cilët qetas,  
që nga fushat e pamatme,  
shpirti i conte zbrazdësirës,  
ku dëshira i tërhiqte  
pa kujdesje për gjithsinë.  
Kurse dy bujarët ecin  
dhe pa prerë kuvendojnë  
për të fshehtat e gjithsisë...

**Peshkopi** — Njerzit kthisin plot pallate,  
qiellzagjerë<sup>3)</sup> e kvadrebukur,

---

1) shkefajat — grilat, bulkthit

2) tërzimitë — zhurmët e këngëve të bulktheve

3) qielzagjerë — me tavan të gjerë

me dritare, nga tē cilat  
shihen pamje tē stërlashta  
dhe prej tyre kur largohen  
duket sikur kurrë s'qenë:  
vajza sallash tē begata  
shkelin nē mermer që s'njohin;  
dhe shpërvjerrsësh tē mëndafshta,  
zëra dheut<sup>1)</sup> na marrosen  
pas cici zogjsh, q'i tagjisim  
nē flanikth; pastaj mendo,  
po tē ndjejnë zë tē dashmit...  
Por nē mes tē kësaj jetë,  
kur e drejta na shkelmohet,  
ajo irreh krahët e ngjitet  
lart te zoti, e ai e pret  
si tē bijën e i ter lotët.

Duke folur ata dolën  
lart nē çukën e një rrahe,  
nga çdo gjë e zbehtë dukej:  
atje ndenjnë e ngrysën natën.

Por agimi shpejt e ndriti  
kaltërsinë e ditës re  
mbi qytefet që po flinin.  
Era e ftohtë i zgjoi bujarët.

---

1) zëra dheut — zana, shtojzavalle

Mendimqetë nganë kuajt  
dhe të shtunën më drekherë,  
nëpër portat q'i rreh era,  
në pallat të Krujës hynë.

## II

Mbi të linjtin shtrat si borë,  
me natyrën para syve,  
lart në dhomë gjet peshkopi  
Mbretin, zotin e pallatit.  
Gjithë u ngritnë e u larguan.  
Brenda qetësi e madhe.  
Evdoksia e Kinigoit<sup>1)</sup>  
doli në dritare e foli:  
«Tha mbretresha Voisavë  
të pushojë zhurmërima.  
Futni kuajt me lingth stallash!  
Eshtë shumë rëndë Mbreti;  
dhe Bozdarin, aq të lodhur,  
që sërisht mundime e presin,  
as që mund ta zerë gjumi.»  
Edhe jashtë ra qetsia.

Tani ndihej fjala e Mbretit:  
«E ndonse do kthehen djemtë,  
unë u nisa për nga s'kthehem

---

+ ) Evdoksia e Kinigoit — familje e dëgjuar patriote dhe përparimtare arbëreshe

më kötu. Ata qëndrojnë  
larg prej varrit...

**Peshkopi** — Nga t'errëtit  
e kësaj mbrëmje, Mbret, sheh errët.  
Pa vëreji? Rreth t'u mblodhën  
gjithë ata që ty të njohën.

Si ti, gjithë shtegtarë,  
lanë të mirat e ditës  
së përjetshme e t'erdhën pranë.

**Mbreti** — Sepse vetëm mua nisin  
ndënë dhe, pasi u veçova  
prej atyre: u bëra mbret!

S'mjaftoi zemra që më falën,  
deshë edhe gjënë e tyre,  
dhe kamata për të majmur  
njerzit e shtëpisë sime,  
gjer dhe qentë e mi e kuajt!...

Tani shkoj. E asgjë s'u jap  
për gjithë ato q'u grabita!

**Peshkopi** — U dhe gjithve jetën tënde.

**Mbreti** — Mos më sill sërisht mi retë,  
që m'i zhduk veriu i vdekjes!

Ç'kishin ushtarët në luftë,  
duhej të kisha dhe unë.

Dhe në paqë, pasi atdheut  
qetësinë i solla, patë  
udhëheqjen dhe sundimnë.

Vetë fola, edhe dëgjova,  
por asgjë s'mora ndër duar.

Ndryshe nga ç'kérkon e drejta,  
si shpërbëlim desha pallate  
dhe bashtina nga vegjlia...

Por ja, sot po më zhvesh vdekja:  
baltë jam, i kthehem baltës.

**Peshkopi** — Vctë shokët ty t'i dhanë,  
dhe i harruan.

**Mbreti** — Shpirtbujarët!

Përmjet tyre e pres ndjesën.

Një të mirë unë e pata:  
për shtëpinë e zemrën time,  
ushtë m'ish çdo veprë e keqë  
që plagos njeriun-zot.<sup>1)</sup>

Po tani të gjitha ëndrra!

Jam si djali, që në shfaqje  
na sheh fate të panjohur,  
tek le botën, po shoh se  
bëhen gjëra që s'kuptova...

Edhe dje në kllapi t'ëthes,  
m'u shfaq gati jeta ime:

Vetëm filli te sulltani  
unë u gjeta... e akojt<sup>2)</sup> më thanë:

«Çfarë e do njeriun-zot  
që t'u zhduk nga faqja e jetës?»

«Qoftë, u gjegja, me të, ne!»

«Po për djemtë s'mendon vallë,  
q'aq i dhimsen zotit madh?»<sup>3)</sup>

«Flisni, u thashë, o bijtë e mi:  
ndrroni besë, e lini mua  
që të bëhi si këta?»

«Jo, m'u gjegjnë, o zoti tatë!»

---

1) njeriun-zot — zotin njeri, Krishti

2) akojt — oficerët, suita

3) zotit madh — sultani

«Nxirrni thikat, thirret plot vrer  
një akua, e shkoni i mprihni!  
«Do na vrasin?» pyet Stanishi.  
Unë ndrydha gjëmë e lotë:  
«E ç'na duhet jeta e kotë  
në një dhe q'e shtyp armiku!»  
«S'ka ç'na duhet!» tha Stanishi,  
borë i bardhë e për lot mprehur.  
Si një dritë i shkrep Stanishit,  
buzëtarë e më të qeshur:  
«Një, i thotë, e kemi larg.<sup>1)</sup>  
Ai do vijë e do t'i vrasë,  
edhe ne do na shpëtojë;  
(një zë përbrenda ma thotë.)»  
Gojëhapët dëgjon djalthi,  
kur një turk i qaset pranë  
dhe me thikë i bie n'ijet.  
«Vdiqa, mëmë!» briti e gjaku  
i rrjedh kofshës. «Shpejt një thikë!  
klithi i vllai». «Kuku, nane!  
S'paskërka këtu t'arbëreshë?»  
I tronditur, djersët akull,  
i përlotur, thirra: «Zgjohu!  
Voisavë, pasiëtë djemtë!»  
«Qyqja, bijëzeza unë!»  
**Peshkopi** — S'ke përse të shqetësohesh.  
Kjo tregon se bijtë e tu  
në gji zoti do t'i mbajë.  
Edhe fajet, që gjithmonë  
shkatërrojnë shtëpi mbretrish,

---

1) Aluzion për Skënderbeun

po i lan ti duke pasë,  
peng fëmijët tek armiku.  
Por ata s'e ndrrojnë besën...  
Kjo t'u shfaq, o Mbret, në gjumë...  
**Mbreti — Ashtu qoftë!**

**ZEF SEREMBE**



## V r r u l l

Zogj të bukur këndoijnë me hare,  
po zemra do t'më plasë mua në gji.  
I helmuar e shkoj jetën te ky dhe,  
mërzitem në katund, në vetëmi.

Hapet përpara meje deti i shkëlqyer,  
që zgjon në trutë e mi mendime shumë,  
e shqetësimi zemrën time çjerr,  
aq sa vetëm pushoj kur bie në gjumë.

Arbëria matanë detit na kujton,  
se ne të huaj jemi te ky dhe.  
Sa mote shkuant! E zemra nuk harron,  
që nga turku mbetëm pa mëmëdhe.

Prej hakmarrjes lind shpresa e drithë  
e bardhë,  
era po fryshto dhe akulli më zë,  
se arbëreshi harroi ç'ish më parë  
edhe nuk ka më turp, po rri e flë.

## **Zonjës Elena Gjika**

Shumë të madhe një hare  
unë në zemër ndjej sot,  
gjithë më duket plot hie,  
kam gëzim, nuk kam më lot.

Afër diellit të gëzuar  
të arbërreshëve të mjerë,  
një yll i ndezur ka ndriçuar,  
që largoi natën e thellë.

Rri atje lart e na shikon,  
rrugën duke na treguar,  
mbi mjerimet që kaluan,  
hedh një dritë që na gëzon.

Ylli apo u tregua,  
pushoi era shpejt e qetë;  
edhe kënga, kur u zgjua,  
ndezi mallin për në jetë.

Anemban' malli u rrit  
e u ndal ku gjet' arbëreshë,  
e na lidhi jotja dritë  
mendje e zemër. perëndeshë...

Di si ishim ne të shkretë?  
Posi gjuhëza pa gojë;  
hodhëm rrënë ne në jetë,  
asnjeri po s'na dëgjojë.

Skënderbeu shkoi si shqotë,  
pasi çau errësinë,  
historiq na e thotë,  
se përmbysi turqërinë.

Shkoi stuhia na mbuloi  
e me topa e me zjarr,  
e një mjegull na rrethoi,  
se Arbëria ra në varr.

Në atë kohë gjëmonin malet  
plot me thirrje, e bubullima  
mbushën sheshet, shkuan zallet,  
qielli u fsheh me drithërima.

Sa t'këqija na kanë rënë,  
oh, sa lufta ndër luadhe!

Vendet ishin për të qarë,  
gjaku vej rrëke e madhe.

Shkoi e vate edhe qëndroi!<sup>1)</sup>  
lart në qiel i si një re  
e t'arbëreshin e qëlloi,  
që si ish nuk mbeti më.

Shumë i gjat' qe moti i zi,  
i vëllai harroi vëllanë,  
Shqipëria s'pat fuqi,  
se të bijtë krah s'i dhanë.

· · · · · · · · · · · ·

Trimat tanë, o zonjë, presin  
Kruja sa t'i zërë luftimet  
e tamburat të kërcasin,  
këngt' e luftës të buçasin.

· · · · · · · · · · · ·

Sido që un' jam i mjerë,  
në katund i vetëmuar,  
me mendimin që më therë  
e me zemrën e helmuar;

---

1) Shkoi e vate – është fjala për stuhinë, që përmendet tri strofa më sipër.

do të shkoj në luft' ku thrret  
gjaku ynë në Shqipëri,  
te ku toska e gega i shpejt'  
bashk' luftojnë përsëri.

Edhe kur të shuhet zjarri  
mbledhim flamujt në shtëpi,  
dhe Shqipëria, që ish te varri,  
do t'shkëlqejë në lumturi.

• • • • •  
Dhe kur nga kufiri i huaj,  
do t'na ngren' ndonjë pusi,  
për t'na tretur jetë e nder,  
për t'na shpën' në robëri,

emri yt atëherë do t'jetë  
shënjë shprese e guxim,  
asnjëri të mos harrojë  
burr' të jetë, të jët' trim.

## **D e t a r i**

Mirëmbeç, o zonjë e dlırë,  
vozitësi vjen menatë.<sup>1)</sup>  
Nga coha brezin nxirre  
edhe lidhma në shpatë.

Po qan? Tañi m̄os qaj,  
se e bukur ësht' kjo jetë:  
bashk' rrjedhin gaz e vaj,  
se vattra na thërret.

Kur venim tue shëtitur,  
ndër fusha e ndër vironja,  
zgjedhën, i lemeritur,  
të turkut qen mallëkoja.

Një mbrëmje në galerë,  
e dashurë, të thashë:

---

1) mëngjes herët

— N'u kthefsha prap' me nder,  
do t'ngre direkn' e trashë.

Si zonjözë arbërore,  
nënqeshe pa mëri:  
dhe sot ti mbahe e gjorë,  
se nuk qëndroj në shpi?

Ti rri kuje; do luftoj  
në det un' me trirembin;<sup>1)</sup>  
ëndërro ti, un' do guxoj,  
si Tefta na dha mësim.<sup>2)</sup>

Zonjë, ti mirë e di  
sa i kënaqur jam,  
u ngrit Bardhyl i ri,  
për t'i shërbyer kam!

Kur dita zbardhon qiellin  
detari ëndrrat harron,  
për nuse ka flamurin,  
për mall — detin këndon.

---

1) anije me tri rrëma

2) Teuta dhe Bardhyli, mbretër ilirë

## A u t o p o r t r e t\*

• • • • • • • • • • • • •  
Në zemrën time gaz e helme rrinë,  
më zë inati, po shpejt e kapërcej,  
me shokë rri pak, kërkoj qetësinë  
e kohën me shumë ëndrra e gënjej.

Mllef kur kam e shkund edhe e rrëmbej  
të vërtetët e shtënë në llavinë.  
Desha të ndreqja botën... Po nuk shprenj<sup>1)</sup>  
e lotët më ven' fakes nga mëria.

Gjuhën me miqtë e kam si një këmborë,  
rrallë jam idhnak, më fort kam butësi,  
megjithëse lufta më pëlqen shumë.

Të gjithë i ndjej. E hapëtështë imja dorë.  
Sido që s'kam e rroj në varfëri,  
thellë zemra më zbutet posa brumë.

---

+ ) Kjo vjershë, me titull «Fytyra ime», përbëhet nga dy tingëllime: në të parin jepet paraqitja fizike, kurse në të dytin, që po e botojmë, figura morale e poetit.

1) nuk shpreso

## Fytyra e asaj

E bardha vashëza ime e bukur ë:<sup>1</sup>  
e prerë, e hollë, si kumbull drejt më rri,  
kur ecën, shkon si zog e, mbase, më,  
e ngre zërin ajo plot me melodi.

Flokndarë mbi ballë e bukur rrrethas vë  
gërshetën, që i shkëlqen krejt në të zi,  
balli i saj ndrit e rreze drite zë,  
si gryka e detit në agimn' e ri.

Të zez, plot me mendim e mall të thellë  
sytë e asaj shkëlqeijnë më se hënë,  
e gëzon në mes faqesh hunda e hollë.

Ka buzët si koral, ësht' faqemollë,  
dorën dhe qafën në albastër bënë,  
edhe kur qesh, sikur të ngre në qiell.

---

1) është trajtë e shkurtër dialektore

## Pas të vjelave

Retë që ajri nuk i lë,  
shtinë pika shiu sot,  
rrushtë mbaroi, trishtimi zë;  
ikën vjeshta e nuk na thotë  
të ecim fushës përsëri  
plot me shpresë e lumturi.

Lisit gjethi shpejt i bie,  
tjerrin vashat në shtëpi,  
dimri i egër vjen e shtie  
nëpër udhët qetësi.

Kudo shoh, nuk gjej hare,  
s'ka më zogj nëpër fole.

Gjithnjë vetëm, gjithnjë i shkret',  
vashën time pa shikuar,  
dridhem, ëndërrrij, më vret  
dëshërimi i helmuar.

Asnjëri s'më thotë të veshi:  
— Vasha jote ësht' te sheshi!

Marr pushkën për gjueti,  
çdo mëngjes un' jashtë dal,  
shkoj ndër pyje e në gremi,  
nëpër përrrejnt' që janë në mal,  
hyj në shpellat sa më fshehtë,<sup>1)</sup>  
sa largohem nga kjo jetë.

Vasha lehtë e pa kuptuar:  
mendje zemër m'ka pushtuar:  
bëhet diell që më ndriçon  
edhe zemrën ma gëzon,  
më bën malli shënd e verë  
dhe më sjell një paraverë.

Dhe kujtoj un' kur këndonin  
gardalinat nëpër pyje,  
kur te lumi plaçkat shtronin  
gratë e bardha posa lile,<sup>2)</sup>  
kur në çukën e lulëzuar  
shkonin çërrat e gëzuar.

Un' në paqë atëherë rri,  
dritë më duket kjo jetë,  
nuk kam breng', po lumturi;  
mbushur nga mall' i vërtetë  
vete e vij; kur bie borë  
e mbaj zemërën në dorë.

1) hyj thellë nëpër shpella

2) zambak

Edhe kur mali gjëmon,  
ikin gjindja e zogjtë qajnë,  
era e ngrirë më lëmon.  
Shiu e bora, që më lajnë,  
bëjnë të mblidhem në shtëpi.  
Gjithçka mbytet n'errësi.

Brenda, nga dritarja shoh  
një hapësirë shum' të gjerë  
edhe zemra të shkojë do,  
ku bredh një vashëz si erë.  
Bubullima, por, gjëmon  
dhe nga ëndërrat më zgjon.

Shkundet dheu dhe hapësira  
oshtëtin shumë e më shumë,  
fshihet deti e në shtëpira  
gjindja bën të dytin gjumë.  
Unë rri edhe rënkoj  
atje ku jam dhe pushoj.

Eja, vash', për t'më gjuar  
tash që kam kaq drithërimë,  
më lehtëso, duke kënduar,  
nga të thellat llahtarime.  
Shtrir' në shtrat rri, mbyllur sytë,  
në ëndërr shoh gjith' bukuritë.

Tash dëgjojmë atje ku rri:  
Dje në shpellën më të shkretë,  
gjeta, plot me bukuri,  
një gjel t'egër, që thërrit  
natë e ditë, nga orë e mot,  
nusen që ia vrau një shqot'.

E zura e ta solla ty,  
se mua t'ziut ai më ngjet:  
si unë i lodhur është ai  
dhe unë qaj si zogu i shkretë,  
që pa mall n'kafaz qëndron  
dhe pa shpresë jetën kalon.

Vashë, nga Piluri një herë  
dil e bëj ndonjë të hollë,<sup>1)</sup>  
shihm' me syrin tënd të qetë  
e rrëfem' faqët si mollë,  
buzqeshëm me përkëdheli  
thuajm' një fjalëz dhe... teshti.<sup>2)</sup>

Nëpër shqope e korkore<sup>3)</sup>,  
do të vij ku më je ti,  
pas do t'vij un' qetë e lehtë,  
të të shoh me dashuri,

---

1) ndonjë shkarpë

2) të tështiturit, sipas një paragjykimi, është shenjë mbarësie.

3) Xhixhibanoz i egër

të të puth një herë, jo më  
dhe një këng për ty të zë:

—Dëgjo, vashë, jehona flet:  
te përroi nga rrahu i thellë,  
kënga rrëth e qark buqet,  
me hare mbushet kjo jetë;  
qielli i but' do të dëshmojë  
dashurinë, që sot agoi...

Po vonohet,,, I kumbisur  
përmbi pushkë, rri e kujtoj  
çast'n e shenjtë të vithisur  
tok me ata që dëshiroj.  
Jeta është një zonjë e madhe  
q'e harruar që ndër valle.<sup>1)</sup>

1) Ka kuptimin qëjeta nuk pyeste për brengën e poetit.

**GAVRIL DARA (I RIU)**

(WILL 1) A HILL CROWNED

# KËNGA E SPRASME E BALËS

*poemë*

## Pjesa e katërt

1

### Dita e Valkalit

Zogu natën seç rënroi  
majë kullave të Petës  
e gjith' egërshitë e malit  
iu përgjigjën për së largu.  
Lindi dielli pa rrëze,  
keq i kuq, ngjyër gjak  
në një qiell bojë hiri.

Një ohtë<sup>1)</sup> e rëndë ra mbi bot'.  
S'frynte, s'tundej asnë fletë,  
asnë zog nuk pipëtinte,  
veç kumria e lënguar  
brumbullonte nëpër shpat  
dhe me të — një zëth i hollë,  
si këmborëz e argjendtë,  
atje lartë në ballkon.

## II

### Kënga e Beratit

O Berat, o Berat, —  
këndoi Mara atë menatë, —  
sa të varfër ti ke lënë,  
sa të veja shkulën flokët!  
Ditë vrasmje, ditë e zezë,  
mos u kthefsh në jetë më,  
nata e vdekja të mbuloftë,  
kurrë djelli mos të zgjoftë!  
Nga katër anët e dheut  
vijnë qiftet tufë-tufë,  
nga gjithë shpellat e malit  
zbresin bisha në çdo anë;  
gjak në erë, gjak në re,  
gjak në ujë, gjak në dhe,  
gur më gur një copë mish,  
kokë e krahë trimash kish!

---

1) ohtë — avull

Zonja Mamicë atë natë  
pa një èndërr keq të gjatë,  
se iu duk i shoqi i zbehtë,  
me gjith' kurmin copëtuar;  
ai kurorëzat mbi shtrat  
i mbuloi me shqep të zi;  
hoq unazën e martesës  
dhe e ndau në dy pjesë;  
një e mbajt, nj'asaj ia dha,  
pastaj humbi e gjë s'i tha.  
Natë e ditë ajo vajtoi,  
po nga varri dot s'e zgjoi.

Kështu Mara më këndoi,  
nuk 'këndoi, po rënroi.  
E dëgjoi që nga dhoma  
zonja Lenë dhe e qërttoi:

— E përzishmë, zonja nuse,  
t'u çel kënga sot menatë,  
mos një èndërrëz të keqe  
apo të vdekurit pe?

— As m'u shfaq èndërr e keqe,  
as të vdekurit nuk pashë,  
po kam zemërën të thyer  
dhe pa hir më rrjedhin lotë:  
çfardo shoh, e shoh në zi...  
Obobo, ky Niku ynë,

kur më iku m'u helmua  
dhe unazën më kërkoi!...  
Vemi, mëm', vemi në kodër  
tek zbulohen gjithë fushat,  
mbase Niku na ësht' kthyer!

Vanë, të zezat, në kodër  
dhe vështruan më çdo anë  
sa, me trastë e me shkop  
panë përderësin<sup>1)</sup> që qante.

— O përderësi mavri,  
paç uratën, përse qan?  
Mos kafshën të kanë vjedhur,  
kasollen të kanë djegur,  
apo yt bir të ka humbur  
në këto lufta të shkreta?

— Jo, as kafshën, as kasollen,  
as tîm bir unë nuk po qaj...  
Syt'e mi u bënë lumë  
që prej Arbërit kullon...!

— Fol, ti zë i fatit keq, —  
thirri vasha e i ra pikë, —  
ç'të keqe pe në ushtri?

---

1) përderës — lypës

Si ra Arbëri në zi? ,  
Fol! Në flamurët e luftës .  
qift'n e Petës a e pe?

U përgjigj aher derziu:  
— Po ju them, se dje menatë,  
atje lart në Muzëkatë  
zjenin gjémët<sup>1)</sup>, lumbardhat<sup>2)</sup>.  
Nga gjémët dhe lumbardhat  
gjithë dheu bubulloi  
edhe tymi i dyfekëve  
gjithë malet mjegulloi;  
nga zbardhllimi i jataganve  
gjithë fushat më shkëlqyen;  
nga gjak i ushtarëve  
lumenjtë krejt u mbuluan;  
nga copat e ushtave  
bëheshin urë e stiseshin;  
sheshe shtroheshin në Valkal  
e mbi shesh ngriheshin malet.

Posi vala e detit bie  
e prap' kthehet në thellsi,  
dhe si arat e bleruara  
tunden erës që i përkund —  
venin, vinin, duke shtënë  
gjoks më gjoks, ushtar m'ushtar.

---

1) gjémë — bubullimë, gjëmim

2) lumbardhë — gjylet

Po, në kohë kur lëshon qetë  
bujku edhe u jep sanë  
dhe vëtë, para kalives,  
përtyp një cop'buk'mc kripë,  
u ndryshua pamja e luftës,  
se nga e djathta, vëtëtimë  
se nga e djitha, vetëtimë  
u sul Mbreti dhe çau gardhin,  
gardhn' e zi me patërshana.  
Tek binte kordha e rëndë,  
binin krerët posa breshër;  
ai më shkoi me tërsëllimë,  
duke i shkelur thundr' e kalit  
të vdekur e të plagosur.  
Ndërsa, në anën e mëngjër,  
Dukagjini, që e vu re,  
si një shkëmb mbi armiq ra.  
Veç në grykë, me Badherin,  
jenicerët u shtrënguan,  
të bashkuar trup më trup  
dhe mburojë më mburojë,  
posa ndonjë mur i hekurt  
i patundur dhe i tmerrshëm.

Më kot trimat, guximtarët,  
n'atë mur përpoqën kryet,  
se përdhe ran' të goditur.  
Atëherë dhjet' kalorës,  
dhjet' dragoj u ranë shporve, —  
dhjetë gjëmë në stuhi —  
në mes tyre u vërvitën,

shtrirë ushtat si purteka.  
Rrézuan, vranë, coptuan,  
ngritën mal këtu e atje,  
mal të vrarësh, të plagosurish,  
dhe hapën të çar' të gjerë,  
shtruan një udhë mjaft të gjatë,  
si një brazdë në të mbjella.  
Ashtu Drini i Zi në dimër,  
mbushur prrenjsh të maleve,  
vjen i fryrë e i tërbuar,  
has në ujrat e liqenit,  
i merr zvarrë, i ndan më dysh;  
e lart ngrihet dallga e bardhë  
dhe rrëtë rrëzave gjëmon.  
Porsi ujrat e liqenit,  
që, si ndahen, prapë kthehen,  
priren vrap e bëjnë shesh,  
sa dhe lumin e mbulojnë,  
ashtu bëri hordhi e keqe.  
Si pa që të pakt' sulmonin,  
duke u mbledhur e shtrënguar  
pas të dhjetëve u mbyll.  
Mbretë aherë e Dukagjini,  
e shpérndanë hordhinë dhe u kthyen  
dhe tok ranë mbi Badherin,  
para, mbrapa, më çdo anë.  
Copëtar dhe shkatrruar  
qeni i ndyrë zu e u zbyth,  
por, i padërrmuar krejt,  
brenda vahut u mbëlodh,  
si ariu i Tomorrit,  
që nga dhënarët përzenë,

njérin vret e tjetrin çjerr,  
sado grisur e përgjakur,  
po pa drojë zemrës së madhe,  
tërhiqët shpatit nga doli,  
ngopur gjak e ngopur mish.

Si u ngrys, Mbreti u kthyë  
me gjith' ushtarët ndaj fushës;  
na ndezi zjarret e natës,  
u kujdes për të plagosur...  
— Mos të zëntë nëma e zezë, —  
thirri Mara si e çmendur, —  
qifti i Petës a m'u mblodh,  
a e lpe ndër të plagosur?

Ai heshti e s'u përgjigj.  
U verdh e, me sy në dhe,  
pikë-pikë i binin lötët.  
Vasha me një ulërimë  
drejtë shtegut m'u lëshua;  
nuk zbriti, u rrokullis  
e ndaj malesh perëndoi.

. . . . .

(Lypset edhe këtu një pjesë)

. . . . .

Gjithë natën, gjithë ditën,  
me kalorësit e mi,

renda unë pa u ndalur  
dhe pérshkova nëntë fusha,  
nëntë fusha e nëntë male,  
duke prerë, duke vrarë  
qentë e ikur, të shpëtuar,  
po kur u zhdukën të fundit  
përtej brinjës së Mokreut  
edhe dita zu të erret,  
shokët tërhoqa dh'u ktheva.

Sa i qaseshim livadhit  
vrëhej, errej zemra ime,  
velur vramjes së trazuar,  
se zjarri qe bërë hi,  
se gjith' drizat e barishtet  
ishin lyer në të kuq,  
edhe brazdat e hendeqet  
ishin plot me gjak të piksur.  
Afër vahut të Valkalit,  
tek e ashpra luftë u ndez,  
pirgje-pirgje qen, të vrarët  
e në pirgjet me të vrarë  
ujq e qena buzëndotur  
grinin, shqyenen bark e zorrë,  
ndërsa, me britma të çjerra,  
mbulonin djellin si re  
korba, sorra e sqifterë.

Sa e bukur djalëri  
që gjer dje përpinte retë,

sot ka heshtur përgjithmonë,  
posi pleh në dhe shpérndarë!  
Në sa trajta vdekja e shkretë  
m'u dëftua n'ato pamje!  
Këtu një ushtar i ri  
mbylli sytë duke qarë;  
kujtoi nënën që e priste!  
Medet, që më kot e priste!  
Më tej armik me armik,  
kafshuar porsi dy qena,  
ende dukej se luftonin!  
I trazuar, i helmuar  
hoqa syt' nga pamja e egër,  
ktheva sytë afër urës;  
pashë, befas, një murgjar  
me kryet ulur në truall  
dhe me frerët nëpër këmbë,  
me mutafën<sup>1)</sup> zvarrë-zvarrë  
e me shalën nën bark.  
Iu afrova, jo pa drojtje,  
se mutafa n'ar qëndisur  
një dyshim të keq më zgjoi,  
se e qëndisur m'u duk  
me luanë në të gjelbër.  
Pranë kalit, një ushtar  
me dhjetë ushta në gji  
ishte shtrir' si ka i therur.  
Shtrëngonte me dhëmb' flamurin,  
mbante kordhënë në grusht.  
Me fytyrë nga qielli kthyer

---

1) mutafë - mbulesë e kalit.

edhe vdekjen e përbuztë.  
Jo nga pendët e shqiponjës,  
as nga mburojë e argjendtë,  
sa nga vëtullat kaleshe  
dhe nga sytë e zgurdulluar  
Pal Golemin unë e njoha.  
U gëzova mos ish gjallë  
dhe e hoqa me kujdesje  
ku qe bari më i shkrifët.  
I preva rripat parzmores,  
vura dorën përmbi zemër  
nën dorë ajo më rrahu.  
Vrapova shpejt gjer te lumi,  
mora i solla një pikë ujë  
e ia hodha përmbi faqe.  
Ai u shtriq me një psherëtim',  
si njeri në gjum' të rëndë,  
tundi kryet e m'u kthyte,  
më njohu dhe pa mundim  
me zë të thellë më tha:

— Le të vdekurit ku janë,  
lem' të fle përgjithmonë  
te ky shtrat i nderit tim,  
këtu, ku eshtra të vrarësh,  
të vrarësh prej kësaj dore,  
përngaherë i kam kurorë.  
Na këtë flamur dhe Mbretit  
të m'i thuash këto fjalë:

— Pal Golemi edhe i vdekur  
i 'tmerrci armiqë' me sy  
dhe, si ikën ata, ra.  
E t'u thuash shokve t'mi:  
Pal Golemi nuk ka vdekur,  
do ta ngrerë zëri i luftës  
edhe do jenë me ju  
krahu, kordha, zemra e tij.  
Tani, Balë, n'atë lis  
var mburojën e parzmoren  
dhe përkrenaren e zezë  
dhe mbi to var kordhën time,  
që, kur dielli të shkëlqejë  
dhe me rreze t'i qëllojë,  
nga shkreptimat e tyre  
të bijen, ngrirë nga 'tmerrri,  
gjithë ç'm'u trembën në jetë;  
dhe, në qetësinë e natës,  
hekurat edhe çeliku,  
tundur erës së Mokreut,  
do t'i ngjajnë ushtri e gjallë  
genit qasur n'errësirë.

Foli e kryet i ra në gji,  
shtrembëroi sytë, u shtri përdhe  
me të gjithë 'trupin e tij.  
Unë u ngrita, se mbaroi  
dhe nga shokët u këtheva,  
që t'i hapnim shpejt një varr.  
I dallova atje poshtë  
tek sillnin një të plagosur,

që po e mbanin në duar.  
Kur e qasën, u zalisa  
sa pashë qiftin e artë,  
sqeppërpjetë. krahëhapur,  
mbi përkrenaren prej bronzi.  
Ish'te i bardhë si qiri,  
kryet i binin mbi sup,  
lëshuar flokët përdhe.  
Gjaku i rridhte pik'-pikë  
qafës së hapur si shégë.  
Jeta qe mbledhur në sy.  
Si më pa me dhemshuri,  
më vështroi edhe qeshi.

— Mos më qaj, vëllathi im,  
mos më qaj në zulmën time,  
kësaj dite flamurtare,  
kësaj dite t'Arbrit tënë!  
Kthehu n'ushtri dhe u thuaj,  
edhe Darës të m'i thuash:  
Malli i mirë në djalëri  
ësht si vaji në kandil.  
Niku, dhëndërith i ri,  
këmbeu dasmën me luftën  
dhe kangjelet me Valkalin.  
Njëqind qena m'u vërsulën,  
të njëqindët hanë baltë,  
pastaj Badher tradhëtari  
që nga prapa më qëlloi.  
E t'i thuash edhe mëmës:  
Niku u nis e do mënojë,

po ti, mëmë, mos e prit.  
se, për birëthin që humbe,  
një bijëz ai të la;  
ta ka truarë përjetë!  
Pastaj hip përmbi ballkon  
të m'i falesh vashës bukur,  
vashës së bukur të Lalës,  
asaj që mua kujton,  
më kujton në zemërë:  
Niku yt, moj, t'u martua,  
t'u martua me një plakë.  
me një plakë keq të zezë  
e ti, e bukur, të martohesh!

Sosi fjalën dhe m'u shua,  
si kandili që s'ka vaj,  
si një lulëz e këputur  
që mban erë edhe e vyshkur.  
Dhe, tekxa ne po mendonim  
që t'i mbulonim në varre,  
më 'kët' anë urës një vashë  
na u shfaq posa një hije.  
Kishte flokët të ndërlikur,  
sytë thelluar në ballë,  
me fustanin copë-copë  
e me këmbët përgjakur:

— O ju ushtarë, vëllezër,  
qofshi të lumtur 'përherë,  
mos më patë kësaj fushe

një kalorës fort të ri,  
më përkrenare të artë,  
ku një qifl i fluturon?  
Floriri i saj përzihet  
me flokët e tij të verdhë  
e me ballin posa diell;  
ka dy sy si dy shkëndija,  
dy shkëndija shkrepëtime.  
E ka gojëzën unazë  
edhe fjalëzën të ëmbël,  
porsi hoji i paraverës...  
Eh, ju lutem, më kallzoni!

Ne u pamë sy ndër sy,  
që na mbytën në lot.  
Helmit buza na u qep.  
U zverdh edhe na vështroi  
dhe u kthye. E, sa pa  
të vdekurin në dhe shtrirë,  
dha një britmë e i ra në krahë  
e ftotë posa dëborë.

Vam' t'i flisnim, s'u përgjigj.  
Vam' ta preknim, nuk lëvizi.  
Vam' ta ngrinim e na vdiq.  
Zemra e dhënë Nikut t'saj,  
rritur mallit e hareshë,  
si u rënd nga helmi i keq,  
më s'e mbajti, edhe plasi...

Në Valkal janë dy varre,  
fle te njëri Pal Golemi,  
e mbi të mbiu një lis  
me gjithë fletët e zeza.  
Fle te tjetri Nik Peta.  
Vasha e Lalës i fle pranë  
dhe, si u deshën në jetë,  
ashtu duhen nënë dhe.  
Atje mbiu një qiparis,  
mbiu dhe një mollë e bardhë.  
Kur zë thahet qiparisi,  
thahet edhe molla e bardhë!  
Mori bijë, bija e Lalës,  
mori e bukur e trishtuar,  
ç'më ktheve në motnë e shkuar?

1906

**ALEKS STAVRE DRENOVA  
ASDRENI**

THE FEDERAL BUREAU OF INVESTIGATION  
U. S. DEPARTMENT OF JUSTICE

## Vlesa e Atdheut

Sa të dua, o Shqipëri,  
sa mall ndjenj e sa dëshirë,  
për ty gaz e dashuri  
mu në zemër më ka mbirë.  
Se për mua t'i, o Atdhe,  
je një lule aqë e vyer,  
sa nuk gjëndet përmbi dhe,  
shpirtin tem për të ushqyer.  
Qindra vjete gjithë në zi,  
qindra vjetësh i helmuar,  
po një vlerë pate ti.,  
që s'ka shëmbëll, s'ësht' dëgjuar.  
Vala shkuan përmi ty,  
kombe shkelnë pa mëshirë,  
po një s'pati faq' e sy  
të të shohë prej dheut fshirë.  
Se ke trima si më s'ka,  
se ke burra të pavdirë,  
droja syrin s'jau ha,<sup>1)</sup>  
sisën tënde kanë pirë.

---

1) droja syrin s'jau ha – frika syrin nuk ua kap; nuk u  
trembet syri.

Mos ki frikë, moj vajto,  
mos me kryet,<sup>1</sup> trupin zgjatur,  
tunde krahun, u forco,  
dëfto namin që ke pasur!

---

1) Mos me krye — mos me kryet ulur, mos e mbaj kryet poshtë.

## Betimi mi flamur

(*Himni patriotik*)

Rreth flamurit të përbashkuar  
me një dëshirë, me një qëllim,  
të gjithë atij duk' iu betuar,  
të lidhim besën për shpëtim.  
Prej lufte vec ai largohet,  
që është lindur tradhëtor.  
Kush është burrë nuk frikohet,  
po vdes, po vdes si një dëshmor!

Në dorë armët do t'i mbajmë,  
të mbrojmë Atdhenë më çdo kënd,  
të drejtat tona ne s'i ndajmë,  
këtu armiqtë s'kanë vend.  
Se zoti vetë e tha me gojë  
që kombe shuhën përmbi dhe,  
po Shqipëria do të rrojë;  
për te, për te luftojmë ne!  
O flamur, flamur shenjë e shenjtë,  
te ti betohemi këtu,

për Shqipërinë, Atdhenë e shtrenjtë,  
për nder' edhe lavdim'n e tu.  
Trim burrë quhet dhe nderohet,  
Atdheut kush iu bë theror;  
për jetë ai do të kujtohet  
mi dhet, mi dhet si një shënjtor!

**1908**

## Drin it

Drin, o lumë, o i madh lumë,  
që sjell valë, gürë shumë,  
që shkon udhës me buçime  
dhe mbush malet me gjëmime,  
që lak anës fusha, fshatra,  
kur ti rendën me të katra,  
pse je sot i egërsuar,  
vetullvrenjtur, zemëruar?  
Vallë e ndjen ti robërinë  
që e ka mbytur Shqipërinë,  
q'ësht' e shkelur, copëtuar,  
vargonj lidhur këmb' e duar?  
Nga të huajt q'e dërrmuani,  
krejt që e zhveshnë, që e ropnë  
dhe e thëthijnë gjersa u ngopnë?  
Që kur zoti të ka bërë,  
Drin, o lumë i gjat' i gjerë,  
Shqipërisë ç'i ka ngjarë,  
ti të gjitha i ke parë!  
Se çdo luftë që ka krisur,  
kundr' armiqve q'është nisur,  
i pe mundjet, plot çkëlqime,

që përmenden si kujtime.  
ata trimat e vërtetë,  
që dëstonin se në jetë  
kurrë s'trembet shqipëtari,  
që ka zemër, gjak si zjarri.  
Koh' e keqe apo e mirë,  
mot i bukur apo i nxirë,  
qoftë natë, qoftë ditë,  
si në t'errët e në dritë,  
i ke parë, i ke dëgjuar,  
kur ty pranë kanë shkuar,  
dhe kaluar dhe më këmbë,  
t'armatosur gjer më dhëmbë,  
luanë e trima të pavdirë,  
kryelartër, zemërlirë.  
Burre e grua, plak e djale,  
gjith' me zemër, jo me fjalë,  
si fatosa që luftonin,  
Shqipërinë të shpëtonin,  
dhe të lirë dhe të mirë,  
plot me gaze, plot me hirë  
në mes tyre rronin, shkonin,  
dashurinë s'e harronin.

Po sot vallë, sot si janë?

· :

Kryeunjur anembanë.

Sot më s'është ay zjarri  
që e kishte shqipëtari,  
ay gjaku që valonte,  
kur detyra ia kërkonte,  
me një fjal' e me një besë

për Atdhen' ay të vdesë,  
pasjen, gjënë mos kursejë,  
trimërinë të rrëfejë.  
Sot një heshtje, një përtesë  
me një rrojtje në shërbesë.  
Ësht i ftohur, ësht i ngrirë,  
pa një ndjenjë, porsi i mpirë;  
dhe nga feja i verbuar,  
rron ndë terrët e mbuluar.

Drin, që rrjedh gjith' shkumb' e valë,  
her' i rrebtë, her' ngadalë,  
kur i turbullt', kur kulluar,  
kur i qetë, kur trazuar!  
Që ke parë aq të gjara  
dhe gëzirne dhe të qara,  
nd'aqë vjete, aqë kohë  
dhe me diell dhe me llohë,  
kur shqiptari i vrapiuar,  
për në luftët i gatuar,  
me balashin kryelartë,  
sy të kjartë,  
po dëfrente, po këndonte,  
këngë trimash kur kujtonte;  
kur bari dhe bleqtoreshë,  
porsi mbret e mbretëreshë,  
pranë teje shumë dendur,  
fjalë, këngë kanë endur,  
kur me fyell, kur me lote,  
duk' i puthur vala jote;

këngë e bukur, këngë malli,  
 që gjemonte i tërë zalli,  
 sa edhe qielli qeshte, fliste,  
 dielli, hëna rrinte, priste.  
 Më s'dëgjohet, sot u shua,  
 më të qarë çdo gjë u ndrua.  
 Nd'ujën tënde të valuar,  
 atje brenda ka pikuar  
 loti i mëmës, që ka qarë  
 ajem të dashur q'i jan' vrarë.  
 Ndë atë ujët kaq të çgrryer,  
 që po duket gjith' i ngjyer,  
 atje brënda është trazuar,  
 në çdo kohë të tmerruar,  
 gjaku e djersa e udhëtarit  
 dhe të fundit dhe të parit,  
 që për emër të lirisë  
 i dha shpirtin perëndisë;  
 me mjaftim q'e dhuroi jetën  
 për të drejtën, të vërtetën,  
 për lavdimin' e kombësisë  
 dhe për nder të Shqipërisë.

Ndale, ndale, Drin, vrapimin  
 qëndro pak e hidh vështrimin!  
 Rrotull teje duke i parë,  
 se sa janë për t'u qarë  
 viset tonë që rënkojnë,  
 kur të parat i kujtojnë!  
 Ardhi dita pra të zgjohesh,  
 si më parë ti të çohesh,

burrat, trimat duk' i mbledhur,  
gjith' me armët mi krah hedhur;  
të përpiken, të luftojnë,  
Shqipërinë ta shpëtojnë;  
zgjedhën, turpin, që po e mbajnë,  
posht' ta hedhim, ta çpërlajnë,  
sepse turp është një shërbesë  
për atë q'e mban me besë.

Ashtu pra emrin pagëzoje,  
jepi famë, lartësoje,  
dëfto botës pa të druhesh,  
do se i Bardhë, i Zi quhesh,  
se lavdim për të fituar,  
koha edhe me s'ka shkuar,  
po sot dita, Drin, të ka ardhë,  
prap' të dalësh faqebardhë!

**1912**

## Ardhi dita

Ardhi koha, ardhi dita,  
iku nata doli drita!

Ngrihi trima, mos përtoni,  
këtë kohë ta shpëtoni!

S'është mjaft sa duruat  
edhe tër' ato që vuat?

Është turp për emrin tuaj  
të mundohi për të huaj!

Qitni pallën, si ju dini,  
edhe kordhën në e kini.

Me gjith' zemër e pa ndjesë  
bini qenit' të pabesë!

Mjaft me rrobenë të çjerrë,  
mproni vatrën, mproni nderë!

Ç’mbani duart si tē thata?  
Nxirrni shata edhe shpata,

Ferrat, gjemba i qëroni,  
lule tē mbijnë nē doni!

Pér trima ju trima jini,  
këtë dhe ju vetë e dini!

Po ç’dobi ësht’ pér Atdhenë  
kur s’është ashtu si ka qenë!

Shqipërinë ju nē doni,  
nga ky rrezik ta shpëtoni.

Kryet ngrini, zgjedhën shtini,  
pastaj lumtur<sup>1)</sup> që tē jini!

Në jini ju atdhetarë  
edhe thjeshtë shqipëtarë,

Bënje ju sot Atdhenë  
siç qe nënë Skënderbenë!

**1901**

---

1) lumtur — tē lumtur

## Balashit

O Balash, o bukurosh,  
që je trim si një fatosh,  
o dragua kali im,  
që po pret me padurim,  
në ke mall për Shqipëri,  
ngjeshu, kalë, ji gati.

Shih sa vend plot bukuri,  
ku del ar, ku del flori,  
ku ndrit dielli me shkëlqim  
dhe qesh hëna me pëlqim;  
si në vend të prallave,  
trimave dhe pallave!

Ku një pyll, ku një burim,  
male e fusha pa mbarim,  
me lëndina plot magji,  
ku dredh këngë trimi i ri,  
ku del zana për mëngjes,  
lule thurur gjer në brez...

Shpjermë, shpjermë, o Balash,  
si hark rrugën drejt ta mbash;  
çili këmbët, mos u dro,  
shkëmbinj, kodra m'i kapto,  
malit lart t'i ngjitemi,  
jemi trima e s'vritemi!

Ti i shpejtë plot fuqi,  
unë burrë trim i ri,  
kur armiku ne na del  
Shqipërinë për m'e shkel,  
si luan t'i hidhemi,  
prej tij ne mos dridhemi!

Si shqiponjë me thonj, krah',  
prej zemrimit zjarr që ha,  
si rrufeja sa më shpejt,  
Balash, derdhu drejt,  
ta rrëzojmë poshtë përdhe  
në mos shkelë ndë Atdhe.

Sepse armiku ku u bë hi,  
atje lule ka me mbi,  
dhë, ku këmba na ka shkel',  
trëndafil ka m'u çel';  
pika e djersës ku q'u derdh,  
kurrë bari s'ka m'u verdh.

Faqebardhë që të dy  
do të jemi për çdo sy,  
kur të shohin më çdo mur  
një shqiponjë, një flamur  
dhe të thonë pa kujdes:  
Shqipëria kurrë s'vdes!

## Zëri i kryengritësve

(*Shqiptarëve të pasur*)

Ne s'duam paqen, prehjen që t'ju prishim,  
ne s'duam të na i falni pasuritë,  
as dorë s'zgjatim — lypës, s'e durojmë —  
në luftë që të veni na s'ju grishim,  
të lini lark dhe shtëpitë;  
asgjë për veten tonë s'ju kërkojmë,  
asgjë nuk duam, nukë,  
veç armë edhe ca bukë!

Me kryet lart në zjarr të luftës vemi  
dhe gratë rrokin armët, na gjyrmojnë;  
me gaz e derdhim gjakun për lirinë!  
Rrezikun s'e peshojmë, ku që t'jemi,  
prej zë trumbetash malet kur gjëmojnë,  
të shkret' e lëmë vatrën e shtëpinë.  
Ju gjë s'ju duam, nukë,  
veç armë edhe ca bukë!

Esht' turp për ne t'i zgjatim botës dorë.  
Detyrë kini ju të na ndihmoni,  
në i kini dhembje vetes dhe Atdheut.  
Ne s'druhemë nga breshër, shi, apo dborë,  
po kurdoherë ju që të kërkoni,  
një tingëll armësh del nga faq' e dheut.  
Pra gjë nuk duam, nukë,  
veç armë edhe ca bukë!

Vëllezër, prej një nëne jemi lerë,  
po fati na ka lidhur pran' t'i mbësim,  
ta shkojmë jetën tonë me durime,  
me djersë, të vështira dhe të mjerë;  
këtu në malet lart ne do të vdesim  
për rrojtjen tuaj, jetën plot pëlqime.

Asgjë nuk duam, nukë,  
veç armë edhe ca bukë!

Ju rroni nér shtëpira plot shkëlqime,  
nuk dini vojtje, lote dhe kujdese;  
të çveshur si në pak sot muñd që t'jenë.  
Si ju s'e shkojmë jetën me dëfrime,  
po njerëz jemi gjith' t'asaj krijese;  
për nderin, vatrën, kombin edhe atdhenë.  
Asgjë nuk duam, nukë,  
veç armë edhe ca bukë!

Shtëpi ne kemi shpellat, vrimat, malet,  
Nesh rrrotull gjithë armiq e tradhëtorë,

pa vetëdijë, njerëz të pabesë;  
një ergjendit, arit tjatëri sot i falet.  
Kush helmin t'hedhi, kush shpatën mban në dorë  
dhe kush vëllanë armikut do t'ia shesë.  
Për zotin, s'duam, nukë,  
veç armë edhe ca bukë!

Kur flamuri kuq-zi bën vala, ngrihet,  
shqiponja me dy krerë kur del ballë,  
kur dridhet toka, topat kur shëkojmë,  
asnje prej nesh atherë nukë fshihet,  
po flamurin, të vdekur a të gjallë,  
me radhë do të bijem, ta shpëtojmë!

Pra mos na lini, nukë,  
veç armë edhe ca bukë!

Këtu pra njihet vlera, trimëria;  
këtu rrëfehet forca e kombësisë.  
Se ne, me t'u bashkuar, tundet dheu,  
i thyhet çdo armiku gjith' fuqia;  
çel trëndafili i bukur i lirisë,  
përtrihet kombi, ngjallet Skënderbeu.  
O, gjë nuk duam, nukë,  
veç armë edhe ca bukë!

Kujtonani me ç'kini pra të tepër.  
Ne derdhim gjakun lumë, ju veç pasje.  
Ne vdekje tmerri presim, ju veç rrojtje!  
Se me theror fitohet sot çdo vepër,

me njerëz bëhet themeli me çdo rasje.  
Pra fshinani sot lotët plot me vojtje,  
se gjë nuk duam, nukë,  
veç armë edhe ca bukë!

Ç'na duhen krahët dot kur s'i përdorim,  
ç'na duhet jeta, robër, gjithmonë,  
kur s'shohim diellin, dritën e lirisë?  
Pra hënën, errësirën që ta qporrim,  
të ngjallim kombin, farën, fisin tonë,  
për nderin tuaj, nder' e Shqipërisë,  
gjë tjatër s'duam, nukë,  
veç armë edhe ca bukë!

**1911**

**192**

## Krerëve tradhëtorë

Ju njohim cilët jini, s'është nevojë  
t'ju hapet libri i veprave të bëra,  
se populli i përmend papra me gojë,  
me kut i mat, me sytë i sheh të tëra.

Se çfarë shëmbëlltyrë t'ju përqasim,  
me ç'emër botës mundim t'ju tregojmë,  
ne kot si trut' e mendjen do t'i vrashim,  
me juve, e dimë, kombin turpërojmë!

Si ferrat jini, jetën q'e ndalojnë.  
Çdo bimë e lule e mbytni ndënë gjëmbat,  
se as dritë, as diell më s'shëkojnë,  
as gjaku s'iu lëvrin në dejtë e rrëmbat!

Si bisha e malit, gjahut kur i derdhi,  
as gjurmë më s'i mbetet në ka rrojtur;  
mëshirë s'kini, drojës ju nuk verdhi  
për shpirtet, jetën që ua kini shojtur.

Si mjer' ata që presin dörë ndihme  
prej njerëz pa mëshirë perëndie;  
si mjer' ata me djersa edhe mundime,  
kështu që shohin çase lumërie!

Ju s'kini as shpirt, as zemër, dhembje s'ndjeni  
përpara jush kur krahë e duar ndehen,  
fytyrën, sytë mënjanë ua ktheni  
atyre, shpresës suaj që ushqehen.

Sa lot nuk janë derdhur pa shteruar,  
shtëpi sa s'kanë mbetur sot të shkreta,  
sa zemra s'psherëtijnë sot pa pushuar,  
theror q'ju ranë krejt nën thonjtë e mprehtal

Mëkatet shpinës shpirtit që i përbani,  
as posht. në ferr pak vend s'ka që t'ju nxerrë:  
me ujt e detit dot nuk i çpërlani:  
mallkimi do t'ju ndjekë gjatë e gjerë!

Prej gurit zemrën ju sikur e keni,  
që aspak s'ndjeni qarjen e rënkimin;  
ju ligësitë e fajet s'mund t'i fshehni,  
çdo e keqe këtu poshtë e ka çpérblimin.

E lumtur është për besë Shqipëria!  
Ka kryesi në botë si s'ka tjetër,

një rregull e ka lënë perëndia:  
çel një krijesë e re prej një së vjetër.

Përdhe u shtrinë shtyllat e mermarta,<sup>1)</sup>  
prej rrënje u prenë lisat madhështorë.  
Në vend të tyre hije ka të tmercta  
dhe mbi rrënimet ngrihen shpirtmizorë.

U shuan yjtë rrugën q'e ndritonin,  
sa udhëtari më s'ka ku të prehet,  
shteruan dhe burimet që kullonin;  
çdo pemë që çel, helm e hidhur bëhet.

Sot zëri i fortë i luanit<sup>2)</sup> më s'dëgjohet  
që malet i përcante si gjëmimi;  
por zë bretkosash<sup>3)</sup> posht' prej pellgu çohet  
si këngë zie, këngë robërimi.

Mjaft, mjaft! Se u mbush kupa e hidhërimit!  
Gjarprinj, pushoni! Helmin tej e çporrni,  
mos dalim tej kufirit të durimit:  
që më në fund se çmbuallt ju të korrni!

1) Këtu dhe në dy strofat që vijnë pas, poeti idealizon parësinë e vjetër, të kohës së Skënderbeut si udhëheqësen e luftës për liri dhe stigmatizon parësinë bashkëkohore të degjeneruar.

2) i luanit — Skënderbeut

3) zë bretkosash — zëri i parësisë bashkëkohore

## Lulekuqeja...

Lulekuqeja e mjera  
asgjékundi s'ka shtëpi,  
e shkon jetën nd'arrati;  
ajo s'është si të tjera,  
s'ka stoli!

Fushës, kodrës, del vetiu,  
verës ngrohet, dimrit ngrin,  
vetë shkundet, vetë mbin  
dhe kur skuqet, vjen veriu  
dh'e përfshin.

Nëpër këmbë gjith' e shkelin,  
vend më kopshtet ajo s'ka,  
dorë ndihme kurrë s'pa;  
as e mbjellin, as e vjelin,  
shkoi, u tha...

Po veç ngjyra e saj si zjarri,  
si një yll që xixëllon,  
tërë bota e imiton;  
është shenjë për së mbari,  
                             ngat shëkon.

Ajo ngjyrë kur zë çfaqet,  
mbreti fronë shkon e lë,  
njerëz robër fare s'sheh  
vjen e drejta del në faqet:  
                             si zot je.

Ajo ngjyrë nd'ato fletë  
është shpresa, që tregon  
një të ardhme që ëndërron...  
Është flamuri ynë vetë,  
                             që valon!

19018 10.102  
19018 10.102  
19018 10.102  
19018 10.102

19018 10.102  
19018 10.102  
19018 10.102  
19018 10.102  
19018 10.102

19018 10.102  
19018 10.102  
19018 10.102  
19018 10.102  
19018 10.102

**NDRE MJEDA**

MURIE MURIE

## Vaji i bylbylit

### I

Po shkrihet bora  
dimni po shkon;  
bylbyl i vorfën,  
pse po gjimón?

Pushoi murrlani  
me duhi t'yet;  
bylbyl i vorfën,  
çou, mos rri shkret.

Gjith' fushët e malet  
blerimi i mbéloi;  
livadhi e pema  
gjithkah lulzoi.

---

1) Nga libri «Juvenilia» 1917

Nder pyje e ograja,  
n'ma t'mirin vend,  
me rreze dielli  
po e gjazon gjithkend.

E tue gjimue  
shkon rrerh e rrerh  
nji prrue që veret  
rrjedh nëpër gjeth.

A çilë kafazi,  
bylbyl, flutro,  
Ndër pyje e ograja,  
bylbyl, shpejto.

Kërkush ma hovin  
atje s'ta pret;  
me zeher haejen  
kërkush s'ta qet.

Kafaz ke qiellin,  
epshin pengim;  
e gjith'ku t'rreshket  
shkon fluturim.

Nëpër lamije  
ke me gjetë mel;

për gjith' pranverën  
njajo bukë t'del.

E kur t'zitë eti  
ndër prroje pi;  
te njato prroje  
që ti vetë di.

Tash pa frigë çerdhen  
e ban n'do'j lis;  
nuk je si i njeri  
që nuk ka fis.

E kur t'vijë zhegu  
kur dielli shkon,  
ti ke me kndue  
si ke zakon.

Rreth e rreth gjindja  
me t'ndie rri;  
prej asi vendit  
dahen me zi.

A çilë kafazi,  
bylbyl, flutro;  
ndër pyje e ograja,  
bylbyl, shpejto.

Ndër drandofille,  
ndër zambakë nga;  
ku qeshet kopshti  
idhnim mos mba.

Po shkrihet bora,  
dimni po shkon;  
bylbyl i vorfën,  
pse po gjimon?

## II

Por vaj se'j dimën tjetër  
paske, o bylbyl i shkreti,  
pa da ty zemra t'treti  
mbas vajit që t'rrethon.

Me lulzim t'vet pranvera  
ty s'ta përtrin gazmendin;  
jo kurr' s'e njihke shendin,  
bylbyl, që po vajton.

A thue po kjan, se çerdhen  
ta ka shkatrrue skyfteri?  
A thue po kjan, o i mjeri,  
se me rrnue gjallë s'ke, mel?

Ndrrojnë edhe stinët e motit,  
e për gjith' pas ndrron era;  
mbas dimnit vjen pranvera,  
mbas borës blerimi del.

Veç ti me idhnime t'tu'ja  
n'zemër gjithmonë po pihe,  
e ditë e natë po shkrihe  
mbas vajit që t'mundon.

Kur a tue ardhun drita  
ndihet tue këndue shpendi,  
e n'kangë i duket shendi  
që zemrën ia gazmon.

Njeti ndër pemë, ndër lule  
shkon e flutron, bylbyl;  
n'at' erë që nep zymbyli,  
vjelca e zambaku ngjet.

Por ty n'kafaz t'shterngueshëm  
ty t'paska ndry' mizori,  
e kurr' nji herë nuk t'nxori  
me t'l'shue ku zëmra t'thret.

Ti kurrnji kangë s'ia këndove  
diellit kur nadje çohet;

zemra me vaj t'coptohet  
e me pajtue nuk don.

Ndoshta kujdesi i t'tu'jve  
gjith kët idhnim ta qiti,  
e shendin ta shutiti  
e vshtira që i mundon.

T'burguem i bani gjindja  
veç përse donë me ndie  
njat za që l'shojnë me hije  
që t'k'naq e që t'ban rob.

Çdo krajl i madh ndër shpia  
ty t'mba m'u thanë i veti;  
vetë bukuria, o i shkreti,  
kenka për ju nji kob.

Përse tu ndeja e t'mëdhajve  
nji shpend i vogël s'ndalet;  
shpendit i kande malet,  
çerdhen e t'parëve do.

Me at' zanin tand t'përmallshëm  
ndoshta ti ankon këto t'v'shtira;  
derisa t'kthejë e mira,  
bylbyl, pa pra gjimo.

### III

Por njaj vaj që je tue lshue,  
bylbyl, zemrën ma copëton;  
ditë e natë rrij tue prigjue,  
vaj për mue, kush mund t'ngushllon?

Gjama e jote a porsi ankimi  
i nji fmijës që vetun mbet.  
Gjama e jote a si shungllimi  
i nji t'zezës që gja s'e pret.

Forsi dnes me futë në krye  
nana e shkretë që mbet pa djelm;  
njashtu tine rri tue shfrye  
njat idhним që t'u ba helm.

Puna e jote, o i mjeri m'mbyti  
e kërkund nuk m'len pushim;  
shkoi nji muej, po shkon i dyti,  
t'zezat t'tuja s'kanë mbarim.

Tash ndër arë lulzoi qershia,  
e me borë dimni po shkon.  
Kurr' s'mbarojnë t'zezat e mia,  
gjama e jote kurr' s'mbaron.

Si t'burguemit n'ishull t'detit,  
ku tallazi thekshäm vret,  
o t'vijë t'ftohtit o t'vijë t'nxehtit  
vaji zemrën ia pölset.

E pa pra n'ankime t'veta  
vajton fisin që larg la;  
e tu fmija i shkon si zhgjeta  
mendja e shkretë se mbet pa ta.

Njashtu ti rri tue vajtue  
n'njat kafaz qi shungullon;  
fisin tand rri tue mendue  
t'zi'n atdhe që s'e harron.

Pér fat tand, pér zogj që kishe  
ndoshta zemra, i mjeri, t'dhemb;  
me e pasë ditë të mjerët ku rrishë  
kërkue t'kishin gemb mbi gemb.

Me e pasë ndie njat za që lëshoshe,  
me e pasë ndie njat vajin tand,  
kishin ardhë kudo që t'shkoshe,  
t'kishin lypun kand e kand.

Njat vaj tandin tue kujtue  
pa mbyllë sytë kan' shkue sa net

pvetshin hanën tue gjimuë,  
pvetshin hyjt pér prind tē vet.

Por ai kob që hana e diti  
e njaj vaj që hylli pau,  
t'shkretve n'vesh kurr nuk iu mbrrijti,  
c kurr' zemra nuk ju ndau.

Me ditë hyjt me bisedue,  
me pasë sy që me derdhë lot,  
vajit tand iu kishin prue,  
t'kishin kja pér jet' e mot.

Nëpër fushë e nëpër shpia,  
me ziti<sup>1)</sup> që s'nep afat,  
rreth e rreth t'kishin ardhë f'mija,  
kjamun t'kishte i ngrati fat.

#### IV

Por ça ka toka, bylbyl, ndrroni moti;  
ankimi e vaji nuk asht i zoti  
përgjithmonë zemrën me na coptue;  
fillo me gëzue.

---

1) me ziti — me ngut, me nxitim

Mbas boret t'dimnit çilet pranvera;  
nji ditë nuk gjindet që s'po ndrron era,  
sendet qi patmë janë tue mbarue;  
                                fillo me gëzue.

Tue dnes'i vorfni se e mbëluene t'kqijat,  
me ankime t'veta mbushë rrugët e shpiat;  
lekim por, s'mbramit, gjen tue punue;  
                                fillo me gëzue.

Kjajnë fëmin'e dekun prind'e shkretnuem  
me 'j vaj, që duket se s'ka t'pajtuem!  
Por zemrën moti jau ndrron tue shkue;  
                                fillo me gëzue.

Ndër ishuj t'detit kjan i burguemi  
për f'mij, për grue, që s'sheh i shuemi,  
por prap' durimi ka me ia prue;  
                                fillo me gëzue.

Shpend tjetër burgosi sa herë mizori,  
e rishtas jashta dikur i nxori;  
ndër fushë e male janë tue flutruar;  
                                fillo me gëzue.

Flutrojnë ndër male, flutrojnë ndër lule,  
flutrojnë ku çerdhen motit e ngule

e kangët e parshme nisin me këndue;  
fillo me gëzue.

Ndër zogj që kishe ndo'j herë do t'hasin,  
ndër pemë, ndër lule bashkë me ta ngasin;  
për ty t'vorfnuemit rrijnë tue shpresue;  
fillo me gëzue.

Krajlnit'ma t'moçmit ndrrohen me t'reja,  
e njimij' popuj ranë porsi rr'feja;  
po kthen motmoti, që pat mbarue:  
fillo me gëzue.

Porsi motmoti ndrrojmë dhe na vetë,  
herë herë gazmohna, herë rrimë të shkretë,  
por vaji e ankimi kanë pér t'u shue:  
fillo me gëzue.

Mbas vajit t'tashëm ka me t'ardhë shendi,  
ka me ta shëndoshun zemrën gazmendi;  
për mall, si motit, zanë ke me e lëshue;  
fillo me gëzue.

Kur t'shkojsh ndër fusha, kur t'shkojsh ndër  
male  
afër shpis' seme hovin tand ndale;  
mahnitë, atë zanin tand tue prigjue,  
kam pér t'u gëzue.

## Liria

### I

O shqipe, e zogjtë e maleve, kallxoni  
a shndritë rreze lirie mb'ato maje?  
Mbi bjeshkë të thepisuna e nd'ograje  
ku del gurra e gjimon përmallshëm kroni?

A keni ndie ndokund kah fluturoni  
nëpër shkrepë me ushtue kangën e saj,  
a keni ndie një kangë të patravajë?  
O shqipe, o zogjtë e maleve, kallxoni.

Lirim, lirim bërtet gjithkah malcia;  
a ka lirim ky dhe që n'a shklet kamba,  
a veç t'mjerin e mb'lon anë mb'anë robnia?

Flutro, shqipe, flutro kah çilet lama,  
sjellju maleve përreth që ka Shqipnia  
e vështroje ku i del lirimt ama.<sup>1)</sup>

---

1) ama — burimi

## II

Nëpër fusha ku rrjedh Misisipia,  
ushtoj rrökull nji za si bumbullima;  
krisi ndër male si kërset ushtima,  
kur qiel e tokë turbullon duhia.

## V

Lirin'e keni ju! Na hekrá kemi.  
Na terr e mjegull deri në dit'ma të vona;  
na pa emën kërkund, pa atdhe; na jemi  
shërbtorët e të huejve nëpër vendë tonë.

Porsi berre qi bleu mishtari vemi  
mbas shkopit, të kalamenduna, ku s'dona.  
Ahte t'ankueshme nëpër buzë polemi<sup>2)</sup>  
vaj e mjerime qet këjo tokë e jona.

E kot duhia e trimënis' malcore  
nëpër fusha të molisuna plandosi  
si kokërr rrfeje prej nji reje lëshue.

Çuditë prej peshës së nji pushtedës mizore,  
kot Dukagjini e Skanderbeg fatosi  
shpupurisin ndër vorrre eshtna të harrue.

2) ahte t'ankueshme nëpër buzë polemi — ahte ankimi  
nëpër buzë të popullit

Por nuk u shuejti edhe, jo, Shqyptaria.  
 Lodhun prej hekraш qi mizori i njiti,  
 lodhun prej tenri ku robnimi e qiti,  
 shpreson me e zgjue fluturim mënia.

E këqyre: ndër male po përhapet shkëndija  
 e lirimit 'Atdheut; fshehtas shetiti  
 kësollë për kësollë rrëth buneve e soditi  
 frymë te re tue shprazun për gjithkah, hija

e Skanderbegut. Që ndër djepa rrisin  
 nanat e Hotit djelmënин' ushtore,  
 e idhnim n'anmikun nëpër gji iu qisin.

E nalt, ndër maje, bukuri mbretnore,  
 hapi flatrat e mnershme qi përshndrisin,  
 me thonj t'harkuem, Shqipeja arbënore.

lloj i t'përmjetjeve, qëndrueshme  
qëndrueshme, qëndrueshme, qëndrueshme,  
qëndrueshme, qëndrueshme, qëndrueshme,  
qëndrueshme, qëndrueshme, qëndrueshme.

## Malli për atdhe

Ndër nji kto vende për bukuri  
dheun tem i shuem i jam tue di shrue;  
ndër dhena t'hueja, po si n'shkreti,  
t'përmjetjeve, qëndrueshme, rri tue gjimue.

A e bukur fusha kur çil pranvera,  
lul'zim ka kopshti, kur lulet dalin;  
e drandofilles ndër fushë tret era  
t'përmjetjeve, qëndrueshme, e përtej malin.

Por gjith'keto t'mira ngushllim nuk m'apin;  
për atdhe temin zemra pa m'shkrihet;  
nj'atje kur mendja ll'shon ndo'jherë vrapin  
t'përmjetjeve, qëndrueshme, shendi i përtrihet.

Ndër lisa t'pyjve, bylbyl, tue këndue  
për çerdhe tande po ban ankime;  
mue, i mjerë bylbyli, po m'përgjan mue  
me k'to dertime.

Sa herë nën hije t'ni farë çinarit!,  
afër nji kronit qi i shkot përbri,  
për vend mendohem, ku ndodh s'parit,  
n'vaj tue u shkri.

E pves tue skjamtun erën e kronin  
për fushë e male ku mendja m'vret;  
por tue rrjedhë uji, si e ka zakonin,  
gjimon e s'flet.

Prej majës s'malit shikjoj larg fushën  
ku kah di se a vendi qi jetën m'fali;  
por prej trishtimit me lot syt' m'mbushen  
e s'muند t'i ndali.

O bjeshkë e male, fusha t'bekueme,  
ku vëtëherhera për sheti shkoshe;  
O Maranaj, o Buenë e mbëlueme  
me bimë gjelbroshe.

Kur kam me t'u gëzue? Ndër nj'ato kësolla  
inë e pagjtë e kandshme m'u duktejeta;  
ndër dhena t'hueja, ku mbrapa u ndolla,  
veç trishtim gjeta

1) çħarġ - rrap

Na dha me t'shkretve vetë perëndia<sup>2)</sup>  
mallin m'u pamun, me ndejë n'nji votër  
grueja me t'shoqin, me prindën fëmija  
e vllau me motër.

Nj'aj zemër njerit, nuk ka qì u dh'timin  
për mirakanda merr me u begatue;  
larg teje, o Shqipe, kush lyp gjallimin  
po, do mallkue.

Do varre t'reja ndodh qi m'kallxojnë,  
ndoshta tue kjamun prej dhimet gjiindja;  
nji k'tu, do t'm' flasin, t'rrin'e pushojnë  
vllaznit e prindja.

O prind, o vllazen, te'j vorr me jue  
e gjallë e i dekun unë do t'rri;  
sa do n'gjuhë teme kan' me m'urue:  
«Dritë pastë n'lumni».

2) Mjeda, ashtu si dhei poetët e tjenë të Rilindjes, kishte  
dhe pikëpamje idealiste.

## Gjuha shqipe

Përmbi za, qì lëshon bylbyli,  
 gjuha shqype m'shungullon;  
 përmbi erë, qì nep zymbyli  
 pa da zemrën ma ngushllon.

Ndër komb' tjera, ndër dhena tjera  
 ku e shkoj jetën tash sa mot,  
 veç për ty m'rreh zemra e mjera  
 e prej mallit derdhi lot.

Nji kto gjuhë, qì jam tue ndie  
 janë të bukra me temel;  
 por prep' këjo, si diell pa hije,  
 për mue t'tanave ju del.

Edhe zogu kërkon lisin  
 mbi shpi t'artë ku rri me mbret;  
 e shtegtari dishron fisin  
 përmbi vend qì s'asht i viet.

O Shqipni e mjerë Shqipnia,  
plot me burra e trima plot  
ti'j'dit'ishe; por lumnia  
qi ke pasun, nuk a sot.

Nën nj'at' tokë, qi ta shklet kamba,  
zam' e t'moqmëve vështo;  
për bij t'tashëm, porsi e ama  
e t'koritunve, gjimo.

Nam e za, qi kishe, t'treti,  
e vleç turpi e marrja t'mbëloj;  
për lumni veç kore t'mbeti,  
qyshse fara e mirë mbaroi.

Por gazmo ndër gjith'k'to t'vshtira  
përse ende s'sharrove krejt.  
Diçka t'mbet ndër ato t'mira  
mbas dy mij'e ma shum'vjet.

T'ka mbet' gjuha, qi po ndihet  
n'fush'e n'mal, qi ti zot'non;  
Gjith'ku hija e jote shtrihet,  
ku shqiptari za'n'e lëshon.

Geg' e toskë, malci, jallia  
jan nji komb, m'u da s'duron;

fund e maje nji a Shqipnia,  
e nji gjühë t'gjith'na bashkon.

Kjoftë mallkue kush qet ngat'rrime  
ndër k'ta vllazën shoq me shoq:  
kush e don me flak'e shkrime  
ça natyra vëtë përpoq.

Por me gjuhë kaq t'moçme e mjera  
si i'bij'kje qi pa prind mbet;  
për t'huej t'mbjashin dhenat tjera  
s't'kishte kur për motër t'vet,

kur nji burrë u çue n'Austri  
e me sy gjithkund t'kérkoi;  
Gustav Majeri asht emni i tij,  
emni i burrit qi t'madhnoi

Porsi dielli, tue flakue,  
shpérndan terrin qi na mbëlon,  
njashtu Majeri tue kërkue  
kah ke dalë po ta difton.

T'ditfon motrat, t'difton fisin  
nëpër shekuj fluturim,  
t'çon nj'atje ku luftnat krisin,  
ku a kap' Roma e Iliri shqim.

Nji k'to t'hot' (e ti s'e dishe),  
janë t'bijt t'tu, qì pate mot;  
këta janë burrat, qìj ditë kishe,  
emnit t'and me i dalun zot.

Nën gjytët, qì ma vonë cili  
kombi i yt luftar ma pak,  
ku ish mbrjet at'botë Bardili,  
shum'anmiku derdhi gjak.

E nj'at tokë, qì je tue gëzue,  
e kë xanë tesh sa mij'vjet,  
Shqiptaria; që mbet mbëlue  
sot nën dhe, edhe shqip flet.

Flet më rrasa, flet më sende  
ku lumnin'e vet e shkroi;  
por kërkush s'i di këto vendë,  
e harrimi t'tana i mbëloj.

Por, gjithnji, nën kambë po ndihen  
burrat t'u, qì toka i mbëlon,  
e nën dhe kocijt' përzihen  
si 'j arë grun', kur era lëshon.

Don' m'u çue e gjith' për s'mbarit  
me u pri nipave mb'nji cak:  
don'më t'ba si ke kenë sparit  
t'nderës me kapë t'lumnueshmin prak.

## Mustafë Pasha

*në Babune*

E pranë vallet ndër male unji<sup>1)</sup>  
e ushtima e pushkve ndër lugje mejti;<sup>2)</sup>  
ndër festa e t'kreme n'fushë e n'malci  
burrnimi u dejti.<sup>3)</sup>

E djerr a toka: krrut<sup>4)</sup> ndër livadhe  
shkon kau, e avllin qi del prej arve  
erton, e nepet pér stinë të madhe,  
pér rrëth t'kularve.

Por mb'zgjedhë mbërthyё kularët pushojnë  
vjerrun nën trena, e rri n'gardh parmenda;  
e n'mal pa njeri berret firojnë,  
o dridhen mbritënda

1) unji — në të gjitha anët, krejt

2) mejti — pushoi

3) u dejti — u zhduk, s'u pa më

4) krrut — i kërrusur

Vathit, ku unshëm sillet ulkoja,  
e rrmon me kthetra dyert që baria  
dikur përtrini; sot hull<sup>5)</sup> e zoja  
pa burrë te shpia.

Mbas tejet, Shqipe, burrat flutruene  
ndër male t'reja, m'nji lugje t're;  
ngadhnjim o dekën tue lypë u lëshuene  
t'gjith' për Atdhe.

E luftojnë rrebtas: mën breshën plumbit  
që karajfilet<sup>6)</sup> lëshojnë e bërshanat,  
turren, O Shqipe, si rrjedha e lumi  
trima si zamat.

E pasha, ndejun mbi thasë t'florijve  
ndër valle jevgash, n'lodër dudumash<sup>7)</sup>  
tallet i knaqun prej zanit t'fqinjve,  
si qen mbas trumash.<sup>8)</sup>

O pjellë e keqe o dhunë, o kore!<sup>9)</sup>  
qe shtojzavallet, pa e dijtë, po kcejnë  
me ty e zgërdhihen, e'j kangë mortore  
nën za shpërthejnë.

5) hull — afron

6) krajfilet... bërshanat — dy lloj pushkësh të gjata me çark.

7) dudumash — të tredhunisht

8) trumash — bushtrash

9) kore — turp

Ora e shqiptarit t'lëshoi, e fatosat  
qi n'luftë, pa shkrëpun, shkrine n'marri,  
gjykim po lypin, e thekshëm kosat,  
shpirtna me mni,

Sjellin n'shpi tânde. Qe Mehmet Begu  
ështna t'shpulpuemum mbi vorr tu' u çue  
idhun prej s'largut t'thotë: «Këtune a shtegu  
me folë me mue.

Këtu t'prita<sup>1</sup> q'motit: këtu do t'paqohet  
vaji i një femnës që n'mjerim lëshova,  
pa faj. Shqiptari këtu do t'kujtuhet  
se hupës nuk shkova».

E prej gjith' fushash bajnë valle t'mnershme  
arët e livadhet që 'j ditë grabite:  
sot vonë, më t'rebshëm përfaje t'hershme  
gjykimin prite.

Del, Mizuer, këndenaj, del; prej mërzijet  
zgaq<sup>10)</sup> i përbuzshëm, Shqipnia t'volli;  
ty shpina e detit, ty, vend robnijet,  
t'pret Anadolli.

---

10) zgaq — llum, i poshtër

# **FILIP SHIROKA**

23.22(0.1) 2.0(0.1) 2.0(0.1)

## **Shko, dallëndyshe!...**

Udha e mbarë, se erdh prendvera.  
Shko dallëndyshe tue fluturue,  
prej Misirit n'dhena tjera  
fusha e male tue kërkue;  
n'Shqypni shko, pra, fluturim,  
shko në Shkodër, n'qytet tim!

Shndet prej meje të m'i falësh  
asaj shpis'vjetër ku jam le,  
me ato vende rrëth t'përfalesh,  
ku kam shkue kohën e re;  
atje shko, pra, fluturim,  
fal më shndet qytetit tim!

Me ato male, me ato kodra,  
me ato pproje rrëth t'përfalesh;  
n'ato fusha që m'ka Shkodra  
të lulzueme, aty t'ndalesh,  
tue këndue me ambëlcim:  
fal me shndet qytetit tim!

T'mujshe edh'un'më fluturue,  
dojshe dhe un'me u nisë me ty,  
dojshe n'Shkodër me kalue,  
m'e pa prap' at vend me sy!...  
Por... ti shko atje fluturim;  
e ti qajma fatin tim!...

Dhe kur t'mrrish në Fushë t'Rrmajit<sup>1)</sup>  
dallëndysh', ulu me pushue;  
kam dy vorre n'at vend t'vajit,  
t'nan's e t'bab's që m'kan' mjerue:  
qaj me za t'permallshëm shqim  
nji këngë tandem gjith'vajtim!...

Ka shum'kohë që s'jam n'Shqypni  
n'ato vorre me vajtue,  
ti, dallëndyshe, veshun në zi,  
ti aty pra qaj për mue,  
me njat za t'permallshëm shqim,  
kangën tandem për vajtim!

1897

---

1) Fushë t'Rrmajit – varrezat

## **Dallëndyshe, eja!...**

Mirë se vjen, me krah të letë,  
dallëndyshe, tuj fluturue!  
Mirë se vjen m'ket anë të nxetë  
t'dheut t'Misirit me dimnue:  
eja, pra, ktu fluturim,  
m'gzo me at za gjith' ambëlcim!

Kur je nisë t'kam porositun  
atje larg t'shkojsh kah Shqypnia;  
m'difto, pra, kur ke shetitun  
a t'kan'ra n'mend fjalt e mia,  
me m'shkue n'Shkodër fluturim,  
me m'i'u falë qytetit tim?..

Atje malet, n'i paç pa,  
janë prej boret nalt zbardhue,  
n'ato fusha, në paç ra,  
janë me lule lulëzue,  
atje n'paç vojtë fluturim,  
aty asht qyteti im!

Barit t'njomë gjith'atje veshen  
çuka e kodra, e atje ndinë  
tue këndue blegtoreshën.  
•qi kullot rreth bagëtinë;  
atje n'paç vojtë fluturim,  
aty asht qyteti im!

N'Shkodrën t'ime të Shqypnisë  
burrat lejnë që s'dijnë ç'asht friga,  
çupat e bukura t'urtisë  
atje lejnë që s'dijnë ç'asht flliga;<sup>1)</sup>  
atje n'paç vojtë fluturim,  
aty asht qyteti im!

Dishroj shum', por... nuk po di  
a kam prap' fat t'mirë me shkue  
nji herë tjetër në Shqypni,  
n'Shkodrën time me kalue...  
Atje dù t'shkoj fluturim,  
t'vdes, aty n'qytetin tim!...

T'kam pasë thanë... se n'Fushë t'Rrmajit  
kam dy vorre t'dashtunisë,  
nanë e babë kam n'at vend vajit,  
qi m'kanë lanun t'vorfënisë:  
me zanë tand t'përmallshëm shqim  
a ke ba mbi ta vajtim?!

---

1) flliga — flligjshëtia morale

A u ke thanë se un't'kam çue  
prindët e dashtun me m'i qa?  
A u ke thanë sa kam lotue  
kur t'kam nisë vorrin m'e pa?  
A e ke thanë, t'përmallshme shqim,  
kangën tandem gjith'vajtim?

A u ke thanë se zemra ime  
n'dhena t'hueja keq u shkri,  
se s'ka gzym, as s'ka ngushllime  
se po digjet për Shqypni?  
Me zanë tand t'përvajshëm shqim,  
a e ke qamun fatin tim??

Pra, dallndyshe, kah ke shetitun  
qytetin tim a e ke pa?  
N'ato vende ku ke rritun,  
n'mend për mue a të ka ra,  
me m'shkue n'Shkodër fluturim,  
me m'iu falë qytetit t'im?

**1898**

## **Te vorri i Skanderbegut**

*Në kishën e Shën Kollit në Lesh*

Ktu Skanderbegun e kanë pasë varruemun,  
t'parin e luftarve, t'Madhin e Shqipnisë,  
ktu kanë pasë vorrue ate që pat shituemun  
n'njizet e dy lufta ushtarët e Turqnisë.

Ktu asht vorr'i Tij, dhe sa mot ka kaluemun,  
kurr' nuk i asht sosun vlera e lumnisë,  
se asnjiherë bota s'mundet me i harruemun  
t'Skanderbeg shqyptarit tregjet e trimnisë.

Kurr' nuk vdes Trimi, se gjithherë e ndritun  
i qindron fama dhe me nder emnohet  
dersa hyjt', hana e dielli kanë me shndritun!

Ardhka pra nji kohë që me shkrola t'arit  
sipri kti' vorrit të nderuem të shkruhet:  
«Ky asht vorri i t'Madhit Skanderbeg shqyptarit».

## Kombit tonë

Vimë nga pelazgët, njerz të lavduem  
ç'në kohët e vjetra të njerzisë,  
jemi t'permendun e të nderuem  
ç'në kohë të moçme të historisë.

Komb kreshnik jemi, jemi ushtarë,  
kemi luftue trimnisht gjithmonë,  
nga Shqypnia kemi emnin shqypëtarë,  
me shqype kemi flamurin tonë.

Asht mjaft i vlerët komb' i shqyptarit,  
me t'mira zoti e ka begatue;  
por... ç'se pat ramun n'dorë t'barbarit  
ky komb i nderçëm keq asht mjerue!

Në mes tonë solli anmiqësinë,  
vllaznit me vllazen t'vet i helmoi;  
na hupi nderen e bashkëninë  
dhe n'faqe t'botës keq na turpnoi.

Fjalët e anmikut tue i ndigjue,  
«Baba Dovlet» s'asht tue na lanë  
në Shqypni tonën shqyp me na mësue,  
e n'shkolla t'hueja fmijtë tonë po nxanë.

Për me na mbajtun në robëni,  
na suell mjerime, na ka rrënuar,  
e drejta hupi, e në Shqypni  
nuk ka shqyptari ku me ankue!...

Çoniu nga gjumi, birt e Kastriotit,  
se robënia turp asht për triminë,  
çoniu, bre burra, për emën t'zotit,  
nër male e n'fusha qitni kushtrimin!

Çoniu sokola, çoniu nji herë,  
çou, ngjeshi armët, burri Shqypnisë:  
përpara botës s'ka robi ndër:  
turp asht për trimin zgjedha e robnisë!

**1899**

## Kushtrimi

Kur dhenë tonë n'rrezik e kemi,  
pleq e t'rij çohemi m'kambë,  
mal në mal vikat kushtrimi,  
kalon zani anëpëranë.

Gjithkush asht shqyptar lëkundet,  
e rrok pushkën gjithkush mundet  
tue vikatë, si ç'kem zakonë:  
«Bini, burra, anmikut tonë!»

«Bini, burra, anmikut tonë!»  
thrrasin nënët djelmënisë.  
«Bini, burra, anmikut tonë!»  
gjimojnë malet e Shqypnisë.

Nuk na ndanë kisha as xhamia,  
të gjith'lidhëmi me nji besë,  
ryrash n'luftë bie djelmnia  
marre kombit mos t'i mbesë.

Me gjak t'vet na kanë lanë shkrue  
babat tonë në fushë t'ushtrisë:  
«Djal'mbas djalit qoftë turpnue  
ai që s'i del zot Shqypnisë!»

Se n'ket dhe janë shpijat tona,  
fushë e male tonat janë;  
n'dhena tona anmiq nuk dona,  
votrat tona anmiq xanë!

Gjuha shqyp gjithkah ku flitet  
dhe ku len burr' i Shqypnisë,  
n'qoftë se anmiku po afritet,  
ndesh sokola n'lamë t'ushtrisë.

Jemi bijt' e Kastriotit,  
për soj na e kem burrninë:  
tym e flakë, me ndimë të zotit,  
shprazin malet për Shqypninë.

**1898**

**LUIGJ GURAKUQI**

COLONIALISM IN INDIA

## Dallëndysha u këthye

*Gegë Postripës*

Ti, dallëndyshës, je porositun  
vendin tand me shkue me pa,  
nëpër Shkodër me shetitun,  
mi vorr t'babs e t'nans me t'qa,  
n'shkollë, n'shpi tande 'i her'm'u ndalë,  
me miq t'motshëm m'u përfalë.

Erdh njimend e nepër Shkodër  
shum'kërkoi tue fluturue,  
rrugës, n'livadhe, n'mal e n'kodër,  
me kangë t'vet na ka gazmue;  
n'Fush' t'Rrmajit asht ndalue  
e mbi vorre ka vajtue.  
Në prendverë ktej porsa mrrini  
miqvet t'uej iu fal me shndet,  
nepër shkollë, nepër kishë hini,  
me ta hjekë at kasavet,<sup>1)</sup>)

---

1) kasavet — brengë

e n'shpi t'vjetër ku ke le  
Ka goditë çerdhen e re.  
Por kur kthej, me t'thanë a diti  
miqt', qytetin, punt si i la?  
Para sysh Shqipnin a t'qiti?  
A e harroi ndoj send belda?<sup>2)</sup>  
A t'kallxoi gjithçka kish pamun?  
Si mbi vorre kishte qamun?

Por prej prindsh ndoj shndet, ndoj fjalë,  
ndoja bekim a ta ka pru?  
Mbi rrasë t'tyne kur a ndalë,  
ndoja tubë lule a ia kish vu?  
T'zezat ton a t'i kallxoi?  
Me kangë t'vet a t'i diftoi?

Mirë po shoh se ke shum'mall  
për me u gjetë nji her n'Shqypni;  
ik pra e eja për të gjall'  
me miq tu m'u knaq', m'u ngi!  
Eja vetë n'Shkodrën m'e pa,  
eja vetë n'Rrmaj me qa!

---

2) beldat (turq.) — ndofta

## Zogzës kryezezë

Po pse, moj zogza ime, kështu m'harrove  
e këtu ma nuk po shihe  
tu u tundë mbi at gëm dullije  
ku pér sa dit' n'e nadje aq mallshëm këndove?  
Po a thue s'do t'këthehesh ma, apo nga unë  
ndër lule e gjeth po fshihe,  
e s'do ma t'm'bajsh me ndije  
zanin t'and t'dridhun, ndoshta me m'ba dhune  
pse tepér t'mora mbrapa  
e fort mbas teje u kapa?

Apo gja tjetër t'ndal t'marrsh fluturimin  
e t'këthehesh n'breg t'këtij prronit  
me zanë kangën e parëshme,  
me notat t'lautit tim, me murmurimin  
t'puhizes s'lehtë e t'ujit me e bashkue?  
E mbrapa, pas zakonit,  
e butë e gjith'e mbarëshme,  
me ardhë përmbi dorë time me pushue,  
me zanin tand me m'kënaqun,  
e t'ndiemet t'tua me m'shfaqun?

A thue, moj zogzë, t'ndodhi ndonji e keqe,  
a thue, si e pavaditun  
qi je, fjalës s'njaj skyfterit  
iu bane vesht e rae ndër t'tijat leqe?  
Ah po, mori fatzeza! Sa fort u rrejte!...  
Mbas shpinet ti tue qitun  
këshillet e mue t'mjerit,  
rae n'lak, tue bjerrë çka t'ish ma shum'e shtrenjtë:  
bore, po, lirin tande,  
qi aq fort ta kishte kande!

Njimend se arit shndritshëm ma se dielli  
thuprat i ka kuvelia  
ku ndër këto dit t'kan ndrye;  
por prap' asht burg për ty, sikur asht filli  
i mëndafshtë qi n'kambë t'kan lidhë, vargue i  
vështirshëm  
aty ndër t'zeza e t'kqia,  
prej mallit keq tue rye  
ke për t'shkue jetën; e, sa herë i lirshëm  
tek un t'flutrojë mendimi,  
ka për t'trazue pendimi.

E kështu për ty do t'rrjedhin moti e stina  
der q'kangë mos t'kenë mbetun,  
e koha, pendësh tue t'deshun  
mos t'hapin dyert e t'sjellë prap' n'këto krahina;  
atëherë, ah po! do t'lanë e këtu do t'këthehesht!...

---

1) rae n'lak – re në lëk

Por mue s'ke pér t'm'gjetun,  
as ma s'ke pér t'i ndeshun  
shoqet e moçme e në vetmi do t'mbetesh  
deri qi toka, t'shueme,  
mos t'mbledhë n'paqë t'pambarueme!

## **T'falun atdhetarit të Kosovës<sup>1)</sup>**

*Për të mira që a tuj u përpjekë me ba për gjuhë shqipe*

Sado nen emën i t'Kosovës je mblue  
po m'dan prej Shkodrës s'ime;<sup>2)</sup>  
vllaznisht po t'falem pra që ke fillue  
me i prue gjuhës sonë lulzime.

Me t'drejtë sot ka përse m'u gzue Shqipnia,  
sot ka ke me thirrë bir;  
pse me i rritë emnin po punon djelmnia,  
e gjuhën me ia ddirë.

Ket gjuhë t'tingllueshme, e'ambël e trimneshë,  
ket gjuh'plot bukuri  
qi ne t'mjerve na e çon gjith'zemrën peshë  
n'dhe t'huej lark tuj e ndi.

---

1) Mati Logorecit, një nga lëvruesit e shqipes letrare.

2) m'dan — më duket

Por prap' sot janë disa qi edhe s'kuptojnë  
i gjuhës ç'asht përparimi;  
tuej ndrrue gjuhën t'falitunit mendojnë,<sup>3)</sup>  
se vjen qytetëni.

Ktyne njerzve qi mbahen gjind me krye,  
sa t'dalin prej gzhøjës s'vet  
e t'rrinë jashta do dit', kur kanë me kthyë  
s'ke shqip ma pse iu flet.

. . . . .

---

3) t'falitunit mendojnë — mendojnë humbjen

## **Qindresa**

Me gusht shkon vapa e me djelmni kalojnë  
gjith' prallat e kohës s're;  
si n'dimën bora dhenë, kryet na zbardhojnë  
vjetët e kujdeset ne!

Me lule t'ershme e larca m'dukej shtrue  
bota sa ishe i ri;  
n'gaz m'shkontejeta, s'm' nepej kurr m'u ankue,  
kur zemra s'm' ndjellte zi.

Andrra t'kandshme m'livrojshin nëpër mend  
si flutra pa ia da!  
T'lum si vdesin nuk njifshe tjetërkend,  
nuk dijshe kurr' me kja.

Zanat tek unë shpesh zdrypshin, e n'Mal Shejt  
m'flakrojshin me mendim;  
e vetë, sa niste Apolli me dridhë pejt',!<sup>1)</sup>  
ia thoshe kangës me gjim.

---

1) Apolli me dridhë pejt — këtu, me dalë agimi

Shum' herë te bregu i prronit, mblue prej barit  
ku, rrokun dorë pér dorë,  
valles ia krisëshin nymfat me flokë arit,  
e mblidheshin kunorë,

shkojshe prej nadjes, e nën t'kandëshmen hije  
t'nijj lisi n'gjeth,  
pér t'gjatë u shtrishe, e t'etshëm bukurije,  
syt siellshe rreth e rreth.

Rrjedha e ujit përciell me fyell të barit,  
me delet tuc kullotë,  
m'thirrte gjumin; un' ndejë në prehën të gjithsis',  
nisëshe nga pak m'u kotë.

Era, tue shkelë mbi lule pa lanë gjurmë,  
me flokët e mi tue luejtë  
shkonte; vetë flejshe... engjujt, pa ba zhurmë,  
zdrypëshin nën krahë me m'ruejtë!

Por andrrat sot kaluen, prallat djelmore  
janë zhdukun e kanë tretë;  
ideve t'bukra, shpresavet lulzore  
veç emni u ka mbetë.

Oh jeta pernjimend me rrena e vaj  
plot qenka n'ket botë t'lashtë!  
U shueka tepër shpejt lakmimi i saj,  
si zjarmi i bam' me kashtë.

Veç një qëllim i naltë t'ban me durue,  
e zemrën ta forcon:  
ndër kundërshtime s'vyen kurr me u ligshtue.  
Mjer' ai që nuk qindron!

**HILË MOSI**

1200ft. 8.1111

## N'armë, Shqypni!

Çka gjeti, t'gjith'shkretroi rrufeja,  
gjithkah rrënimet jan'kah gjajnë —  
me fut'të zez'u mblue Atdheja,  
të gjith'me lot t'përgjakshëm qajnë.

Ah, lenje vajin sot, o burra!  
Se vaj prej nesh Shqypnia s'pret,  
por veç ndër armë mbi shkrepë e curra  
me vdekë për të ajo na thrret!

Ndër arm'! Ndër arm'! Se zbardhi drita  
që qindra vjet Atdheu po pret!  
E fundit kjo për ne asht dita,  
se ma asgja për ne nuk mbet.

## Kënga e shoqërisë «Vëllazëria»<sup>1)</sup>

Sot gjith'djalëria  
ç'është kah po pret?  
Sot «Vëllazëria»  
ne po na thërret.  
Shpejt, o djalëri,  
ngrihu për liri!

Vëllezër qem'e jemi,  
ne askush s'na lot;  
gjith'një gjuhë kemi,  
nuk na ndajnë dot.  
Shpejt, o djalëri,  
ngrihu për liri!

Na vëllezër jemi,  
s'kemi për t'u ndarë;  
bes'e fe na kemi

---

1) Shoqëria sportive e djemve në Korçë, themeluar më 1909. Pjesëtarët më të mirë të saj dolën komitë më 1911.

kombin shqipëtar.  
Shpejt, o djalëri  
ngrihu për liri!

Djem të Gegërisë,  
eni tok me ne!  
Djem të Toskërisë,  
eni t'bëjmë bë!  
Shpejt, o djalëri,  
ngrihu për liri!

Rroft' «Vëllazëria»!  
Mëm'e jonë ti je!  
Rroftë Shqipëria,  
zonj'e lirë, e re!  
Rrofsh', o «Vëllazëri»,  
lule për Shqipëri!

**1909**

## Himni i bandës së lirisë

Male dhe fusha ushtojnë sot,  
zër'i Atdheut po dëgjohet,  
dita po nis'e ngadalë zbardhohet,  
ndritë si qe një mot.

Humbur s'e kemi, jo, shpresën,  
ditët e bardha kujtojmë.

Ejani, vëllezër, në këtë çast besën  
ne pér Atdhen'ta forcojmë!

Besën ta lidhinë tok me ne  
djemtë të rrept'të Shqipërisë!  
Kjo është Banda jonë e Lirisë,  
është një hyll pér Atdhe.  
Besën ngahera e kemi,  
lidhjenë tonë ta shtojmë;  
të tërë vëllezër ne qem'e do jemi:  
vdesim e kurrrë nuk ndrojm'.

Korçë, 1909

## Mashkullori

Atje, n'at vend të lamun  
me gjak t'arbnorit t'dlirë  
atje nji djal asht'vramun,  
atje mbet nji i lirë!

Atje, n'at'vend barbari  
e njofti mir'djelmninë!  
Atje tregoi shqyptari  
sa shtrejt e blen lirinë!

Atje shqypja luftoi  
trimnisht me zogjt'e vet!  
Atje nji za ushtoi:  
«Në zjarrm, se nji na mbet!»

Ai vend nuk do t'harrohet,  
i gjall'do t'jet pér ne;  
mbas tashit do t'emnohet:  
nji çerdhe e shqypes s're.

## Rreth kullës së Dinoshës<sup>1)</sup>

Të gjithë n'pushim kish ra,  
nji za nuk u ndigjote!  
Kaiherë dhe hana ndritte,  
ne rrugën tue na e da...?)  
e ftyrën her'e qitte  
e her'mbas resh e mbloste.

Me hap sikur të tretë,<sup>3)</sup>  
me pushkë t'armatuemun,  
mbi gur udhën tue gjetun,  
na ishim nisë pesë vetë,  
n'roje n'at kull'me shkuemun,  
ku muret kishin mbetun.

Atje sa pa më zatetë,  
i Cemit gurgullimi

---

1) E vtit të kryengritjes së veriut 1911.

2) tue na e da — duke na treguar

3) me hap sikur të tretë — me hap të pasigurt

pada ai poshtë u ndjete,  
përzie me nji erë t'letë...  
E qyqes n'kull'vajtimi...  
Ka'i pushk'q'anmiku shtite...

Tue ndie at melodi,  
m'nji shkrep un'kryet e lshova,  
e rash'n'kujtime t'mia —  
u çova si n'kllapi,  
nën shkrep nji za ndigjova:  
«Do t'dalë n'drit'Shqypnia!»

## Dëshmorët e Shqypnisë<sup>1)</sup>

«Shqypnis'i vdiq tashma e gjith'fuqia!..  
Njikshtu dikush sot asht kah mendohet:  
«Për dedikim, thon', na bani ne robnia!»  
Kshtu, me kto fjal', shumkushi sot ligshtohet.

Na thom': Përpëra se m'u dhan'liria,  
q'u ba robni e rand'kaq sa s'durohet,<sup>2)</sup>  
prejse e gjall'nuk ish atdhedashtnia,  
çdo dëshmimirë me gisht mund të numrohet.<sup>3)</sup>

Por sot që m'ne asht ngallun kombësia,  
nuk ka kërkush ndopak sepse t'frigsohet,  
se n'udh'të shejt asht nisun djelmënia.

Gjithkund çdo vorr dëshmorit asht kah shtohet.  
Ta dini mirë se pa vonim Shqypnia  
prej gjakut t'shtrejt'të tyne do t'lirohet».

1) Çetinë 1911

2) domethënë para shpalljes së Hyrjetit, që pat qenë një premtim mashtrues, liri e rrejshme

3) dëshmimirë: dëshmor, martir për liri

**RISTO SILIQI**

1948.02.01

1948.

1948  
1948

1

## Mehmed Shpendi

Malit Thethit naltësinat,  
ku sall bishat qi jetojnë,  
ku rrufe e shkrepëtinat  
zjarrin botës poshtë ia lshojnë,

ku me gjama qiella s'prani,  
ku jan'majet rrok'me re,  
aty gjindet i **Shaljani** —  
Mehmed Shpendi trim si dre!

Ktu vendin n'komitë e hodhi,  
la tokën, shtëpinë e gjanë,  
tuj pi vesën si krapolli,  
ka i' qind sahat pa ngranë!

Me qetsi e la jetesën,  
sall martinën e ka rrokë,  
burrash n'burni e muer pjesën  
me tridhet komita shokë!

Tyrku n'zemër mori zore,  
tha «ai kalit t'i ve fre», —  
e mësyni me tabore,  
porse Shpendi asht ndër re!

E prej reve kqyr me t'qeshun,  
lot të kandshme i kullojn'sytë,  
plumbë e gur po qet si breshun —  
osmanllin' tërposht tuj mbytë!

Mitroloz plumbë gjergylet  
ç'po pikojn'tuj hallakatë;  
bumbullojn'prej topash gjylet, —  
gjuejnë e vrasin shkrepë t'thatë!

E komitat kur i msyjnë,  
u prin Shpendi devedish;  
e prej grykash armve tyne  
villin plumat — përshkojn'mish!

Pashë askeri u gërvalli,  
syt' n'mjeri përtokë i ul;  
iu zbe buza, iu vra balli,  
prej idhnimit mjekrën zhgul!

Thithi tymin e duhanit,  
muer kalemin, shkroi ferman;

drejt në dorë ia çon sulltanit  
e qeshtu po i ankon:

Sulltan at, ma nuk mund t'bari,  
Mehmet Shpendi m'u gjet gjak,  
cili asht ma i let' se shqari  
e se tigri ma zemrak!

Ndonse asht nji plak i vjetër,  
ai si gjarpni plot ka zell,  
e nuk asht si gjindja tjetër,  
asht si bisha e leme n'shpellë!

S'tradhton kurrnji soi krejet,  
top as pushk's'mund ta frigojnë,  
sytë i ka si shkëndi'rrfejet,  
me t'këqyrun të shitojnë.

Kurr' nuk gjendet zdathë e zdeshun,  
por gjithmon' gatue për pritë;  
n'zheg e n'shi e n'borë e breshun  
shtati i tij gjithmon'vaditë.

Në Stamboll ankimi mbrrijti  
e sulltani e këndoi, —  
nji sahat musade s'priti,  
gjegje pashës i dërgoi!

O ti pash', fort m'ke tundue,  
sa dhe syt'gjak më lotojnë!...  
Hiqiu Shpendit, kjoft'mallkue,  
ushtërin'mos t'ma farojnë!

Kam këndue n'qitabe tonë  
(falë u kjoshim — thonë ezber)  
se në bot'ka gjind drangona,  
topi as pushka që s'i merr.

Me ankim që je tuj m'que,  
e me sharte që m'kallzon:  
edhe Shpendi asht drangue  
e me te s'ke pse lufton.

Porse Shpendi si gjarpnusha  
pa asqerin se ia hjekë,  
u ul prej Thethit, ra ndër fusha,  
don ku t'jen' gjithkund me e ndjekë.

## **Tradhetorëve të kombit**

O tradhtor' t'kombit, nuk ju vjen marre  
n'dishir' t'anmiqve me u përkulë  
e n'elterin shejt të jets shqiptare  
shpatn e përgjakun pa mshir' me e ngulë?!

Doni t'mohoni gjuhën amtare,  
fli tue bamun, vner, gjak e lot!  
E të përdorni at gjuh' barbare,  
qi na u kërcnue pes'shekuj plot!

Ah fatkeqsi! Doni dhe t'zbritni  
flamurin! Shejin e Shtetit tonë!  
E n'at shtiz'shejte ate të ngritni,<sup>2)</sup>  
qi skllavt e grekt e shkrryen tash vonë!

---

1) ate gjuhë — turqishten

2) ate — flamurin e Turqisë

Ju gjettë e zeza ma se ju gjeti!  
Ju shoft' prej qiellit e rrfeshmja zduhë<sup>1)</sup>)  
Me se dëftohen Kombi dhe Shteti,  
veçse me Flamur edhe me Gjuhë?

Ato do t'mbahen, ato do t'mpruhën,  
për to do t'jepen mall edhe gja!  
Se, kur t'këmbeni flamurn e gjuhën,  
ju n'shipija tueja zot s'jeni ma!

Doni si krymbi n'pluhun t'ju shkrryhet  
nën shqelm t'anmikut foshnja e juej?  
Drita e e Drejta në burg t'ju ndryhet,  
n'troll t'ju kurdiset njeri i huej?

Cfar'helm demonit ju ndrydhi fytin,  
ju treti mendjen, ju qorroi n'dritë?  
T'vij' tok've tueja t'u korrin frytin  
ai qì vorrin ju çel përditë?

Po a nanës sonë i biri i saji  
gjoksin me heshtë don t'ia shpojnë?!  
Ah! Le t'shpërthehet prej qiellit vaji  
e lott e gjakut mbi na t'kullojnë!

---

1) zduhë — flakë

Ç'asht kjo mynxyrë? Cilit komb jeni?  
Vall' prinden tuej s'e keni njoftë?  
Po çfarë gjakut ndër dcj ju keni  
e ç'gjuhë flisni? — Turpi ju mbloftë!

— Ç'asht kjo mynxyrë? Cilit komb jeni?

## Dedë Gjo Luli

(I TRABOINIT TE HOTIT)

Kur Kongresi i Berlinës  
Hot e Grud', dy male n'nam,  
ia dhuroi Knjazit Cetinës,  
të shtin mbrend turi e kambë,

iu përgjak nji burrit syni,  
Ded Gjo Lulit vojevodë!')  
Me kren'malesh n'Shkodër hyni  
fill tu pasha mbrend'në odë.

«Pashë, o pash'të rrnoft'bajraku,  
ndigo Dedën, ç'asht kah flet:  
për pa rrjedh'der'n'sylah gjaku<sup>2)</sup>  
knjazi vendin tem s'e shklet!»

---

1) vojevodë — prijës, udhëheqës

2) sylah — (turq.) brez kur vihen armët

Aty doli, mori udhëën,  
tuj kuvend' me kryeparinë, —  
mu në Hot kur mbrriti kullën,  
çoi kushtrimin, mblodh djelminë.

Armët n'dorë e u gatuerë  
me e mprue tokn e ksaj Shqypni,  
nji jav'dit edhe nuk shkuene,  
ra urdia e Malit Zi<sup>1)</sup>!

Lum për zotin pushka ç'krisi,  
shoqishojn'n'kushtrim tue e ndjellë;  
dielli n'qiell u terratisi  
prej tymit qi ishtë hjedhë.

Djelmt me gjoks si kull'çelikut  
e n'rrezik me t'veten rrashtë  
pritshin plumet e anmikut,  
der qi e dbuene, e qitën jashtë...

Ah! Qe prep don't'na dajn'copa,  
prep mendimi i parë asht ngjallë!  
Por ta marr vesht gjith' Evropa:  
Ded Gjo Luli prep asht gjallë!

---

1) urdia — ushtria, hordhia

## **Shumëvojtunit Atdhe**

Prej s'lodhunit shpirti i mekun  
vallzon mbi tokën shqyptare  
dhe ndër male, n'errsin'mblue,  
pisha e liris'shqymë e sosë!!)  
Zgjue jam dhe esull, dhe më shtihen  
shëmbëlltyrat plot me marre,<sup>2)</sup>  
andrrimet e shqyptarta<sup>3)</sup>  
me duer t'shqyptarve varrosë!  
Ndër kllapina m'shetit shpirti!  
Çfarë kanget do të endi?  
Don t'lartsoj' triumfalish  
me t'përdhunta fraza t'flashkta??!)  
Ah jo! At landë nuk e gjeta,  
tuj kërkue si derdimendi,  
as n'qytete, as ndër fshatra,  
as ndër fiset e përbashkta!  
Por n'kujtime un'tuj vrejtun  
famn e art' të kohës s'shkueme

---

1) shqymë — shue, fikë

2) shëmbëlltyrat — parafytyrimet fytyrat

3) andrrimet e shqyptarta — idealet kombëtare për Shqipërinë

4) fraza t'flakshta — fraza pa forcë, të dobëta

dhe tuj mësue kahun e kalbun,<sup>1)</sup>  
t'tallunit e fatit t'saj, —  
m'zhkrehet zemra në mallngjime  
mbas vllaznis' së bastardueme!  
S'due t'i dhimbsoj! Por, pa dashtun,  
sytë e mi shpërthehen n'vaj!...  
Shpirti i liris'tuj i gjimue  
i plaguem e dbue ndër male!  
Bota tejet m'njanë an'kryet,<sup>2)</sup>  
n'çapoj t'fatit zi tuj t'lancë!  
N'det t'harrimit po humbasin  
t'mbetnat tueja ideale!  
Populli dridhet prej trishtimit,  
por, m'sa peshku, me goj's'bzan!...  
Bijtë e tu, Atdhë i dashtun,  
nuk don gjuhën, nuk don kombin!  
N'elterin e jets shqyptare  
kërcnohen me armë n'dorë!  
Feodalët, n'grahmë t'dekës,  
me tamth t'idhun buzt t'i njomin!  
Kunor'ferrash porsi Krishtit  
t'vejn'mbi ballin madhështor!  
Zoja e Shqypnis', Shqypja e zezë,  
kjan pa lote, me sy t'shterun!  
Pikëllohet n'loçk'të zemrës  
bijve t'saj gjamën kah ndin,  
kah vajtojnë e kjajn'pa shpresë,

---

1) tuj mësue kahun e kalbun, t'tallunit e fatit t'saj — duke marrë vesh kahun (drejtimin) e kalbun (e gabuar) që mori Shqipëria, duke parë se si fati po tallet me Shqipërinë

2) m'njanë an'kryet — shto — e ka sjellë

dhimbsojn' triumfin e errun')  
flaka e keqsis'dhe e turpit  
gjité e tyne iu lëpin!...  
Ata djelm t'atyne burra,  
për Atdhe qi u dëshmuene,  
prindës vet iu tundin eshtnat,  
me gjak vllaznish tuj iu qullë!  
Ty, o Atdhe, t'ropne, t'vodhne,  
t'dogjne, t'poqne, krejt t'verfnuene!  
Kur agimi i del botës,  
ti kah vorri gjindesh n'udhë!  
Njerzit e huej n'qytete t'hueja  
për ty planet pregatisin:  
me t'dhan'dritë (?) o me t'lan'verbët!  
Me t'vorruje, o me t'lan'gjallë.  
Bijt'e tu gjith' kte e shofin,  
por në mprojtje nuk lëvizin, —  
u asht kandun skllavëria,  
rrin'si krymbat n'pluhun kallë!...  
Adriatik, det i kaltërt,  
q'i përpin valët e lumit,  
priti turmat e anmiqve!  
Nji komb i ten'të ban be!...  
O shqyptart e ri qi fleni,  
a do t'zgjohi ndojher'gjumit  
me i kërkue lirin'shëruese  
shumëvojtunit Atdhe!

---

1) dhimbsojnë triumfin e errun — u dhimbset, u vjen keq për triumfin (lirinë), që u errësua (që humbi)

## **Luftari ynë**

E fatkeqësoi vorfnia,  
nuk ka mprojtje prej kurrkuj,  
shtëpia e vet s'asht' e tia,  
brenda rron si rob i huej!

Robe mëma rob e polli,  
me keqhkékë i vu kunorë,  
tok't frytore ai i mbolli, —  
vjen i hueji e i korr!

E tlynin prej qumshtit mjelmë  
merr halldupi t'mbramen pikë, —  
ai me shllirë, shllirë t'njelmë  
t'vet gërmazit eden fik!!)

Vorfënia, zia, mnera,  
petkat crule, gjoksi çelë,

---

1) eden — etj

e pjek dielli, e rreh era, —  
shpirt i fortë e nuk i ngel!

Por nji ditë iu neveriti  
kjo vorfni, kjo robëni,  
thue se ora e yet e thrriti  
dhe jetën ta baj'dëshmi.

Rroki pushkën, at gjaksore,  
n'brez mbërtheu at samokresë,<sup>1)</sup>  
e ma s'parit skoi ndër vorre,  
n'vorre t'prinde mori ndjesë.

Mori ndjes' dhe u betovi:  
«O liri, o vdek' me nder!...  
Syni lote i pikovi  
se kujtoi fëmijt' të mjërë!

Katër foshnja përreth votret  
pa nji mprojtje që i la, —  
shtërngoi zemrën, shini lotet  
edhe mallit nuk iu dha.

Por u soll me t'shpejta çapa  
tuj vegue me synin shgjetë,

---

1) samokresë — revolver

nuk e ktheu kryet mbrapa<sup>1)</sup> n'mal  
der qì mbrriti n'mal tè shkretë.

Pasoi dita, jardhi nata,  
e luftari pushkën n'dorë.  
Filloi shiu e shterngata,  
filloi breshër<sup>2)</sup>, filloi borë!

Ndër kujdese ra tè thella,  
krizmet zemrës tuj ia njehë,  
nuk e mprute dot as shpella,  
vetëm qielin kishte strehë!

Nata e par' në mal q'u hodhi,  
e dhunojti pa mëshirë,  
porse mëma kështu e polli:  
me vue<sup>1)</sup> si burrë i mirë.

Orët shkojnë, agimi plasi,  
pushoi moti i natës s'parë;

1) me vue — me vuejtë

me halldupa ai u hasi,  
pushkës gjaksore i dha zjarr!

Deh fatosi luftën nisi  
me t'pafrigshmen ftyrë,  
sa barbarë i rrokullisi, —  
të lahen në gjak të ndyrë!

Ra përsri dhe errësina  
e luftari udhën muer,  
porsi shqari mbi shkëmbina  
zu pushimin mbi nji gur.

Mbi nji gur pushimin nguli,  
gjaksoren e pshteti n'sup  
e prej krahit strajcën uli,  
xuer ca bukë edhe nji kupë.

Çeli kupën, kupën drunit  
me kryp' bukën e mylnej,<sup>1)</sup>  
buka thekën vend'n e unit<sup>2)</sup>  
luftëtarit ia ushqej!

---

1) e mulmëj — e ngjeu

2) vend'n e unit — vendin e urise

Ia ushqeu vend'n e unit  
t'mbramen her'në jet'të vet,  
se iu sos kafshata e fündit,  
as thërrime ma s'i mbet.



Pasojn'dit't e koha vëjtje,  
pasojn'ndeshjet, vrasë e presë,  
e luftari pa nji mprojte  
përpas pushkës t'vetmes shpresë!

Tuj luftue për nder të fisit  
po hjek zi, po vuen mundim,  
bar këlkaze, kshtenja lisit  
vetëm kishte për ushqim!

Kur qerpallet gjumi vriste  
dhe kotin s'po muj me vue,<sup>1)</sup>  
se gjith'força iu moliste,<sup>2)</sup>  
lypte shpirti me pushue.

---

1) dhe kotin s'po muj me vue — dhe s'mund të duronte të kotorit

2) iu molisë — i keqësohej

Me gjaksoren kapërthyë  
u përshtrite i têrhjekë,<sup>1)</sup>  
shtatin n'tokë e gur nën krye  
i kënaqte syltë e mektë.

Me halldupa kur u ndeshët,  
me barbar'të pamëshirë;  
buza veç atherë i qeshte,  
u ushqente për dëshirë.

Por nji dit' s'i shkoi për s'mbarit.  
Zu luftoi por sa pak, —  
i ra plumja e barbarit,  
plasi gjoksi gulfa gjak!

Porse zemra s'e lëshoi,  
gjaku rrkaj'si shtite mnerë,  
shpérblej vâtrën qi luftoi,  
shprazi pushkën t'mbramen herë!

T'mbramen her' pushkën e shprazi,  
u molisi e u rrëxue,

1) u përshtrite i têrhjekte — shtrihej i lodhur.

e ndër buzë iu dëftue gazi,<sup>1)</sup>  
se për Shqypni u dëshmues!<sup>1)</sup>

U rrëxue, ma n'kamb' nuk çohet,  
gjaku s'prante tue dalë,  
u përpoq sa të largohet  
prej bërraket t'gjakut valë.<sup>2)</sup>

Me mundim e zu provimin  
forcë zemrës tuj i dhanë,  
mbas nji shkrepit gjet pushimi,<sup>3)</sup>  
ku shkoi gjunjas e rrëshanë.<sup>4)</sup>

Porse tresjet<sup>3)</sup> ktu e zunë,  
krejt humbati në kllapi,  
e në mashte<sup>4)</sup> iu dëftuene  
loçka e zemrës katër fmi.

Katër foshnja pa përkrahe  
pa nji mprojtje, pa nji pshtetë,  
qi po i len n'vorfni e n'ahe,  
n'rrug të madhe, t'mjerë e t'shkretë.

1) u dëshmues — ra dëshmor

2) bërraket — pellg

3) tresjet — të dridhunat

4) mashte — kallpi

Të përpinqen, të trazojnë  
si çë mben'jetima t'ngratë,  
dyert të hueja të kërkojnë  
për nji koje buk të thatë!

Kto kujtime e piklluene,  
malli i fmive nuk iu shkoq,  
lot prej syve i kulluene,  
e mboramja fshame iu têrroq!

Dridhi shtatin, sytë i mbylli,  
ma nuk luejti askërkah,  
e në qiel iu fiku ylli  
jetën për Shqypni e dha.

# **MIHAL GRAMENO**



## Për mëmëdhenë

(Kënga e kryengritësve shqiptarë)

Për mëmëdhenë, për mëmëdhenë  
vraponi burra, se s'ka me prit!  
Të vdesim sonte me besa besë  
pranë flamurit të kuq q'u ngrit!

Pranë flamurit, pranë flamurit  
me shpatë çveshur shqipëtarisht,  
për dhen' e babës edhe të Burrit  
kemi me vdekur sot burrërisht.

Tym edhe flakë, ujë të valë  
Baba Tomori nxjerr e buçet,  
të gjithë trimat atje me dalë  
se dita erdhi koha më s'pret!

E Drini plaku me oshëtima  
mbë Shqipërinë valët po derth:

tosk edhe gegë, si vetëtima  
armikut bini, se dita erth!

Ejani burra malit përpjetë  
duke betuar vdekj' a liri,  
se s'ka m'e ëmbël në këtë jetë,  
kur vdes shqiptari për Shqipëri!

Shpatat gatitni e të pérzejmë  
armikn' e egër nga mëmëdheu,  
se afroi dita, që t'i dëftejmë,  
që kemi lerë nga Skënderbeu!

Vdekje, vëllezër ne të kërkojmë  
se sa një jetë në robëri!  
Më mir' një ditë neve të rojmë;  
po zgjedhën shkundur e në liri.

Poshtë rob'rija! Posht' errësira  
që po përdorin armikët sot!  
Njëri me kisha, tjetri xhamira;  
jemi vëllezër, s'na ndajnë dot!

**1909**

## **Uratë për liri**

Merr uratën, bir, prej meje  
edhe armët i gatit  
se erdh dita e shënuar  
doli ylli e na ndrit.

Eshtë ylli i lirisë  
me të tjetër nuku ngjet;  
Shqipëria kaqë shumë  
këtë yll që po e pret.

Djemt' e saj le ta dëftejnë  
kush mban emër shqipëtar,  
që s'ka kurrë me duruar  
ta urdhronjë një barbar.

Vdekje, djema, të kërkoni  
për të shenjtënë liri,  
se rojtjen përsë e doni  
nënë zgjedh' e robëri?

Rojlja pa nder është vdekje  
po një vdekje e pambuluar,  
e kur vdes për mëmëdhenë  
je i gjall', i paharruar.

Të gëzuar atëhere,  
kur për juve do të mësojnë,  
që për mëmëdhen' u vratë  
me këngë do t'u mbulojnë.

E do shkruajnë mi varr,  
që ju vdiqët për lirinë  
pranë flamurit të kuq  
e nderuat Shqipérinë.

A të kthyerë nga lufta  
burrërisht, ose plagosur,  
nënët tuaj me gaz shumë  
u kanë për të qafosur.

E kurora trëndafilita  
për m'i krye do t'u ngjeshin,  
edhe emrat do t'u rojnë  
kurrë, kurrë do mos vdesin.

Andaj bir, pa ndarë dua  
përmbi armët të betosh;

që i vdekur, a i gjallë  
kthehesh ti të më nderosh.

Si i dha uratën djali,  
mori armët e betoi:  
«Për lirin' e Shqipërisë,  
tha, do vdes, e fluturoi.

**1909**

## Lamtumirë

(*Këngë e kryengritjes*)

Lamtumir', ju le shëndenë  
s'ardhi dita që të shkonj.  
për liri, për mëmëdhenë,  
me gaz vete të luftonj.

Për lirinë, për lirinë  
me gëzim kam un' me vdekur,  
më s'duronj dot robërinë  
se mjaft zemra m'është djegur.

Pushka m'është mëm' e dashur,  
edhe shpata e çkëlqyer,  
ati im këto ka pasur,  
me gjak të armikut lyer.

Shtëpi kam gunën e dhirtë,  
malet, pyjet ku jetonj,

**duke pritur nat' e ditë  
armikun ta copëtonj.**

Se reh bora, shiu e breshëri  
këjo rojtje s'më tmerron,  
se ësht' e ëmbël si shqerit  
kush për Shqipëri lufton.

Vdekja kurrë s'më trëmb mua  
si çdo tjatër njeri  
se vdekjen e kemi hua,  
po lum kush vdes për liri.

**1908**

## Muaji i majit

Sa i ëmbël ish muaj i majit  
kur delnimë rrëzës së malit,  
pranë burimit rrnim; qëndronim;  
a e mban mënd sa bukur' ronim?

Nën ata lisa të lulëzuar  
losnin bilbilat duke kënduar,  
të përqafosur rinim, dëgjonim;  
a e mban mënd sa bukur ronim?

Të vdisnj' at'here sa mirë qe,  
në krah't tënde kur bënje be,  
e duke putthur tinë më thoshnje  
a' jetën pa mua nuk e deshnje.

Të vinjë prapë muaj i majit,  
të dalim rrëzës së malit,  
pranë burimit ne të qëndrojmë  
e zemrat tona ne t'i bashkojmë.

## PASQYRË E LËNDES

### PARATHËNIE

### NAIM FRASHËRI

|  |    |
|--|----|
| Gjuha jonë .....                           | 9  |
| Korça .....                                | 12 |
| Shpreh .....                               | 15 |
| Tradhëtorët .....                          | 17 |
| Shkëndij' e diellit ndaj manushaques ..... | 21 |
| Fjalët e qiririt .....                     | 24 |
| Fyelli .....                               | 27 |
| Bagëti e bujqësia .....                    | 30 |
| Histori e Skënderbeut (fragmente) .....    | 44 |

### ANDON ZAKO ÇAJUPI

|   |    |
|---|----|
| ATDHEU — Mëmëdheu .....                   | 63 |
| Shqipëtar! .....                          | 64 |
| Ku kemi lerë .....                        | 67 |
| Baba Tomori .....                         | 68 |
| Dëshir' e Skënderbeut ditën që vdiq ..... | 70 |
| Robëria .....                             | 72 |
| Besa-besë .....                           | 74 |
| Naim Frashëri .....                       | 77 |
| Fshati im .....                           | 79 |
| Fyell' i bariut .....                     | 81 |

|               |    |
|---------------|----|
| Kurbeti ..... | 83 |
| Korriku ..... | 88 |

## **PASHKO VASA**

|                     |    |
|---------------------|----|
| O moj Shqypni ..... | 93 |
|---------------------|----|

## **JERONIM DE RADA**

|                                     |     |
|-------------------------------------|-----|
| Milosao (fragmente) .....           | 99  |
| Skënderbeu i pafan (fragment) ..... | 130 |

## **ZEF SEREMBE**

|                          |     |
|--------------------------|-----|
| Vrull .....              | 141 |
| Zonjës Elena Gjika ..... | 142 |
| Detari .....             | 146 |
| Autoportret .....        | 148 |
| Fytyra e asaj .....      | 149 |
| Pas të vjelave .....     | 150 |

## **GAVRIL DARA (I RIU)**

|  |     |
|--|-----|
| Kënga e sprasme e Balës (fragment) ..... | 157 |
|--|-----|

## **ASDRENI**

|                            |     |
|----------------------------|-----|
| Vlera e Atdheut .....      | 175 |
| Betimi mi flamur .....     | 177 |
| Drinit .....               | 179 |
| Ardhi dita .....           | 184 |
| Balashit .....             | 186 |
| Zéri i kryengritësve ..... | 189 |
| Krerëve tradhëtorë .....   | 193 |
| Lulekuçqja .....           | 196 |

## **NDRE MJEDA**

|                       |                   |
|-----------------------|-------------------|
| Vaji i bylbylit ..... | 201               |
| Liria .....           | 212               |
| Malli për atdhe ..... | 215               |
| Gjuha shqipe .....    | 218 <sup>11</sup> |
| Mustafë Pasha .....   | 222               |

## **FILIP SHIROKA**

|                               |     |
|-------------------------------|-----|
| Shko, dallëndyshe!... .....   | 227 |
| Dallëndyshe, eja!... .....    | 229 |
| Te vorri i Skanderbegut ..... | 232 |
| Kombit tonë .....             | 233 |
| Kushtrimi .....               | 235 |

## **LUIGJ GURAKUQI**

|                                     |     |
|-------------------------------------|-----|
| Dallëndysha u kthye .....           | 239 |
| Zogzës kryezezë .....               | 241 |
| T'falun atdhetarit të Kosovës ..... | 244 |
| Qindresa .....                      | 246 |

## **HILE MOSI**

|                                      |     |
|--------------------------------------|-----|
| N'armë, Shqypni! .....               | 251 |
| Kënga e shoqërisë «Vëllazëria» ..... | 252 |
| Himni i bandës së lirisë .....       | 254 |
| Mashkullori .....                    | 255 |
| Rreth kullës së Dinoshës .....       | 256 |
| Dëshmorët e Shqypnisë .....          | 258 |

## **RISTO SILIQI**

|                              |     |
|------------------------------|-----|
| Mehmed Shpendi .....         | 261 |
| Tradhëtorëve të kombit ..... | 265 |

|                           |     |
|---------------------------|-----|
| Dedë Gjo Luli .....       | 268 |
| Shumëvojtunit Atdhe ..... | 270 |
| Lufstari ynë .....        | 273 |

## **MIHAL GRAMENO**

|                      |     |
|----------------------|-----|
| Për mëmëdhenë .....  | 283 |
| Uratë për liri ..... | 285 |
| Lamtumirë .....      | 288 |
| Muaji i majit .....  | 290 |

Fjalët e gjuhës së zjarrtë.

Antologji e poetëve të rilindjes.  
[Red.: I. Kadare]. T., «Naim Frashëri»,  
1982,

296 f.

(B.m.): 891.983-1-822

(B.v.): 991.983-1-82

F 69

Tirazhi 3000 kopje Format 78x109/32 ' Stash 2204-79

Shtypur KOMBINATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e Re  
Tiranë 1982